

**DHUNA FIZIKE DHE PSIKOLOGJIKE NË SHKOLLAT
E MESME, TRAJTIMI PEDAGOGJIK I TYRE
(PESHKOPI, PRIZREN DHE DIBËR E MADHE)**

Doktoranti: **Zamira Gjeleshi**

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të **programit të Doktoratës në**
Departamentin e Shkencave Sociale, me profil Pedagogji,
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof. Asoc.Dr.Edi Puka**

Numri i fjalëve: 55886

Tiranë, shtator 2019

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se studimi është puna ime origjinale .

Ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara duke iu referuar rregullave në përputhje me standardet e studimeve dhe kërkimeve shkencore.

E drejtë e autorit © 2019. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit

ABSTRAKTI

Gjatë dy dekadave të fundit, reformat arsimore kanë patur të bëjnë me programe, tekste, objektivat e arritjeve të nxënësit, kurrikulën e shkollës së mesme dhe modele të reja të mësimdhënies. Një çështje e fshehur dhe shqetësuese në shkollat e mesme shqiptare është dhuna. Është e qartë se dhuna mbizotëron në shkollë, por ka një mungesë të të kuptuarit për shkaqet e kësaj dukurie, ndikimin që ka në jetën e fëmijëve, si dhe mënyrat e mundshme për të trajtuar këtë problem, që prek mijëra nxënës.

Dita-ditës numri i rasteve është në rritje, kështu që është detyrë e të gjitha institucioneve përgjegjëse për të hetuar këtë dukuri negative. Të merren masa për ta parandaluar duke shtuar profesionalizmin, edukimin e shëndoshë dhe të drejtë, këshillëdhënien profesionale ndaj të rinjve dhe të rriturve.

Fëmijët nuk i humbasin të drejtat e tyre njerëzore me kapërcimin e pragut të shkollës. Kështu, për shembull, arsimimi duhet ofruar në atë mënyrë që respekton dinjitetin e qenësishëm të fëmijës, i jep fëmijës mundësinë të shprehë këndvështrimet e tij lirisht dhe të marrë pjesë në jetën e shkollës. Arsimimi duhet të ofrohet edhe në një mënyrë të tillë që të respektojë kufizimet në disiplinën shkollore dhe të promovojë mendësinë e antidhunës në shkollë.

Talentet duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre në shkallën më të lartë. Fëmija i talentuar duhet të mbështetet për t'i mundësuar atij që të jetë i madh në shkencë, art, jetën sociale, etj. Mësuesit duhet të dinë natyrën e nxënësve dhe për t'u mundësuar atyre që të përballen me sfidat e jetës. Zgjedhja e karrierës është një nga vendimet më të rëndësishme për jetën e njeriut. Pa dashje dhe pa vetëdije me anë të dhunës robërojmë talentin, shkencëtarin e madh, artistin e famshëm dhe strategun ushtarak. Dhuna duhet të kundërshtohet, sepse kur ajo shfaqet e keqja është e përhershme!

Keywords: dhuna, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve, ligj, arsimim, sjellje agresive, dhuna gjatë adoleshencës, abuzim, konflikt

ABSTRACT

During the last two decades, educational reforms have had to do with programs, texts, achieving objectives, the new high school curriculum and teaching models. A hidden and disturbing issue is the recent violence in Albanian high schools. It is clear that violence prevails in school, but there is a lack of understanding to the causes underlying this phenomenon, the impact it has on the lives of children, and possible ways to tackle this problem, which affects thousands of students. Day by day the bullying of cases is increasing, so it is the duty of all responsible institutions to investigate this negative phenomenon. Measures should be taken to prevent adding professionalism and education to advise on the youth and adults. Children do not lose their human rights by overcoming the threshold of the school. This, education must be provided in a manner that respects the inherent dignity of the children, giving them the opportunity to express their views freely and to participate in school life; education should also be provided in a manner that respects the strict limits on discipline and promotes a culture against violence in school. Talents should develop their skills in the highest degree. Gifted children should be supported to enable them to be great in science, art, social life, etc. Teachers should know the nature of the students and enable them to cope with the challenges of life. The choice of career is one of the most important decisions for human life. Inadvertently and unconsciously, through violence, drowned talents, great scientists, famous artists, and military strategists are enslaved. Violence should be objected, because when it appears and does good, the good is only temporary, and when it is evil, evil is eternal!

Keywords: violence, defense system of children, law, education, bullying, teen dating violence, abuse, conflict

DEDIKIMI

. . . **tim Ati**, që nën kapotën e Tij në burgjet e Burrelit, Tiranës dhe Tërbufit u fshehën diplomat e universiteteve të botës.

Ai ishte orator i përkryer, zëri i tij ishte një mrekulli: i kumbueshëm, tipik shqiptar për nga timbri, tonaliteti, melodia dhe shqiptimi, por pllakosi në një heshtje të thellë, që askush nuk guxoi ta thyente. Askujt dhe asnjëherë nuk tregoi për jetën e tij në fikje. Në fytyrën e tij hidhte relativitetin e jetës, rrudhat e ballit ishin alegoritë e saj.

Krenar. B— Ëndrra e tij për t'u endur nëpër botë me Shqipërinë në zemër duke valëvitur flamurin shqiptar në kampionate botërore me Kombëtaren Shqiptare u shua në korridorin e Shkollës së Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti" Peshkopi.

Shkolla u bë një vend tjetër në qiell!

Ata ndanë me mua mençurinë, karakterin hyjnor dhe drita e dashurisë së tyre më ndriçojnë në misionin e mësimdhënies duke ecur në hijen e madhështisë së tyre.

FALENDERIME

Mirënjohje të veçantë ia dedikoj familjes sime për mbështetjen dhe përkushtimin gjatë viteve të studimit.

Falenderime dhe mirënjohje ndaj udhëheqësit shkencor: Prof. Asoc.Dr.Edi Puka, i cili ka merita të mëdha në kultivimin dhe formimin tim si një kuadër shkencor. Mendimet dhe këshillat e vlefshme të tij më kanë mundësuar që temës së studimit t'i afrohem nga perspektiva, përmasa të ndryshme, më ka nxitur në planifikimin dhe zhvillimin e temës. Ndihma e tij është shumë e rëndësishme jo vetëm për këtë punim, por mbetet një udhërrëfim për punën time në të ardhmen.

Në veçanti u jam mirënjohëse të nderuarve Etleva Miftari, Defrim Kaleci, Erald Miftari, Nazmi Xheleshi, Shpend Erbeli, Bujar Karoshi, Bledar Miftari, Valdrina Miftari, Ornela Dedja, Erilda Topuzi, Klevi Topuzi, Genci Miftari, Merjem Miftari, Amelia Miftari, Jusairah Miftari Lorenc Lazimi, Ygerta Gjeleshi, Kloreanta Janushi, Ylber Berisha, Arbana Pasholli, Flamur Mulladautaj, Ylli Vërlaku, Erion Kurtulla, Meleqe Kata, Xheladin Sala, Besa Uka për ndihmën, përkrahjen e palodhur, zemërgjerësinë dhe miqësinë.

Nxënësit, kolegët, drejtuesit e gjimnazeve: "Said Najdeni", "Nazmi Rushiti", "Remzi Ademaj", "28 Nëntori", "Gjimnazi Maqellarë" për bashkëpunimin, besimin dhe mbështetjen në rrugëtimin tim për realizimin e studimit.

Falenderoj të gjithë Profesorët e Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit European të Tiranës, organizatorët e Konferencave, Revistave Shkencore për ndihmën e madhe në prezantimin, botimin e punimit duke injektuar kërkimtarin shkencor dhe duke u ndjerë qytetar i denjë global.

Mirënjohje të veçantë ia dedikoj nënës time për kurajon, forcën dhe dashurinë e pafund.

Do të më mungoni...

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE	1
1.1 Parathënie	1
1.2. Shtrimi i problemit	5
1.3. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë	7
1.4. Debati aktual mbi dhunën	8
1.5. Përmbledhje e shkurtër e literaturës, avantazhet / kufizimet e saj	16
1.6. Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave të hulumtimit	18
1.7. Vlera shoqërore e studimit	20

PJESA E PARË: KUADRI TEORIK

KAPITULLI II: SHQYRTIM LITERATURE

2.1 Dhuna – shkollat teorike	22
2.1.1 <i>Dhuna në shkollë në një kontekst ndërkombëtar është një thirrje për bashkëpunim</i>	22
2.1.2 <i>Ngritja e vetëdijes dhe vendosja e prioriteteve</i>	26
2.1.3 <i>Listë globale ndërhyrjesh dhe politikash</i>	27
2.1.4 <i>Rritja e kontributeve të teorisë</i>	28
2.1.5 <i>Hipoteza dhe propozimet teorike të avancuara në Japoni</i>	29
2.1.6 <i>Çështje teorike që trajtohen nga perspektiva globale</i>	30
2.2 Dhuna në Shtetet e Bashkuara të Amerikës	35
2.2.1 <i>Mite dhe fakte rreth dhunës në shkollë</i>	36
2.2.2 <i>Dhuna në Shtetet e Bashkuara të Amerikës</i>	38
2.3 Dhuna në shkollat e Evropës	40
2.3.1 <i>Tendencat historike të dhunës në shkollat evropiane</i>	40
2.3.2 <i>Kërkesat nacionale, nismat dhe programet</i>	42
2.3.3 <i>Kongrese shkencor, konferenca, akte, ligje</i>	43

2.3.4	<i>Politikat e shkollës dhe rregullat e klasës</i>	45
2.3.5	<i>Masat e përgjithshme</i>	48
2.4.	<i>Dhuna në shkollat e Kosovës</i>	51
2.4.1	<i>Dhuna në shkollë, plagë e vjetër në debat parlamentar</i>	52
2.4.2	<i>Nismat dhe programet kombëtare në Kosovë</i>	53
2.5	<i>Dhuna në shkollat e Maqedonisë</i>	56
2.5.1	<i>Dhuna në shkollë, sjellje jo normale që kalon në kriminalitet</i>	56
2.5.2	<i>Nismat dhe programet kombëtare</i>	57
2.6	<i>Dhuna në shkollat e mesme të Shqipërisë</i>	59
2.6.1	<i>Statistika viktimash të dhunës në shkollën e mesme</i>	60
2.6.2	<i>Mendime dhe debatet akademike mbi dhunën në shkollë</i>	61
2.7.	<i>Interpretimi i akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijës.</i>	66
2.7.1	<i>Deklarata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut</i>	66
2.7.2	<i>Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore</i>	67
2.7.3	<i>Korniza për Veprime Dakarit</i>	67
2.7.4	<i>Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve</i>	67
2.7.5	<i>Rregullat e Pekinit</i>	68
2.7.6	<i>Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë</i>	68
2.7.7	<i>Kodi Penal</i>	69
2.7.8	<i>Kodi i Procedurës Penale</i>	70
2.7.9	<i>Kodi i Familjes</i>	71
2.7.10	<i>Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar</i>	71
2.7.11	<i>Qarkorja e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës</i>	72
2.7.12	<i>Kodi i Etikës</i>	73
2.8	<i>Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve</i>	73
2.8.1	<i>Spektori i Shërbimeve Sociale</i>	74
2.8.2	<i>Policia dhe Spektori i Brendshëm</i>	76
2.8.3	<i>Spektori i Drejtësisë</i>	78
2.8.4	<i>Spektori i Arsimit</i>	81
2.8.5	<i>Spektori i Shëndetësisë</i>	83
2.8.6	<i>Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri</i>	85

PJESA E DYTË

KAPITULLI III: METODOLOGJIA E KËRKIMIT

3.1	Shfrytëzimi i kuadrit teorik në funksion të realizimit të studimit empirik	90
3.2	Burimet e informacionit	91
3.3	Kampioni i studimit	93
3.4	Metodologjia, metodat dhe instrumentet bazë të hulumtimit	94
3.5	Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre	95
3.5.1	<i>Pyetëtori</i>	95
3.5.2	<i>Pyetëtori Pilot</i>	96
3.5.3	<i>Përpunimi i të dhënave</i>	96
3.6	Vështirësitë e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave në terren	98
3.7	Përmbledhje e kapitullit	99
3.8	Analizë e pyetësit të nxënësve	100
3.9	Analizë e pyetësit të mësuesve	158
3.10	Analizë e pyetësit të prindërve	197
3.11	Analizë e pyetësit të mjekëve të urgjencës	206
3.12	Analizë statistikore	213
3.13	Analiza e intervistave	229
3.14	Analiza e rezultateve të Maturës Shtetërore	246
3.15	Analiza e nevojave SWOT	256
3.16	10 veprimet për t'i thënë “Stop” dhunës në shkollë	258

KAPITULLI IV: PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

4.1	Përfundimet	267
4.2	Rekomandimet	271

SHTOJCA

1.	Punime shkencore dhe profesionale	293
2.	Burime në internet	276

3.	Pyetësor	280
4.	Lista e personave të intervistuar	291
5.	Qarkore e MASH	293

LISTA E ILUSTRIMEVE

Figura 1: Sektori i Shërbimeve Sociale	75
Figura 2: Policia dhe Sektori i Brendshëm	78
Figura 3: Sektori i Drejtësisë	80
Figura 4: Sektori i Arsimit	82
Figura 5: Sektori i Shëndetësisë	84
Figura 6: Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve	88
Figura 7: Përgjigjet urgjente të mbrojtjes së fëmijëve	89

LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE

Grafiku 2.1.1: Klasifikimi i vendeve sipas frekuencës së sjelljeve agresive	46
---	----

Pyetësor i nxënësve

Grafiku 3.8.1: Pjesëmarrja sipas gjinisë	100
Grafiku 3.8.2: Pjesëmarrja sipas klasës	102
Grafiku 3.8.3: A jeni dhunuar	104
Grafiku 3.8.4: Sa shpesh përdoret dhuna	106
Grafiku 3.8.5: Jeni dhunuar	108
Grafiku 3.8.6: Shkaku i dhunës	111
Grafiku 3.8.7: Format e dhunës verbale	113
Grafiku 3.8.8: Format e dhunës joverbale	116
Grafiku 3.8.9: Format e dhunës fizike	118
Grafiku 3.8.10: Dhunë më shumë ushtrohet mbi	121
Grafiku 3.8.11: Dhunë më shumë ushtrohet në	123
Grafiku 3.8.12: Dhunë më shumë ushtrohet nga	125
Grafiku 3.8.13: Përballë mësuesit ndiheni	127

Grafiku 3.8.14: Mësuesi kujdestar ka rol	130
Grafiku 3.8.15: Kujt i drejtoheni kur keni problem	133
Grafiku 3.8.16: Dhuna ndikon	136
Grafiku 3.8.17: Informacioni i mësuesit mbi të drejtat e fëmijës	139
Grafiku 3.8.18: Në etikën e mësuesit do të ndryshonit	141
Grafiku 3.8.19: Mendimi mbi psikologun	144
Grafiku 3.8.20: Keni shumë ndikime	146
Grafiku 3.8.21: Niveli i sigorisë në shkolla	148
Grafiku 3.8.22: Të menduarit për vetëvrasje	151
Grafiku 3.8.23: Ndikimi në rezultatet e nxënësit	153
Tabela 3.8.3: A jeni dhunuar	105
Tabela 3.8.4: Sa shpesh përdoret dhuna	108
Tabela 3.8.5: Jeni dhunuar	110
Tabela 3.8.6: Shkaku i dhunës	113
Tabela 3.8.7: Format e dhunës verbale	115
Tabela 3.8.8: Format e dhunës joverbale	118
Tabela 3.8.9: Format e dhunës fizike	120
Tabela 3.8.10: Dhunë më shumë ushtrohet mbi	122
Tabela 3.8.11: Dhunë më shumë ushtrohet në	125
Tabela 3.8.12: Dhunë më shumë ushtrohet nga	127
Tabela 3.8.13: Përballë mësuesit ndiheni	129
Tabela 3.8.14: Mësuesi kujdestar ka rol	132
Tabela 3.8.15: Kujt i drejtoheni kur keni problem	135
Tabela 3.8.16: Dhuna ndikon	138
Tabela 3.8.17: Informacioni i mësuesit mbi të drejtat e fëmijës	141
Tabela 3.8.18: Në etikën e mësuesit do të ndryshonit	143
Tabela 3.8.19: Mendimi mbi psikologun	145
Tabela 3.8.20: Keni shumë ndikime	148
Tabela 3.8.21: Niveli i sigorisë në shkolla	150
Tabela 3.8.22: Të menduarit për vetëvrasje	153
Tabela 3.8.23: Ndikimi në rezultatet e nxënësit	154

Pyetësor i mësuesve

Grafiku 3.9.1: Pjesëmarrja sipas gjinisë	158
Grafiku 3.9.2: Pjesëmarrja sipas moshës	160
Grafiku 3.9.3: Pjesëmarrja sipas gjendjes civile	162
Grafiku 3.9.4: Pjesëmarrja sipas nivelit arsimor	164
Grafiku 3.9.5: Pjesëmarrja sipas përvojës	167
Grafiku 3.9.6: A ushtrohet dhunë në shkollë	169
Grafiku 3.9.7: Sa përdoret dhuna	171
Grafiku 3.9.8: Mendoni se dhuna ka ndodhur nga	173
Grafiku 3.9.9: Mendoni se dhuna është	175
Grafiku 3.9.10: Format e dhunës	177
Grafiku 3.9.11: Dhunë ushtrohet mbi	179
Grafiku 3.9.12: Dhunë ushtrohet nga	181
Grafiku 3.9.13: Dhunë ushtrohet në relacionin	183
Grafiku 3.9.14: Kujt i drejtoheni kur keni problem	186
Grafiku 3.9.15: Si ndikojnë rastet e dhunës	188
Grafiku 3.9.16: Mendimi për trajnim mbi dhunën	190
Grafiku 3.9.17: Mendimi për projektet në shkolla	192
Tabela 3.9.1: Pjesëmarrja sipas gjinisë	159
Tabela 3.9.2: Pjesëmarrja sipas moshës	161
Tabela 3.9.3: Pjesëmarrja sipas gjendjes civile	163
Tabela 3.9.4: Pjesëmarrja sipas nivelit arsimor	166
Tabela 3.9.5: Pjesëmarrja sipas përvojës	168
Tabela 3.9.6: A ushtrohet dhunë në shkollë	170
Tabela 3.9.7: Sa përdoret dhuna	172
Tabela 3.9.8: Mendoni se dhuna ka ndodhur nga	174
Tabela 3.9.9: Mendoni se dhuna është	176
Tabela 3.9.10: Format e dhunës	178
Tabela 3.9.11: Dhunë ushtrohet mbi	180
Tabela 3.9.12: Dhunë ushtrohet nga	182
Tabela 3.9.13: Dhunë ushtrohet në relacionin	185

Tabela 3.9.14: Kujt i drejtoheni kur keni problem	187
Tabela 3.9.15: Si ndikojnë rastet e dhunës	189
Tabela 3.9.16: Mendimi për trajnim mbi dhunën	191
Tabela 3.9.17: Mendimi për projektet në shkolla	194

Pyetësor - Prindër

Grafiku 3.10.1: Vlerësimi për dhunën në shkollë	197
Grafiku 3.10.2: Dhuna në shkollë mund të zgjidhet nga prindët	198
Grafiku 3.10.3: Dhuna në shkollë zgjidhet nga profesionistë	199
Grafiku 3.10.4: Përfshirja e prindërve në veprimtaritë e shkollës	200
Grafiku 3.10.5: Mendimi i prindërve për problemet e shkollës	201
Grafiku 3.10.6: Zgjidhja e problemeve të shkollës nga prindërit	202
Grafiku 3.10.7: Njoftimi i prindërve nga drejtori	203
Grafiku 3.10.8: Prindërit pjesë e ekipit për vlerësimin e shkollës	204
Grafiku 3.10.9: Bashkëpunimi - çelësi i formimit të qytetarit global	205

Pyetësor - Mjekët e urgjencës

Grafiku 3.11.1: Kontakte me pacientë të dhunuar	206
Grafiku 3.11.2: Format e dhunës	207
Grafiku 3.11.3: Viktima të dhunës	208
Grafiku 3.11.4 :Identifikimi i personave të dhunuar	209
Grafiku 3.11.5: Trajtim viktimave të dhunës	210
Grafiku 3.11.6: Ndërgjegjësimi mbi dhunën	211
Grafiku 3.11.7: Mendimi mbi dhunën në shkollë	212

Analizë Statistikore

Tabela 3.12.1: Testi i besueshmërisë për nxënësit	213
Tabela 3.12.2: Testi i vlefshmërisë për nxënësit	213
Tabela 3.12.3: Vlerat e korrelacionit ndërmjet variablave dhunë dhe shpeshtësisë	214
Tabela 3.12.4: Niveli i rëndësisë së dhunës në shkollë	215
Tabela 3.12.5. Modeli i shumës së regresit linear	216
Tabela 3.12.6 : Analiza Anova	216

Tabela 3.12.7 : Tabela e koficientëve të standartizimit	217
Tabela 3.12.8 : Testi i besueshmërisë për mësuesit	218
Tabela 3.12.9 : Testi i vlefshmërisë për mësuesit	218
Tabela 3.12.10 : Vlerat e korrelacionit ndërmjet variablave dhunë dhe shpeshtësisë	219
Tabela 3.12.11: Vlerat e korrelacionit ndërmjet dhunës dhe performances	221
Tabela 3.12.13: Vlerat e korrelacionit ndërmjet dhunës dhe rezultateve arsimore	223
Tabela 3.13.14: Ndikimi i dhunës në performancën e nxënësit	224
Tabela 3.12.15: Modeli i shumës së regresit linear	224
Tabela 3.12.16: Modeli i shumës së regresit linear	225
Tabela 3.12.16 : Analiza Anova	225
Tabela 3.12.17 : Tabela e koficientëve të standartizimit	226
Tabela 3.12.18. Modeli i shumës së regresit linear	226
Tabela 3.12.19 : Analiza Anova	227
Tabela 3.12.20: Tabela e koficientëve të standartizimit	227

Analizë e Maturës Shtetërore

Grafiku 3.14.1: Gjuhë Shqipe – Letërsi 2013-2014	246
Grafiku 3.14.2: Gjuhë Shqipe – Letërsi 2013-2014	247
Grafiku 3.14.3: Gjuhë Shqipe – Letërsi në shkallë kombëtare	247
Grafiku 3.14.4: Analiza e shpërndarjes së pikëve në Gjuhë Shqipe - Letërsi	248
Grafiku 3.14.5: Matematikë 2013 - 2014	249
Grafiku 3.14.6: Matematikë 2013 - 2014	249
Grafiku 3.14.7: Matematika 2013 – 2014 në shkallë kombëtare	250
Grafiku 3.14.8: Analiza e shpërndarjes së pikëve në Matematikë	251
Grafiku 3.14.9: Anglisht 2013 – 2014 ..	252
Grafiku 3.14.10: Anglisht 2013 – 2014 ..	252
Grafiku 3.14.11: Lëndët me Zgjedhje Z1& Z2..	253
Grafiku 3.14.12: Nota mesatare e gjimnazit "Remzi Ademaj" Prizren	253
Grafiku 3.14.13: Nota mesatare vjetore sipas viteve e gjimnazit "28 Nëntori" Dibër	354

LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORI

ALCIRT	– Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike
AMA	– Autoritet i Medias Audiovizive
AP	– Arsimi Profesional
BECAN	– Studimi Epidemiologjik Ballkanik mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve
COMBI	– Communication for Behavioral Impact-Komunikim për Ndryshimin e Sjelljes
CRC	– Convent Right Children
CRCA	– Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
DAP	– Drejtoria e Administrimit Publik
DKA	– Drejtorati Komunal për Arsimit
FIQ	– Forumi Iniciativës Qytetare
IEA	– International Association for the Evaluation of Educational Achievement
IJIME	– Journal International Violence in School
ISP	– Information System Preservation
ISCAP	– Instituti i Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
KDF	– Komiteti për të Drejtat e Fëmijës
KEC	– Kosovo Education Center
MASR	– Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
MASHT	– Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MRD	– Metodatat e Reja të Disiplinës
NCDS	– Development British National Child
OBSH	– Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	– Organizata Jo Qeveritare
OSHC	– Organizata të Shoqërisë Civile

PEET	– Pause, Enquire, Engage, Take
PIRLS	– Progress International Reading Literature Study
QHDP	– Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim
QKSA	– Qendra Kombëtare për Statistikat e Arsimit
SMKS	– Sistemet e Matjes së Sigurisë në Komunitet
TIMSS	– Triends in International Mathematics and Science Study
UNICEF	– United Nations Children’s Fund
VIRIS	– Violence Reduction in Schools Programme
VKM	– Vendimi i Këshillit të Ministrave
ZA	– Zyra Arsimore
ZRA	– Zyra Regjionale e Arsimit

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Parathënie

Ideja ime që të punoj si temë doktorature problemin e dhunës ndaj fëmijëve në shkollat e Peshkopisë është se në ditët e sotme dhuna është prezente nëpër shkolla. Në media, mbledhjet e prindërve ka një interesim ndaj kësaj dukurie. Megjithëse dhuna është një fenomen endemik në jetët e fëmijëve të sotëm në mbarë botën, ajo ka mbetur shumë e fshehur, me përjashtimin e rasteve të konflikteve të armatosura. Dhuna kundër fëmijëve në kulturën shqiptare shihet si një mjet për disiplinimin e tyre. Përdorimi i formave të lehta dhe të moderuara të dhunës fizike dhe psikologjike është mjaft i përhapur, por nuk është dokumentuar pavarësisht realitetit shqiptar dhe shihet si mjet disiplinimi. Dhuna është e padukshme, pasi nuk ka asnjë mënyrë të sigurt apo të besuar me të cilën fëmijët apo të rriturit ta raportojnë atë.

Njerëzit nuk kanë besim te policia, shërbimet sociale, autoritete të tjera, nuk ka autoritet të arritshëm ku mund të raportojnë, të dhënat e grumbulluara nuk janë të regjistruara në mënyrë të plotë apo transparente, ka shumë pak të dhëna në dispozicion mbi dhunën në institucionet e përkujdesjes dhe të paraburgimit. Megjithëse mund të dokumentohen incidente të ndryshme shumë institucioneve nuk u kërkohet që ta regjistrojnë dhe ta përcjellin këtë informacion as te prindërit e fëmijëve të përfshirë.

Disiplina është një nga parakushtet e domosdoshme të rritjes së efektivitetit të punës mësimore – edukative. Studimet bashkëkohore theksojnë idenë se:

Disiplina mund të vendoset më mirë jo aq përmes kontrollit të jashtëm të ushtruar nga mësuesi, por përmes stimulimit të vetëkontrollit të nxënësit.

Në të njëjtën kohë theksohet me forcë ideja:

Në rastet kur ushtrohet disiplina është më mirë kontrolli i jashtëm të realizohet përmes përdorimit të stimujve përforcues dhe jo përmes stimujve ndëshkues.

Fakti është se dhuna në shkolla është faktor i joefektivitetit të procesit mësimor – edukativ: frenim i përgjithshëm i nxënësit, që ndëshkohet, sukses i dobët, dhimbje, qëndrim negativ ndaj shkollës, pakënaqësi ndaj sjelljeve agresive dhe braktisje të shkollës.

Nga burime të ndryshme informimi dhe përvoja personale, dhuna në shkolla shfaqet në relacionet: nxënës – nxënës, mësues – nxënës, nxënës – mësues, mësues- mësues, prind –mësues, të jashtëm- nxënës...

Dhuna në shkollë dita - ditës po shënon rritje të rasteve. Detyrë e të gjitha institucioneve përgjegjës dhe në veçanti e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)është që të hulumtojë këtë dukuri negative. Të merren masa për ta parandaluar duke shtuar profesionalizmin, edukimin e drejtë dhe të shëndoshë, këshillëdhënien profesionale ndaj të rinjve dhe të rriturve.

Prioritet i politikës arsimore të Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë (MASR) është: përcaktimi i dukurisë së shfaqjes së dhunës në shkolla, faktorëve, shkaqeve, që nxisin dhe e shkaktojnë, pasojat e kësaj dukurie, ndikimi negativ në mbarëvajtjen e punës mësimore-edukative, kategoria e nxënësve, mosha, gjinia. Këto probleme janë studiuar për të gjetur mjete e metoda sa më efektive për të parandaluar dhunën në shkollë, sepse rritja e keqbërësve në një shoqëri nuk premtan një shoqëri të përparuar e demokratike.

Objekti i hulumtimit të problemit është shfaqja e dhunës në shkollat tona, shkak për një proces mësimor-edukativ jo efikas. Problemi i dhunës është një problem i

ndjeshëm dhe kompleks, të cilin për ta studiuar në tërësi dhe në mënyrë sa më të gjithanshme kërkon një periudhë afatgjatë të një ekipi profesionistësh të fushave të ndryshme. Për Shqipërinë jemi në kohë: 1990 rrëzimi i sistemit komunist, 1997 dështimi i skemave piramidale, 1999 lufta e Kosovës, 2001 lufta e shqiptarëve të Maqedonisë, 2002 - vazhdim ka stabilitet politik dhe shoqëror.

Ndryshimet ekonomike-shoqërore kanë shkaktuar një tronditje të marrëdhënieve tradicionale mes të rriturve dhe fëmijëve si në qytete dhe në zonat rurale. Raportime të shpeshta të dhunës janë dhënë nga media, prindërit, fëmijët dhe mësuesit. Ministria e Arsimit dhe Shkencave nxori një qarkore, e cila hyri në zbatim në dhjetor 2006 dhe ndalonte përdorimin e dhunës në sistemin parauniversitar.

Në zbatim të ligjit nr.7952, dt. 21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", i cili në nenin 1 thekson që: "...Arsimi...kryhet në përputhje me marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Arsimi respekton të drejtat e fëmijëve dhe të rriturve të sanksionuara në këto dokumente"

Dispozitat normative për arsimin parauniversitar, të cilat në nenin 36 "Të drejtat", theksojnë: "Individualiteti dhe dinjiteti njerëzor i fëmijës parashkollor dhe i nxënësit respektohet, ai mbrohet nga dhuna fizike e psikologjike, diskriminimi e veçimi. Në kopsht dhe në shkollë janë kategorikisht të ndaluara ndëshkimet fizike apo trajtimet poshtëruese e denigruese të fëmijëve"(Karaj, 2007:13).

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka përvijuar një plan kombëtar veprimi për të ndaluar dhunën. Qëllimi i këtij plani është që:

Në të gjitha institucionet arsimore dhe edukative të sigurohet një klimë pozitive, ku fëmijët dhe nxënësit të edukohen dhe të mësojnë në kushte të sigurta, larg dhunës, që realizimi i procesit të mësimdhënies, të nxënës të mbështesë dhe të respektojë të drejtat

universale të njeriut, që shkolla të sigurojë një mjedis ku sjelljet e dhunshme ndaj fëmijëve të mos tolerohen, ku të përvetësohen sjellje dhe vlera jo të dhunshme (Karaj, 2007:13).

Unë jam plotësisht e vetëdijshme se nuk kam mundësi të përfshijë në kërkim të gjithë nxënësit e shkollave të Shqipërisë, të gjitha Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore dhe subjektet e tjerë, por nëpërmjet përcaktimit për Gjimnazin Maqellarë, "Said Najdeni" dhe Shkollën Profesionale "Nazmi Rushiti", të cilat do të merren si përfaqësim për tërë shkollat e Peshkopisë në qendrat rurale dhe në zona urbane. Ky studim do të krahasohet me gjimnazet "Remzi Ademaj" Prizren, Kosovë dhe "28 Nëntori" Dibër e Madhe, Maqedoni.

Unë do të përcaktoj nga kërkimi për praninë e kësaj dukurie në shkolla, ndikimin në performancën e nxënësit dhe rezultatet e Maturës Shtetërore. Në bazë të rezultateve të nxjerr përfundimet dhe të përcaktoj rekomandimet për parandalimin, që premtojnë arritjen e objektivave:

1. Të rrisë nivelin e të kuptuarit të dhunës në shkollë, faktorët e rrezikut, të identifikojë gamën e formave të dhunës dhe abuzimit që ushtrohet në shkollën shqiptare.

2. Të bëj zbulime mbi ndërhyrjet për reduktimin e dhunës dhe abuzimit në shkollë.

3. Studimi është kombinim sasior dhe cilësor i natyrës së dhunës në shkollë.

Ai do të shërbejë për demokratizimin e jetës së shkollës dhe europianizimin e arsimit shqiptar.

Studimi është një ndërmarrje e vështirë. Vështirësitë janë të shumta. Ato lidhen me mungesën e studimeve, dhuna shoqërohet me përjetime të pakëndshme, ka kënaqësi

dhe dëshirë të flitet për to. Përkundrazi ka një prirje për të mos u shprehur për dhunën e pësuar dhe të ushtruar edhe kur ajo është e dukshme.

1.2. Shtrimi i problemit

Problemi i dhunës, shfaqja e saj ndaj të tjerëve nuk është një dukuri e ditëve tona, por e ka prejardhjen shumë të hershme. Njerëzit në periudha të hershme nuk kanë patur shkollë, por ndërmjet tyre kanë patur konflikte, kanë shprehur agresivitetin dhe dhunën ndaj njëri- tjetrit. Historiana mëson se dhuna është përcjellur në shkollë me intensitet më të madh ose më të vogël në shekujt që i lamë pas.

Dhunë do të ketë edhe në të ardhmen përderisa të ketë pabarazi dhe trajtim johuman ndaj njerëzve, të rinjve dhe fëmijëve.

Të rinjtë shfaqin dhunë, agresivitetin në shtetet e përparuara demokratike, por gjithnjë ka një shkak.

Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme sjell rrezikshmëri dhe pasiguri për vazhdimin e shkollës.

Si dëshmi për këtë mund të marrin:

Një incident ndodhi në vitin 1927, në të cilin 3 shpërthimet kanë ndodhur në Bath, Township dhe në Michigan të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. 45 persona u vranë dhe 58 u plagosën për shkak të këtyre bombardimeve. Këto 3 shpërthime ishin planifikuar nga Andrew Kehoe.

Kjo nuk është fundi, ka pasur incidente të tjera që kanë ndodhurnë të kaluarën, ku një numër i madh nxënësish në shkolla janë vrarë nga studentë të dhunshëm. Lloje të

tilla të aktiviteteve janë çnjerëzore dhe shkolla duhet të marrë hapin e duhur për t'i shmangur ato.

Në vitin 1992, një incident fatkeq u zhvillua në shkollën e mesme Virginia, ku rezultuan 56 vdekje. Masakra 1999 në shkollë në mesme Columbine, Kolorado ishte ndër incidentet më të llahtarshëm të dhunës në shkollë. Dy nxënës të dhunshëm: Dylan Klebold dhe Eric Harris vranë 1 mësues dhe 12 nxënës, 21 njerëz të tjerë u plagosën dhe në fund vranë veten.

Masakra në Universitetin e Teksasit është shembull i dhunës së tmerrshme në shkollë....

Tragjedia shkollore amerikane vazhdon me 28 viktima në shkollën Sandy Hook – Newtown, Connectika më 14 dhjetor 2012, 5 viktima në Sparks, Nevada më 21 tetor 2013, 2 viktima në Arapahoe – Centennial, Colorado, 2 viktima në Reynolds – Troutdale, Oregon, 5 viktima në Marysville – Pilchuck, Washington.

Dhuna vazhdon në Evropë 17 viktima në Dunblane, Skoci, 2 viktima në Gjermani, 11 viktima në Finlandë, etj..

Incidentet ndëretnike në Strugë, Kërçovë, Tetovë dhe Shkup.

Incidentet në shkollën "Emin Durraku" Prishtinë, Gjimnazi "Arkitekt Sinani" Mitrovicë, rasti "Duda", dy raste në Prizren...

Vrasja e nxënësve në shkollën "Bajram Curri" dhe "Ismail Qemali" në Tiranë, "Perikli Ikonimi" Fier, "Nazmi Rrushiti" Peshkopi, "Naim Frashëri" Durrës, "Beqir Çela" Shkozë, "Sinan Tafaj" Tiranë, dhunimi i mësuesit të gjimnazit Bulqizë nga nxënësi dhe të afërmit, shumë raste të shfaqura në media etj.

Të gjitha këto janë probleme të rënda sociale, që paraqesin pengesë për rrjedhën dhe punën normale të institucioneve edukativo-arsimore në shoqëri. Me qëllim për ta

njohur dhe hulumtuar në detaje problemin e dhunës në shkollë, do të ndikojë pyetësi i nxënësve, mësuesve, prindërve, mjekëve, psikologëve dhe intervistat e përfaqësuesve nga Drejtoria Arsimore Rajonale Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe dhe institucione të Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve. Mendimet dhe qëndrimet e tyre do të jenë me interes, sepse vijnë nga burimet e dorës së parë: prindërit dhe mësuesit janë përherë në kontakt me nxënësit, të cilët çdo ditë mund të hetojnë, të përcjellin raste të dhunës dhe agresivitetit, që ka për bazë përdorimin e forcës fizike a psikologjike ndaj personave të tjerë.

1.3 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë

Pyetjet bazë kërkimore të këtij studimi janë:

- 1. A ekziston dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme të Peshkopisë, Prizrenit dhe Dibrës së Madhe?*
- 2. Kush janë përmasat e dhunës në shkollat e mesme?*
- 3. Sa ndikon dhuna në performancën dhe arritjet e nxënësve ?*
- 4. Si mund të trajtohet nga ana pedagogjike dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme?*

Hipotezë është pikënisje, pohim shkencor për studim të një dukurie a problemi, mendim, gjykim, argumentim i pranuar përkohësisht dhe në mënyrë paraprake si e vërtetë (Murati, 2004: 54).

Për një studim shumëpërmasor të këtij problemi me karakter pedagogjik, sociologjik, psikologjik, ekonomik, etj është politikë sociale, që të shtrojmë hipotezën:

Hipotezat bazë:

1. *Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është në rritje*
2. *Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ndikon në performancë dhe rezultatet arsimore të nxënësit.*

1.4 Debati aktual mbi dhunën

Dhuna është dukuri komplekse dhe shpesh me qëndrim kontradiktor. Ajo që dimë rreth dhunës ndaj fëmijëve varet nga mënyra se si e përkufizojmë atë. Një nga vështirësitë më të mëdha ka të bëjë me atë çfarë është e pranueshme nga ana kulturore si dhunë nga kërkuesit shkencor, ushtruesit dhe përjetuesit e dhunës.

Dhuna është përkufizuar në formë globale, por e veçantë për shkollën shqiptare është se disiplina synohet të vendoset tërësisht me anë të formave të kontrollit të jashtëm, veçanërisht me anë të ndëshkimeve përfshirë edhe dhunën fizike.

Kjo mund të kuptohet po të kemi parasysh: të kaluarën hebraike të shkollës shqiptare, tranzicionin politik dhe ekonomik dhe statusin tepër të irrituar të mësuesit.

Në gjuhën angleze “violence (dhunë)”, në gjuhët latine: spanjisht *violencia*, portugalisht *violência*, italisht *violenza*, frëngjisht *violence*, tërmet në gjuhët e tjera evropiane e kanë burimin gjuhësor mjaft të ndryshëm, si në gjermanisht *gewalt*, greqisht βίαια, gjuha islandeze *ofbeldi*, ose shqip *dhuna*. Madje edhe fjala, si ajo në gjuhën angleze “violence” është e hapur ndaj interpretimeve të ndryshme. Vetë fëmijët

e përkufizojnë dhunën në shkollë në mënyra të ndryshme nga moshë, gjuha dhe kultura e tyre (http://www.unicef.org/tfymacedonia/Violence_Handbook_ALB.pdf).

-Dhuna përkufizohet sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë si përdorim i qëllimshëm i forcës fizike ose fuqisë, i kërcënimit ose përdorimit të saj real kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, forcë e cila çon ose ka mundësi të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose pushtet. (Save the Children, 2007:17)

-Dhuna nga pikëpamja juridike dhe rekomandimet e Asamblesë së Këshillit të Evropë smund të konsiderohet si një dhunim (shkelje) i përgjithshëm i të drejtave të çdo qenie njerëzore, i së drejtës së jetës, sigurisë, dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik e mendor dhe mund të marrë forma të ndryshme ose më saktë, materializohet në forma të ndryshme, si agresion ose sulm fizik, abuzim seksual e përdhunim, kanosje dhe tronditje e thellë ose frikësim dhe duhet të konsiderohet nga e drejta penale, si veprë penale (QNL, 2005:7).

-Dhuna është:

1. përdorimi i forcës fizike për të lënduar ndokënd ose për të dëmtuar diçka;
2. përdorimi jolegal i forcës së paarsyeshme ose efekti i krijuar nga kërcënimi i saj. (Encarta, 1999:1).

-Dhuna ose sjellja e dhunshme është: sjellja agresive ku vepruesi ose autori i krimit përdor trupin e vet ose ndonjë objekt (duke përfshirë edhe armën) për të shkaktuar lëndim ose shqetësim (relativisht serioz) ndaj ndonjë personi tjetër (Olweus, 1999:12).

- Dhunë do të thotë çdo fjalë, shikim, shenjë, ose akt që lëndon trupin, ndjenjat ose mendimet e një personi (Howard, Taylor, 2007:23)

- Dhuna psikike ndikon te nxënësit si trembje, habitet, mbylljes në vetvete e për

këto shkolla është e shqetësuar. Por, edhe “zëri”, timbri i zërit, shpreh dhunë psikike, arrogancë apo një timbër zëri shpreh edhe qetësi dashamirësi, mirëkuptim.(Kraja, 2012:)

-Dhuna është veprim i qëllimshëm për të detyruar tjetrin, me mjete fizike a psikike, tu nënshtrohet interesave, synimeve e dëshirave të dikujt (Grillo, 2002: 62)

-Dhuna është përdorimi i forcës fizike a psikike, duke përdorur mjete e metoda të vrazhda ndaj personit tjetër, me qëllim për ta detyruar të bëjë diçka jashtë vullnetit e dëshirës së tij, përkohësisht për ta nënshtrohet dhe për të shtypur dikë(Fjalor i gjuhës shqipe,2005:234).

-Dhuna nuk qëndron në periferi të historisë europiane, por është një përbërës i rëndësishëm i kulturës perëndimore. (Armanski, 2010:12)

-Dhuna është një seri sjelljesh abuzive ose kërcënuese,që përfshijnë dhunën fizike, emocionale, ekonomike, seksuale si dhe forma të tjera të frikësimit, izolimit dhe shtrëngimit. Është një sjellje e qëllimshme dhe qëllimi i saj është vendosja, ushtrimi i pushtetit dhe kontrolli ndaj dikujt. Efektet e dhunës janë jo vetëm fizike, por edhe emocionale dhe psikologjike te viktimat (Shkurti, 2010: 10).

- Dhuna është shprehje verbale,mimikë apo pantonomi; sjellje apo veprim; i vetëdijshëm ose jo; i një apo më shumë individëve; në një apo më shumë individë, me qëllim kontrolli,nënshttrimi, ndëshkimi si dhe ndryshimi deri në tjetërsim të personalitetit të tjetrit; i edukatës, bindjeve, sjelljeve, qëndrimeve, mentalitetit, kulturës, seksualitetit, dhe përkatësisë gjinore, etnike, fetare, racor, politik, sociale,etj (Deva-Zuna, 2008: 2).

Format e dhunës:

-Dhunë fizike: rrahja (shuplakë, grusht,vizore, objekte të tjerë), pickim, shkulja (veshit, flokëve), gjuajtja me copa shkumësi, mjete të ftohta.

-Dhunë psikologjike joverbale: vështtrim me inat, shikim me fytyrë të ngrysur, qëndrim larg nxënësit që s'na pëlqen, mosaktivizim i nxënësit që nuk pëlqehet.

-Dhuna psikologjike verbale: bërtitja para klasës, sharja, kërcënim me lajmërim të prindit, kërcënim me vështirësi të lëndës, kërcënim me provim, kërcënim me anë të drejtorit, kërcënim me anë të notës, mosvlerësim me notë të merituar, nënvlerësim i përgjigjes, kundërshtim para klasës....

-Dhuna emocionale përfshin një dështim për të siguruar një mjedis të përshtatshëm mbështetje, duke përfshirë disponueshmërinë e një shifër shtojce parësore, në mënyrë që fëmija të zhvillojë një gamë të qëndrueshme dhe të plotë të kompetencave emocionale dhe sociale në krahasim me potencialin personal dhe në kontekstin e shoqërisë në të cilin banon fëmija, shkakton dëmtim shëndetësor, fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe zhvillimit social.

Aktet përfshijnë: kufizimin e lëvizjes, modelet e nënçmimit, denigrimit, kërcënimit, profilit, formave të tjera armiqësore ose refuzimin e trajtimit www.dhunapsikologjike.com (parë me 15 tetor 2012).

-Dhunë seksuale përfshin ngacmimet verbale dhe format fizike të padëshiruara, sjelljet seksuale, ngacmim, shfrytëzim nga nxënësit e tjerë, mësuesit apo personeli i shkollës, përdhunim, ...

-Dhunë ndaj pronës: vandalizmi, vjedhja dhe dëmeve në nxënësit dhe pronën e shkollës.

-Dhunë ekonomike: Mospasja e mjeteve financiare, para ose pasuri e patundshme, humbja e së drejtës së pronës. (QNL, 2005:10)

-Dhuna në media nga tv, interneti, video-lojërat viktimizimi në media (p.sh. duke treguar fotografi private në internet dhe duke përhapur thashetheme përmes telefonave

celularë);filma të dhunshëm, lojërat e dhunshme kompjuterike rrisin potencialin agresiv dhe ka pasoja negative në personalitetin e të rinjve,...

-Dhunë institucionale: institucionet arsimore MASR, DAR, ZA dhe drejtorët e shkollave ushtrojnë presion ndaj personelit pedagogjik për largim nga puna dhe zëvendësimi i tyre me mësimdhënës të rinj (militantë partiakë që kanë mbetë pa punësuar) www.shprehja.com/dhuna-institucionale-ndaj-mesimdhënësve-ne-maqedoni (parë me 9 shtator 2014).

-Dhuna sociale: izolimi i një nxënësi ose një grupi nxënësish dhe shprehet me nënçmime nacionale, fetare, gjinore, financiare etj.

-Dhunë e jashtme (Gang): efektet e bandave, armët dhe luftimet jashtë mjedisit shkollor, konfliktet, trafikim lëndësh narkotike, paqëndrueshmëria politike, brutaliteti i policisë...

-Dhunë etnike apo e komuniteteve, ku droga dhe armët janë pjesë e kulturës rrisin rrezikun e ekspozimit dhe viktimizimit në të dy ambjentet e shkollës.

- Abuzimi është një shembull i veprimeve të vazhdueshme, të cilat kanë si qëllim të poshtërojnë, frikësojnë dhe të kontrollojnë personin tjetër. (Fjalor i gjuhës shqipe, 2005: 235).

-Abuzim dhe keqtrajtim i fëmijëve përkufizohen të gjitha format e keqtrajtimit fizik, emocional, abuzimi seksual, neglizhimi, trajtimi neglizhues, shfrytëzimi tregtar ose çdo shfrytëzim tjetër, që çon në dëmtim real ose të mundshëm të shëndetit të fëmijës, të mbijetesës, të zhvillimit ose dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushteti (Save the Children, 2007:17).

-Abuzim fizik është përdorimi i forcës fizike për të kontrolluar personin duke e shtyrë, qëlluar me shuplakë, goditur, pickuar, mbytur, duke hedhur objekte në drejtim të tyre ose duke kërcënuar atë me armë (Save the Children, 2007: 17).

-Abuzim seksual është përdorimi i fjalëve, veprimeve ose kërcënimeve për të detyruar një person tjetër për t'u përfshirë në aktivitet seksual kundër dëshirës (Save the Children, 2007: 18).

-Abuzim psikologjik është përdorimi i fjalëve ose veprimeve për të izoluar, poshtëruar ose kontrolluar një person tjetër, frikësim, por jo përdorim i drejtëpërdrejtë i forcës fizike ndaj personit tjetër (Save the Children, 2007:18).

-Abuzim emocional është dhunim emocional i fëmijës, që përfshin: diskriminimin, sharjet, britmat, terrorin, përpjekjet për ta izoluar nga bashkëmoshatarët, kufizimin e edukimit, arsimimit, përdorimit të mjeteve audiovizive (pamore dhe dëgjimore) të informacionit, pengimin e marrjes së informacionit dhe komunikimit me të tjerët, inati, mungesa e vëmendjes dhe e mbështetjes shpirtërore (Save the Children 2007:18).

-Ndëshkimi trupor është çdo ndëshkim, në të cilin përdoret forca fizike, me synimin për të shkaktuar një shkallë të caktuar dhimbjeje apo diskomforti sado të lehtë (Save the Children, 2007:17).

-Ndëshkim është një veprim(dënim), që merret ndaj një personi, i cili ka shkelur një rregull apo shfaq një sjellje jo të mirë dhe synon të kontrollojë sjelljen përmes mjeteve negative (Save the Children, 2006: 10).

Ndëshkimi ndahet në fizik dhe verbal(disiplinë negative).

-Ndëshkimi fizik shkakton dhimbje emocionale apo fizike.

-Ndëshkimi verbal bëhet përmes qortimeve dhe mosaprovimeve verbale negative.

-Neglizhimi është lënia pas dore e nevojave fizike dhe emocionale, arsimimit, sigurisë dhe kujdesit mjekësor, të cilat mund të shkaktojnë dëmtim fizik ose psikologjik, shkak kryesor i dëmtimeve ose çrregullimeve fizike, emocionale, psikologjike, zhvillimit social (Fjalor i gjuhës shqipe, 2005:236).

-Trajtim mizor dhe degradues quhen ndëshkime, që vënë në lojë, poshtërojnë, fajësojnë, kërcënojnë, trembin a imitojnë fëmijën.

Presioni nga bashkëmoshatarët. Problemi synon: të vërtetojë suksesin e dobët të nxënësve, qëndrimet negative ndaj shkollës, qëndrimet negative ndaj librit, braktisjen e shkollës dhe ndërrimin e shkollës.

-Torturë është çdo lloj akti, i cili shkakton dhimbje dhe vuajtje si fizike dhe mendore, i cili shtyn në mënyrë të qëllimshme një person për një qëllim të caktuar duke përfutur nga ai apo personi i tretë informacione, duke dënuar atë apo një person të tretë për krimin e kryer apo atë, që dyshohet të ketë kryer, apo duke e kërcënuar, e detyruar të flasë, apo për çdo arsye bazuar në ndonjë tip diskriminimi, kur kjo lloj dhimbje apo vuajtje bëhet nën shtypjen, aprovimin ose dijeninë e zyrtarëve publikë apo personave të tjerë, që veprojnë në kapacitete zyrtare. Ajo nuk përfshin asnjë lloj dhimbje apo vuajtje, që vjen vetëm për shkak të trashëgimisë apo është e rastësishme për shkak të masave të ligjshme (Save the Children, 2005: 19).

-Dhuna në shkollë është një sjellje agresive me synimin të shkaktoj dëmtim fizik a psikik tek tjetri brenda institucioneve arsimore www.dhunapsikologjike.com.

-Dhuna në shkollë përfshin shumë më tepër se vetëm përdorimin e armëve. Ajo përfshin: goditjen në korridore, thirrje të emrave, që çojnë luftëtarë në tribuna lojërash brenda shkolle; frikësimi dhe rrëmbimi i ushqimit dhe parave të viktimave; vetëvrasja, që mund të shkaktoj individin, familjen dhe shkollën si të tërë; forma të ngacmimit

seksual, që disa mësimdhënës dhe administratorë nuk i kanë vënë re ose i kanë pranuar si "natyrale", sjelljet në mes fëmijëve dhe adoleshentëve dhe dhuna sistematike e mishëruar në politikat shtrënguese të shkollës www.dhunapsikologjike.com.

-David Mayers studiues i psikologjisë sociale thekson: "Shkak i sjelljes agresive është shpërblimi nga agresiviteti duke theksuar në përfitimet e mundshme, që mund të nxjerrë shkaktuesi i sjelljeve të dhunshme brenda shoqërisë si: frikësimin e të tjerëve për realizimin e qëllimeve të caktuara, dëmtimin fizik dhe psikik" www.dhunapsikologjike.com.

Sipas Mayers "Fëmijët, që kanë prindër ndëshkues kanë prirje për t'u sjellë agresivisht me të tjerët. Prindërit e tyre zakonisht i dispijlojnë me britma, shuplaka ose rrahje duke bërë agresionin një mënyrë për t'u përballur me gjërat" www.dhunapsikologjike.com.

-Sjelljet e dhunshme të nxënësve në shkolla kanë të bëjnë me gjendjen ku të rinjtë janë në mesin e tre kulturave të ndryshme ose kodesh të sjellurit shtëpisë-rrugës-shkollës.

Rruga ka një imazh mistik, që fëmijëve u pëlqen, ata e dinë që kjo kulturë do t'i çojë drejt vdekjes, por në të njëjtën kohë ajo i pajis me një ndjenjë mirëqenie psikologjike dhe sociale.

Sot në epokën e dixhitalizimit të informacionit mundësitë e komunikimit dhe njohjes me këto "kultura", familjarizimi me to dhe praktikimi në formë origjinale në kushte të tjera është shumë i lehtë www.dhunapsikologjike.com.

-Ndryshimi i sjelljes së sistemit është më i vështirë se ndryshimi i sjelljes së individit. Përgjegjësit institucional të ndërhyjnë në sistemin arsimor për kontrollimin, orientimin dhe kanalizimin e potencialeve rinore në kahun e duhur

www.dhunapsikologjike.com.

-Ndalimi i dhunës në shkolla varet jo vetëm nga ndryshimi i shkollës, por edhe të sistemit të aktorëve (fëmijë, familje, shkollë) www.dhunapsikologjike.com.

-Nëse ne mundemi të dërgojmë njeriun në Hënë, pse nuk mund të ndalim dhunën në shkollat tona? www.dhunapsikologjike.com.

Pyetje e një studenti drejtuar Presidentit Klinton 1993.

1.5 Përmbledhje e shkurtër e literaturës, avantazhet/kufizimet e saj

Studimi i doktoraturës në UET më ka plotësuar me kulturën pedagogjike të kërkimtarit shkencor.

Gjithashtu jam mbështetur në raportet hulumtuese të lidhura me vende në të gjithë botën, nga revista të shumta në botë dhe nga Konferenca e Katërt Botërore për Dhunën në Shkollë.

Studimi është gjithëpërfshirës dhe gjatë shqyrtimit të literaturës jam përballur me të njëjtat vështirësi të studiuesve të përbashkët për të marrë një pamje të plotë të diversitetit global.

Shumë programe dhe ndërhyrje janë publikuar dhe diskutuar në gjuhë të tjera përveç anglishtes. Për fat të keq, unë jamkufizuar në botimet e gjuhës angleze, në studime të mëdha shkencore (të tilla si Web of Science dhe PsychInfo) duke përdorur internetin si dhe në revista dhe konferenca shkencore në vendet e Evropës, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Amerikës së Jugut, Azisë, Australisë dhe Ballkan, që më është mundësuar si kërkimtar shkencor gjatë studimeve të doktoraturës duke u ndjerë një qytetar i denjë global.

Politikat zero-tolerancë, përdorimi i sigurisë elektronike (p.sh. video kamera, sensorë, detektorë metali), sistemi i kamerave dhe rojet profesionale do të jenë pjesë e zgjidhjes së dhunës në shkollë.

Një nga dukuritë që vihet re është që dhuna trajtohet më shumë nga organizatat jo qeveritare dhe media. Mungojnë dokumenta strategjikë dhe ligje për dhunën në shkollë nga institucionet shtetërore si Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pjesëmarrja në Konferenca Shkencore, botimet në Revista Shkencore, pozicioni sikordinatore e Institutit të Zhvillimit të Arsimit, Institutit të Kontrollit të Arsimit Parauniversitar, Organizatave jo Qeveritare për Peshkopinë, përvoja personale si mësuese në gjimnaz dhe Përgjegjëse e Sektorit të Kulturës Edukimit Komunikimit dhe Çështjeve Gjimore Bashkia Dibër, anëtare e Bordit Këshillimor për Projekte Ndërkufitare më mundësojnë shfrytëzues:

Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), Drejtoria Arsimore Rajonale, Zyra Arsimore, Organizata Jo Qeveritare: "Partnerë për Fëmijët", UNDP ALBANIA, CRCA Shqipëri, "World Vision", "Save the Children", Qendra Psikologjike "FRENA" Prizren, Bashkia Dibër, Komuna Dibër e Madhe, Bordi i shkollës dhe Qeveria e nxënësve.

Kufizimet: Dhuna është shkaku kryesor i vdekjes dhe paaftësive të fëmijët, (më shumë viktima se kanceri dhe aksidentet automobilistike). Shtrirja gjeografike e studimit, ngarkesa mësimore, mosbashkëpunim me psikologët, mungesë statistikash, mosadaptim i mësuesve tradicionalë, mungesë informacioni, qeveria e nxënësve jo funksionale, keqpërdorimi i trajnimeve, mostransparencë,

Shkelja e të drejtave të njeriut, por më e pa adresuara, pasi ndodh “pas dyerve të mbyllura”.

Faktet tregojnë se pavarësisht se në fazën e “qetësimit” të dhunuarit mendojnë se “nuk do të ndodhë më”, kjo nuk është e vërtetë! Dhuna përsëritet me përmasa dhe shpeshtësi më të madhe. Ajo mund të shkojë deri në marrjen e jetës së personit. Vrasja e Krenar.B e bëri shkollën një vend tjetër në qiell.

“Përkundër fjalimeve të bukura në kryeqytetet e botës, nuk është aspak automatike që bota të bëhet më e kujdesshme ose më tolerante ose që njerëzit do të largohen nga mënyra e tyre për të ndarë burimet e tyre ose për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë.

Maqellara ishte një qendër e madhe.

Unë jam tashmë duke pritur për udhëtimin tim të ardhshëm në Peshkopi” -

Brian Williams

Projekti është zgjidhje ndaj virusit, që po zgjeron kufijtë dita-ditës dhe pasojat janë katastrofike.

1.6 Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave të hulumtimit

Ky studim shtrihet në shkollat më të mëdha të rajonit. Të dhënat janë mbledhur gjatë vitit 2014 dhe shkollat janë përgjigjur përmes pyetësorëve për dukurinë e dhunës në shkollën e tyre.

Natyra e punimit është hulumtuese dhe analitike. Mbledhja e të dhënave është realizuar përmes pyetësorëve të shpërndarë tek nxënësit, mësuesit, prindërit dhe mjekët në 5 shkolla të Peshkopisë, Prizrenit dhe Dibrës dhe përmes intervistave me ekspertë të institucioneve. Përpunimi i të dhënave është realizuar përmes programit SPSS Statistics 17.0. Analiza përshkruese, cross-tabulation dhe analiza e regresionit përbëjnë komponentët kryesorë të analizës së rezultateve të këtij studimi, testimit të hipotezave dhe nxjerrjes së konkluzioneve përfundimtare.

Objekt i studimit do të jetë:

"Gjimnazi Maqellarë", Gjimnazi "Said Najdeni", Shkolla e Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti" Peshkopi, Gjimnazi "Remzi Ademaj" Prizren dhe Gjimnazi "28 Nëntori" Dibër e Madhe.

Zgjedhja e kampionit do të bëhet në këtë popullacion.

Studimi realizohet në 2 faza:

Faza 1: Përcaktohen çështjet, që do të studiohen përmes diskutimeve me grupet e fokusuara të nxënësve dhe mësuesve. Pilotimi i çështjeve dhe ndërtimi i pyetësorit.

Faza 2: Administrimi i pyetësorit në masën e nxënësve, mësuesve, prindërve, psikologëve, mjekëve dhe intervistës me 20 të intervistuarit që janë zgjedhur nga pozicionet më të larta në institucionet e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve.

Ata u gjykuan se kanë më tepër përvojë profesionale dhe përgjegjësi aktuale.

Përpunimi i informacionit dhe shkrimi i temës.

Të dhënat e grumbulluara përpunohen me anë të programit statistikor kompjuterik EXCEL 2010 dhe SPSS Statistics 17.0.

1.7. Vlera shoqërore e studimit

Parandalimi i dhunës në shkolla është jo vetëm nevojë e praktikës, por edhe interes i shkencës në dobi të shoqërisë, edukimit dhe arsimimit të drejtë institucional jo me dhunë dhe forma të tjera të dhunës. Shoqëria me mekanizmat duhet të bëjnë të pamundurën që të mos lejojnë të përhapet dhuna në shkollë, të ushtrojnë profesionalizmin dhe edukimin ta bëjnë sa më cilësor, me qëllim që të rinjtë të kultivojnë njerëzoren si dhe të veprojnë njerëzishëm kudo.

Studim bashkëpunues që do të sjellë së bashku studiuesit dhe politikëbërësit nga i gjithë rajoni, të përdorë metoda dhe instrumente që do të ndihmojnë në teorinë e dhunës dhe përpjekjet rajonale për të reduktuar dhunën në shkollë.

Studimi i ndërmarrë është udhëhequr nga parimet e Konventës së të Drejtave të Fëmijës, të cilat e vënë theksin në të drejtën e fëmijëve për paprekshmëri fizike dhe psikologjike, në detyrimin e mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e dhunës përfshirë dhunën fizike, psikologjike, seksuale, trajtimin jonjerëzor dhe ndëshkimin.

Ky është i pari studim i kryer mbi dhunën në shkollën e mesme në arsimin shqiptar dhe do të shërbejë si një platformë për të mësuarit, monitorimin e dhunës në shkollë në perspektivë rajonale.

Një nga funksionet e rëndësishme të studimit të dhunës në shkollë në vende të ndryshme është që të lejojë krahasime ndërmjet shteteve Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Të dhëna të tilla krahasuese mund të të përdoren për të fituar perspektivë të situatës së dhunës në shkolla që mund të jetë ekstrem në një vend të dhënë dhe në disa vende situata është më pak e rëndë se të tjerët.

Studimi i dhunës në shkollat e mesme në masë të madhe lehtëson krijimin e politikave mbi dhunën shkollore në Bashkinë Dibër, Prizren dhe Dibër e Madhe.

Një studim rajonal sjell vëmendje të faktorëve, që janë kryesisht të fshehura nga ndërgjegjësimi, kur studimet janë bërë brenda sistemit arsimor kombëtar.

Realizimi i një studimi të tillë i shërben njohjes së dukurisë të dhunës në shkollat e mesme, mundësimit të dhënies së rekomandimeve për aktorët, që veprojnë në këtë fushë dhe rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit publik për dëmtimet e dhunës të fëmijët.

Mostrat janë marrë nga nivelet ekonomike, arsimore, rajonale, ndërhyrjet do të kenë më shumë informacion mbi dallimet brenda kulturave në bazë të këtyre karakteristikave.

Qeveria, Agjencitë Arsimore, Bordi i shkollës të mobilizohen për të krijuar politika, trajnime dhe ndërhyrje të projektuara për të reduktuar normat e dhunës

Strategjitë parandaluese mund të bazohen në vetëdijen, Këshillin e Disiplinës, Kodin e Etikës, Kodin e Sjelljes, veprim të rreptë ligjor për shkeljen e ligjit, etj.

Fushatat e ndërgjegjësimit mund të organizohen brenda mjedisit shkollos me pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe prindërve të tyre.

Personeli i mësimdhënies duhet të jetë i trajnuar sipas nevojës së kohës, që të kuptojnë nevojat psikologjike të nxënësve.

Emërimi i një psikologu profesionist brenda mjedisit shkollos, një këshilltar privat që mund të jetë prind apo nxënës dhe oficeri i sigurisë është domosdoshmëri.

Demokratizimi i arsimit dhe çrrënjësja e dhunës në shkollë është standard i europianizimit të arsimit shqiptar.

PJESA E PARË: KUADRI TEORIK

KAPITULLI II: SHQYRTIM LITERATURE

2.1 Dhuna – shkollat teorike

Dhuna është një dukuri komplekse, prandaj për të qenë në hap me kohën kemi studiuar teoritë më shkencore ose akademike të dhunës: teoria patologjike e konflikteve, teoria e pabarazisë, teoria e sistemeve të përgjithshme, teoria sociobiologjike, teoria subkulturore, teoria ekologjike, teoria e këmbimit, teoria e burimeve, teoria patriarkale, teoria e të mësuarit social, teoria e evolucionit, teoria psikopatologjike. E përbashkëta e studimit me teoritë është integrimi i studimit për reduktimin dhe parandalimin e dhunës fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme.

2.1.1. Dhuna në shkollë në një kontekst ndërkombëtar është një thirrje për bashkëpunim global në kërkim dhe parandalim të saj.

Konferenca e Pestë Ndërkombëtare mbi Dhunën në Shkollë dhe Revista Ndërkombëtare mbi Dhunën në Shkollë janë të rejtat më të fundit.

Nuk duhet të harrojmë se dhuna në shkollë është një fenomen global. Në vende me kultura të ndryshme si Japonia, Jordania, Finlanda, Brazili, Norvegjia, Izraeli, Malajzia, Kolumbia, Afrika e Jugut, SHBA dhe Etiopia janë të alarmuar nga akte të tmerrshme të dhunës së pakuptimtë në shkolla. Një nga të rejtat e kohëve të fundit është incidenti tragjik në Finlandë, ku një person i armatosur dhe i maskuar hapi zjarr në

shkollën e tij, duke vrarë 10 njerëz, duke djegur disa nga trupat e tyre dhe duke vrarë veten. Ky është rast i përsëritur nga incidenti në Finlandë ku la 11 viktimë.

Të dy ishin të hipnotizuar nga 1999 në Columbine të Kolorados.

Me internetin, mediat dhe kulturën e globalizuar një incident në një shkollë në një cep të botës mund të ketë një efekt shkatërrues në shumë shkolla në mbarë botën.

Rezultatet negative të ndarjes së lajmit të keq për dhunën në shkolla tani janë në vendin tonë.

Pyetja që ne duhet të përballemi:

A do të jemi ne në gjendje që nëpërmjet levave të kemi ndërrvarësi rajonale për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për të parandaluar dhunën në shkollat tona?

Qëllimi i këtij studimi është për bashkëpunim në kërkimin rajonal e global për të krijuar themelin teorik dhe empirik në përpjekjet për të parandaluar dhunën në shkollë.

Akiba dhe bashkëpunëtorët e kanë shtrirë dhunën në perspektivë globale duke deklaruar:

“Dhuna në shkollë është një fenomen global që prek një nga institucionet kryesore moderne dhe shoqërinë në një farë mase në pothuajse të gjithë Shtetet e Bashkuara të Amerikës ”(Akiba, LeTendre, Baker dhe Goesling, 2002:830).

Ndërsa dhuna në shkollë është përjetuar dhe studiuar gjerësisht në vendet e zhvilluara në Evropë, SHBA, Australi dhe nuk është e kufizuar në shoqëritë e industrializuara. ”(Ohasko, 1997: 7).

Sipas Raffael, K., & Linda, M. (1999), bashkëpunimi në arsim erdhi me qëllim shkëmbimin e informacionit midis familjeve dhe profesionistëve. Gjithashtu, edhe “studime të ndryshme shkencore theksojnë se nuk duhet pritur që prindërit të krijojnë njohuritë e duhura për ti ndihmuar fëmijët e tyre si nxënës, ose për të kontaktuar me

shkollën/mësuesit, por se duhet të jetë shkolla ajo që i informon dhe përfshin prindërit nëpërmjet programeve të partneritetit shkollë-familje-komunitet” (Bezati dhe Hoxhalari, 2011 : 4).

“Bashkëpunimi shkollë familje në parandalimin e dhunës ndaj nxënësve në shkollë”, ku përcakton se dhuna është në një “barazi gjinore” , shkolla nuk ka strategji për bashkëpunim me familjen dhe parandalimin e dhunës dhe kemi dallime të theksuara tek rezultatet mes mjedisit urban dhe atij rural, ato nuk janë domethënëse në ndryshueshmëri të rezultateve (Sylaj, 2014 : 164).

Një përmbledhje e raporteve nga e gjithë bota sugjeron fuqimisht se kjo çështje është një shqetësim real në mjediset e ndryshme në të gjithë botën.

Në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare mbi Dhunën në Shkollë prezantuesit e dhunës ishin prej më shumë se 50 vende nga të gjitha kontinentet dhe përshkruan fenomene që ishin në të njëjtën kohë shumë të ngjashme dhe të lidhura në mënyrë unike në kontekstin e tyre specifik.

Në të vërtetë, unë kam marrë pjesë në konferenca shkencore, kam vizituar shkolla, bisedova me nxënësit, personelin pedagogjik dhe raporte të shumta të dhunës në shkollë janë goditur nga kontradikta.

Nga njëra anë, ekziston një shkallë e konsiderueshme e ngjashmërisë së sigurisë në shkollë në vende të ndryshme dhe në njëjtën kohë është e habitshme se si dhuna të ndryshme janë unike në shkollë.

Tregimet mund të jetë brenda secilit prej këtyre kombeve dhe kulturave. Një ekzaminim ndërkombëtar mund të kontribuojë në kuptimin se variablat e dhunës në shkollë janë unike për çdo kulturë.

Ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet dhe brenda vendeve informojnë në masë të madhe teoritë, politikat publike dhe sistemet e mbrojtjes për ndërhyrjet ndaj dhunës në shkollë.

Puna empirike e kryer nëpër vende të ndryshme mund të shërbejë si bazë për përpjekjet ndërkombëtare bashkëpunuese dhe për të promovuar sigurinë në shkolla në mbarë botën.

Në këtë studim i njoh kontributet potenciale ndërkombëtare dhe perspektivat ndërkulturore të studimeve ndërkombëtare.

Dhuna në shkollë në këndvështrim ndërkombëtar

Unë jam mbështetur në analiza të studimeve të shumta empirike dhe publikime, që shqyrtojnë dhunën në shkollë në një gamë të gjerë të vendeve p.sh., Akibba et al, 2002.; Currie, Roberts, Morgan, Smith, Settertobulte, Samdal, dhe Rasmussen, 2004; De Miranda, Ferriani dhe Zito, 2007; ESLA, Menesini, Morita, O'Moore, MOEA-Merchan, Pereira dhe Smith, 2003; Smith, 2003; Smith, Cowie, Olafsson dhe Liefoghe, 2002; Oahsko, 1997; Smith, Morita, JUNGGER-Tas, Olweus, Catalano dhe Slee, 1999 <http://www.ijvs.org/files/Revue-07/04.-Benbenishty-Ijvs-7.pdf>.

Gjithashtu jam mbështetur në raportet e kërkimeve shkencore të lidhura me vende në të gjithë botën, nga revista të shumta në botë dhe nga Konferenca e Katërt Botërore për Dhunën në Shkollë.

Një nga sfidat në krahasimet kombëtare është fakti që raportet shpesh nuk japin informacion të detajuar në lidhje me metodat dhe instrumentet e përdorura për të marrë shifrat e raportuara.

Me përjashtim të raporteve në revista akademike, Organizatës Botërore të Shëndetësisë detajet rreth sondazheve janë sporadike dhe vështirë për të vlerësuar rigorozitetin metodologjik të studimit si mostrat, instrumentet e përdorura, etj.

Pse dhuna në shkollat e mesme shihet si një perspektivë ndërkombëtare dhe ndërkulturore?

2.1.2 Ngritja e vetëdijes dhe vendosja e prioriteteve.

Një nga funksionet e rëndësishme të dhunës në shkollë në vende të ndryshme është që të lejojë krahasime ndërmjet shteteve.

Të dhëna të tilla krahasuese mund të përdoren për të fituar perspektivë të situatës së sigurisë në shkolla që mund të jetë ekstrem në një vend të dhënë dhe në disa vende situata është më pak e rëndë se të tjerët.

Kjo në masë të madhe lehtëson krijimin e politikave mbi dhunën shkollore në qarqet specifike.

Për shembull, në Izrael, gjetjet e studimeve ndërkombëtare kanë qenë përdorur për të dramatizuar situatën. Në një seri të raporteve për dhunën ndaj të rinjve në faqen e parë gazetave e përditëshme paraqitnin një tabelë, që rrjedhin nga një studim ndërkombëtar (TIMSS), që i përshkruan studentët izraelitë si viktimë të niveleve të larta të dhunës psikologjike në krahasim me pjesën tjetër të botës. Qeveria, organizatat e mësuesve, komitetet qeverisëse janë mobilizuar për të krijuar politika, trajnime dhe ndërhyrje të projektuara për të reduktuar normat e dhunës në Izrael <http://www.ijvs.org/files/Revue-07/04.-Benbenishty-Ijvs-7.pdf>.

Duke përdorur të njëjtat të dhëna nga TIMSS, në anën tjetër të oqeanit, Akiba(2002) dhe bashkëpunëtorët argumentojnë arsimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Audienca e kërkimit shkencor dhe publiku amerikan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë duke përjetuar nivele të ngjashme ose më të larta të dhunës në shkollë si shumë vende të tjera.

Ky këndvështrim global ndihmon vendet në renditjen e tyre nga media të lidhura me dhunën në shkollë.

Krahasime të tilla mund të kenë një ndikim të fortë mbi publikun brenda vendit.

Studimi krahasues tregoi se dhuna në shkollë në Itali është raportuar në një nivel më të lartë se sa në vendet e Evropës Perëndimore (duke qenë gati 2 herë më i lartë se në Angli dhe 3 herë më e lartë se në Norvegji) (Menesini dhe Modiano, 2003:185).

Autorët pretendojnë se gazetatat dhe programet televizive për këto të dhëna kanë sjellë ndërgjegjësimin në shkollat italiane. Drejtorët e shkollave dhe stafi filluan të jenë të interesuar në Itali për ndërhyrjet dhe për të studiuar çështjen e sigurisë në shkollë.

Kjo mënyrë ndërgjegjësimi është përsëritur në shumë vende në të gjithë globin, kur media raporton norma të larta të dhunës në shkollë në krahasim me vendet e tjera.

2.1.3 Listë globale ndërhyrjesh dhe politikash.

Një perspektivë ndër-kulturore e dhunës në shkollë ofron një burim të pasur të njohurive rreth politikave dhe ndërhyrjeve. Ndërhyrje të caktuara që ekzistojnë në disa kultura dhe jo në të tjerat do të jenë shumë të dobishme për të kuptuar dinamikën kulturore të dhunës në shkollë.

Nga raportet në publikimet e kërkimit theksohet programet e ndërmjetësimit. Programet kundër Olweus 'dhe Smith janë më të zakonshme në Evropë, SHBA, Australi, ndërsa programet e drejtësisë janë më të zakonshme në Australi dhe Zelandën e Re.

Politikat zero-tolerancë, përdorimi i sigurisë elektronike (p.sh. video kamera, sensorë, detektorë metali) dhe rojet profesionale janë më të zakonshme në SHBA.

Në këtë epokë globale të komunikimit, konferencave të shumta ndërkombëtare, mbështetje të vlerësimeve empirike, pothuajse të gjitha ndërhyrjet e sigurisë në shkollë janë të pranishme në vende të shumta. Listë e ndërhyrjeve të përdorura në secilin vend dhe informacioni për suksesin e tyre do të jenë të dobishme në të kuptuarit e përhapjes, miratimin e ndërhyrjeve të caktuara në të gjithë globin, identifikimin që ndërhyrjet mund të jenë më efektive në disa vende dhe jo në të tjerët.

2.1.4 Rritja e kontributeve të teorisë.

Një perspektivë ndërkombëtare mund të kontribojë dukshëm në teoritë e dhunës në shkollë.

Teori të avancuara për të shpjeguar dhunën në shkollë në një kulturë mund të informojnë dhe të stimulojnë kërkime krahasuese në vende të tjera.

"Teoritë e avancuara mbi faktorët që kontribojnë në ngacmimin" kanë shqyrtuar literaturën japoneze dhe faktorët që kontribojnë ndaj dhunës në shkollë. Marrëdhënia mes klasës si një grup shoqëror dhe faktin se sjellja e dhunshme kryhet nga një grup shokësh të klasës kundër nxënësve individualë. Roli i mësuesve japonezë dhe praktikat mësues-nxënës kontribojnë në sjelljet e dhunshme (Yoneyama, Naito 2003:123).

Analiza cilësore e në shkollat e mesme të Japonisë, lidh këtë grup sjelljesh jo vetëm në mungesën e mekanizmave të kontrollit në klasë, por edhe me mungesën e marrëdhënieve të besueshme në mesin e shokëve të klasës (<http://www.ijvs.org/files/Revue-07/04.-Benbenishty-Ijvs-7.pdf>).

2.1.5 Hipoteza dhe propozimet teorike të avancuara në Japoni

Sipas studimit duhet të informojmë dhe të pasurojmë zhvillimin teorik në vendet e tjera që ndryshojnë karakteristikat specifike të sistemit arsimor.

Sipas kulturës japoneze marrëdhëniet e besueshme në mesin e kolegëve apo kontrole më të forta sociale do të përjetojnë më pak dhunë në shkollë (<http://www.ijvs.org/files/Revue-07/04.-Benbenishty-Ijvs-7.pdf>).

Revista Ndërkombëtare e Dhunës në Shkollë (IJIME) dhe Akiba (2002) shfrytëzojnë të dhënat e sondazhit ndërkombëtar TIMMS në viktimizimin e nxënësve në 37 vende.

Ata testuan dy grupe të variablave në nivel kombëtar.

- a. Parashikues të njohur të krimit në përgjithësi
- b. Faktorët që lidhen me sistemin arsimor.

Puna e tyre tregon se faktorët trashëgohen në sistemin arsimor (p.sh. arritjet akademike) janë parashikues më të mirë të dhunës në shkollë se sa parashikimi i krimit të përgjithshëm kombëtar, kushtet ekonomike dhe karakteristikat demografike.

Lloje të caktuara të viktimizimit shkollor (p.sh.sulmet seksuale) janë të lidhura me nivelet e krimit në komunitet më shumë se llojet e tjera (Akiba 2002).

Në një studim në Izrael, në të cilat lloje të rënda të viktimizimit në shkollë ishin të lidhura më shumë me lagjet e varfra (Khoury-Kassabri. Benbenishty. Astor. Zeira. 2004: 231).

Konkluzionet dhe testimi në vende të tjera mund të ndihmojnë të përsosin një teori mbi dhunën politike dhe të komunitetit në shkolla (Benbenishty. Astor. 2005:436).

Këto gjetje ndërkulturore empirike çuan përpara teoritë ekzistuese mbi marrëdhëniet midis viktimizimit dhe faktorëve strukturorë që lidhen me shkollën dhe mjedisin e saj.

2.1.6 Çështje teorike që trajtohet nga perspektiva globale

Ndikimet relative shkollë, familje, shoqëri dhe kulturë ndaj dhunës në shkollë.

Një sistem ndërkombëtar ka bërë apel ndaj kërkuesve shkencorë për studimin e dhunës në shkolla.

Dhuna në shkollë (Akiba et al. 2002; Benbenishty. Astor. 2005; Furlong. Morrison. 2000; Yoneyama. Naito. 2003).

Teoritë e dhunës studiojnë dhunën në dy mënyra kryesore.

1. Njerëzit nuk motivohen për të vepruar dhunshëm.
2. Dështimi parandalohet nga kontrolli dhe vetëkontrolli shoqëror.

Teoritë e dhunës ndahen: teoria patologjike e konflikteve, teoria e pabarazisë, teoria e sistemeve të përgjithshme, teoria sociobiological, teoria subkulturore, teoria ekologjike, teoria e këmbimit, teoria e burimeve, teoria patriarkale, teoria e të mësuarit social, teoria e evolucionit, teoria psikopatologjike.

Teoria patologjike apo shoqërore shpjegon konfliktin dhe zgjidhjen e tij nëpërmjet komunikimit human.

Teoria e pabarazisë është shumë e avancuar, shpjegon agresionin, dhunën, pabarazitë, privilegjet, hierarkitë, diskriminimin, shtypjen, disa njerëz janë të motivuar të abuzojnë, të shfrytëzojnë, të përfitojnë nga inferiorët shoqërorë, të motivojnë ata persona, që i nënshtrohen inferioritetit, të rezistojnë dhe të rebelohen me dhunë kundër statusit të tyre. Shpjegime të dhunës janë të bazuara në ekonomitë politike të pronës private dhe të zhvillimit kapitalist (Iadicola dhe Shupe 1998: 35).

Teoria e sistemeve të përgjithshme shpjegon agresionin dhe dhunën si ndërveprime të individëve, familjeve dhe sferat shoqërore (Straus 1978: 341).

Nivelet optimale të dhunës janë të nevojshme për të ruajtur dhe riprodhuar sistemin, grupe të ndryshme të faktorëve të sjelljes, duke përfshirë: nivelet e larta të dhunës në familje, integrimi i dhunës në personalitetin dhe sjelljen, normat kulturore që dhuna të jetë e ligjshme dhe organizimi i familjeve dhe shoqërisë (<http://www.ijvs.org/files/Revue-07/04.-Benbenishty-Ijvs-7.pdf>).

Teoria sociobiologjike është përdorur për të shpjeguar përdhunimin, abuzimin e fëmijëve, vrasjen e fëmijëve dhe formave të tjera të dhunës në familje (Alexander 1974; Daly. Wilson 1981; Lightcap. Kurland. Burgess 1982).

Teoria subkulturore shpjegon dhunën gjinore (O'Leary 1988).

Teoria ekologjike zhvillimore që koncepton dhunën si bashkëveprim ndërmjet disa nënsistemeve përkatëse përshkruan këtë lloj të teorisë si një teori ndërvepruese (Goldstein 1994).

Ky zhanër i teorive konsideron sjelljen e njeriut si një "duet" mes tipareve personale të personit dhe ndryshimeve kontekstuale e mjedisore (sociale dhe fizike).

Ky mjedis mund të përfshijë qeniet e tjera njerëzore që janë të përfshirë në situatë (nxënës, mësues) dhe gjithashtu përfshin mjedisin fizik (shkolla, madhësia e klasës, struktura e shkollës,...).

Teoria e këmbimit është analizë kosto - përfitim e dhunës (Gelles 1983: 157).

Teoria e burimeve dhunën në familje e sheh si një produkt të mungesës së kufizimeve të jashtme.

Teoria e burimeve argumenton se kryefamiljari ka fuqinë më të madhe si: të holla, pronë, prestigj, force, urdhëron pushtetin më të lartë në marrëdhëniet martesore dhe familjare, gratë dhe fëmijët janë në pozicione vartëse dhe të rrezikuara (Blood.Wolfe 1960).

Bindja dhe pajtueshmëria janë tipare të preferuar.

Modeli deduktiv teorik që e vendos shkollën në qendër të modelit.

Ligje që përfshijnë shkollën (karakteristikat strukturore, klima sociale dhe politika kundër dhunës), lagje (varfëria, organizimi shoqëror, krimi), familjet e nxënësve (arsimi, struktura e familjes), aspektet kulturore të nxënësve dhe mësuesve (feja, përkatësia etnike), emigrimi ekonomik, social dhe politik të vendit në tërësi (Astor. Benbenishty.Vinokur. Zeira.2002, 2004,2006).

Çështja e kontekstit social dhe fizik është i rëndësishëm për perspektiva ndërkombëtare për disa arsye të rëndësishme.

Sot është thelbësore për të parë rezultatet e krahasimeve midis kulturave për të kuptuar rrethanat që çojnë në dallimet, ku shpesh interpretimet çorientuese mund të shmangen (<http://www.ijvs.org/files/Revue-07/04.-Benbenishty-Ijvs-7.pdf>).

Në kuadër të mediave popullore ka shpesh një tendencë për të dhënë gjetjet që lidhen me dhunën në vende të caktuara dhe kulturat për a) një karakter kombëtar b)

pranimin kulturor të dhunës c) shpjegime të tjera shkakore shumë përmasore (përkatësia fetare, raca, arritjet arsimore).

Duke krahasuar nivelet dhe karakteristikat e dhunës në shkollë brenda grupeve kulturore që kanë rrethana të ndryshme socio-politike do të kontribuojmë në të kuptuarit e rolit tonë relativ. Një mënyrë është që të rrisim numrin brenda-grupit të studimit.

Për shembull, në qoftë se mostrat janë marrë nga nivelet ekonomike, nivelet arsimore, ndoshta rajon, teoritë tona dhe ndërhyrjet do të kenë më shumë informacion mbi dallimet brenda kulturave në bazë të këtyre karakteristikave.

Mund të ketë dallim të madh strukturor dhe organizativ ndërmjet shkollave në vende të ndryshme.

Përmbledhje e dhunës në 24 shkolla evropiane nga Smith më 2003.

Studimi ka zbuluar dallime të mëdha në moshën e nxënësve që fillojnë shkollimin, strukturën e sistemit të arsimit sipas moshës së nxënësve dhe nga tipet e shkollave (fillore, të shkollave të mesme dhe shkollave të mesme të larta).

Italia ka tre sektorë të moshës (6-11; 11-14; 15-19), Irlanda ka vetëm dy (4-11; 12-18). Në disa vende nxënësit fillojnë shkollimin në moshë të re, ndërsa në vende të tjera ata hyjnë në një mjedis formal arsimor.

Në disa vende evropiane përqindja e "përsëritësve" ndryshojnë ndërmjet vendeve në Evropë.

Dallimet strukturore midis vendeve mund të kenë shumë pasoja mbi nivelet dhe karakteristikat e dhunës në shkollë (Journal International Violence in School - 7 Decembre 2008:68).

Prania e madhe e nxënësve në klasë që janë 'përsëritës' (mundet më shumë se një herë) për shkak të dështimit akademik, të cilët janë më të mëdhenj mund të kenë një

ndikim të rëndësishëm mbi atë se sa të sigurtë ndjehen nxënësit e tjerë. Një studim ndërkombëtar sjell në vëmendje faktorë që janë kryesisht të fshehur nga ndërgjegjësimi, kur studimet janë bërë brenda sistemit arsimor kombëtar.

Perspektiva ndërkombëtare për dhunën në shkollë: dhuna në shkollë mund të jetë një përcaktues i rëndësishëm në procesin arsimor që është lënë pas dore në shumicën e kërkimit për performancën e nxënësve. Studimet e kohëve të fundit nga Ammermueller. Pischke. 2006, Hanushek. 2003, Hoxby. 2000 i kanë kushtuar shumë vëmendje ndikimit të performancës, statusit social, racor apo gjinor dhe arritjeve të nxënësve.

Literatura shkencore tregon se dhuna në shkollë ka shumë forma dhe lloje.

- verbale: nofkat, fyerjet raciste, mallkim;
- sociale: izolimi i një studenti ose një grupi studentësh;
- dhuna media: viktimizimi në media (duke treguar fotografi private në internet dhe duke përhapur thashetheme përmes telefonave celularë); filma të dhunshëm, lojërat e dhunshme kompjuterike,...
- fizike: dhuna moderuar fizike duke i shtyrë dhe tërhequr, rrahje
- pronës: vandalizmi, vjedhja, dëmeve në nxënësit, pronën e personelit dhe shkollës
- seksuale: ngacmimet verbale, format fizike të padëshiruara, sjelljet seksuale, ngacmim, shfrytëzim nga nxënësit e tjerë, mësuesit apo personeli i shkollës, përdhunim,...
- armë: thika xhepi, doreza hekuri dhe armë

- e jashtme (Gang): efektet e bandave, armët dhe luftimet jashtë mjedisit shkollor, konfliktet, trafikim lëndësh narkotike, paqëndrueshmëria politike, brutaliteti i policisë...
- etnike apo komuniteteve ku droga, armët janë pjesë e kulturës rrisin rrezikun e ekspozimit dhe viktimizimit në të dy ambientet e shkollës.

Të gjitha këto forma të shumta të dhunës në shkollë mund të jenë të rëndësishme dhe të lidhura në shumë diskutime ndërkombëtare. Dhuna në shkollë është një fenomen global dhe ekziston një nevojë e qartë për të filluar një studim të vazhdueshëm në mbarë botën e shkollës (Journal International Violence in School - 7 Decembre 2008: 76).

2.2 Dhuna në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Dhuna është në rritje në mesin e të rinjve në shkollë dhe në pjesën më të madhe të botës. Sot është shumë e zakonshme për të lexuar në lajme rreth dhunës që ndodh brenda një shkolle. Rastet e rrahjes së nxënësit nga një tjetër janë shumë të zakonshme për tu dëgjuar. Raporti Washington Post njofton se në shkollën e mesme në Hart tre mësues janë rrahur dhe sulmuar me armë gjahu. Në shkollën e mesme Dunbar C vetëm 17 % e nxënësve mund të lexojnë dhe pjesa tjetër janë të përfshirë në aktivitete të dhunshme në shkollë. Mungesa e mësuesve, lufta për gjetjen e personit të duhur, vonesat e ndërtimit të shkollave janë disa nga faktorët më të zakonshëm të dhunës në shkollë. Jo vetëm djemtë, por vajzat janë të përfshirë edhe në aktivitete të dhunshme që po ndodhin në shkolla. Sipas Washington Post në shkollën e mesme Dunbar policia

arrestoi 19 vajza pas një sërë aktiviteteve të dhunshme dhe e njëjta gjë në shkollën e e mesme Anacostia.

Kjo është mjaft shqetësuese, sepse qeveria nuk po merr hapat e nevojshëm për të përmirësuar kushtet në shkollat e mesme publike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për një të ardhme më të mirë autoritetet kombëtare duhet të mbajnë qëndrim kundër dhunës.

2.2.1 Mite dhe fakte rreth dhunës në shkollë

Sot ka shumë të vërteta që janë të dukshme për dhunën në shkollë, por gjithashtu ka edhe shumë mite që ekzistojnë rreth dhunës në shkollë. Shumë lëvizje globale dhe programe shkollore janë duke u krijuar për të ndihmuar rreth dhunës në shkollë për edukimin e prindërve, nxënësve rreth miteve, që vazhdojnë nën dritën e përpjekjeve informative dhe edukative.

Miti 1: Dhuna në shkollë ndodh vetëm në mesin e nxënësve që nuk mësojnë.

Dhuna në shkollë prek të gjithë fëmijët pa dallim race, shtrese sociale, ekonomike dhe rajoni gjeografik. Kjo do të thotë se nxënësi nuk është i sigurt nga dhuna në shkollë vetëm për shkak se ata marrin pjesë në një shkollë të shtrenjtë apo vazhdojnë studimet jashtë vendit.

Miti 2: Dhuna në shkollë është shkaktuar nga fëmijët, që vijnë nga shtëpitë me probleme..

Ka shumë raste kur dhuna në shkollë shpërthen në mes të nxënësve, të cilët kanë prindër me arsim të lartë dhe kanë siguruar për fëmijët e tyre më të mirën. Me fjalë të tjera, dhuna në shkollë nuk tregon klasën sociale.

Miti 3: Nëse ju nuk doni probleme, ju duhet vetëm të shikoni dhunën në shkollë si mënyrë tjetër e reagimit.

Duke u kthyer larg dhe duke pretenduar se nuk e keni parë dhunën në shkollë vetëm rrit mundësinë që jo vetëm do të ndodhë përsëri, por herën tjetër dhuna mund të përshkallëzohet dhe më shumë nxënës mund të dëmtohen ose të vriten. Ka institucione ku mund të raportoni dhunën pa u rrezikuar të dëmtoheni.

Miti 4: Nëse ju injoroni dhunën në shkollë, ajo thjesht do të shkojë larg në kohë.

Dhuna ka tendencë të vazhdojë të përshkallëzohet, shpeshherë duke i dhënë autorit të veprës nxitje të adrenalinës apo ndjenjë të rreme të pushtetit mbi ata, që janë viktimizuar. Nxënësit, që kryejnë akte të dhunshme në shkollë duhet të trajtohen. Sa më shpejt, më mirë!

Miti 5: Fëmijët, që kryejnë akte të dhunshme në shkollë, duhet të jenë larg përgjithmonë.

Ka një numër të madh arsyesh të ndryshme pse fëmijët sillen në mënyrë të dhunshme në shkollë. Gjetja e shkakut të sjelljes së tyre dhe trajtimi i shkakut është e vetmja zgjidhje logjike. Përgjashtimi nga shkolla dhe burgosja për akte të dhunshme vetëm e mbështet pohimin se arsimi dhe shoqëria kanë dështuar para nxënësve që kryejnë akte të tilla.

Miti 6: Nuk ka zgjidhje të dhunës në shkollë.

Çdo ditë zgjidhjet janë duke u sjellë në tryezë për të ndihmuar në zvogëlimin dhe eliminimin e dhunës në shkollë. Edukimi i prindit, mësuesit, nxënësit dhe komunitetit se si mund t'iu shërbejnë më mirë nxënësve, të cilët mund të kenë tendenca të dhunshme. Viktimat janë një pjesë e zgjidhjes, sepse është duke u punuar për të bërë shkollat më të sigurta për nxënësit dhe personelin pedagogjik në të gjithë botën.

2.2.2 Dhuna në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Askush nuk ka lindur i dhunshëm. Një fëmijë bëhet i dhunshëm për shkak të mjedisit që i është dhënë. Prindërit, mësuesit dhe shkolla së bashku mund të krijojnë një nxënës me qëndrim të drejtë, por kjo mund të bëhet vetëm duke ofruar mjedis të sigurtë dhe kujdesin për nxënësin. Nëse një nxënës është nën depresion të rëndë apo nën ndonjë lloj të stresit dhe ankthit atëherë ai mund të vuaj nga problemi i sjelljeve të dhunshme.

Vrasjet me armë në shkollë janë duke u rritur dita ditës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Historia është plot me të tilla incidente, ku nxënësit kanë krijuar panik në shkolla duke shfaqur sasi të madhe të dhunës në shkollë.

Nxënësit e dhunshëm të shkollës kanë vrarë, kërcënuar, ngacmuar, luftuar me nxënësit e tjerë, mësues dhe drejtorë. Ata janë duke përdorur armë zjarri dhe armë të ftohta që kërcënojnë nxënësit e tjerë.

Sjellja e dhunshme përfshin: ngacmim, kërcënim, rrahje, vjedhje, vandalizëm, etj

Një incident ndodhi në vitin 1927, në të cilin 3 shpërthimet kanë ndodhur në Bath, Township dhe në Michigan të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. 45 persona u vranë dhe 58 u plagosën për shkak të këtyre bombardimeve. Këto 3 shpërthime ishin planifikuar nga Andrew Kehoe.

Ky nuk është fundi, ka pasur incidente të tjera që kanë ndodhur në të kaluarën, ku një numër i madh nxënësish në shkolla janë vrarë nga studentë të dhunshëm. Lloje të tilla të aktiviteteve janë çnjerëzore dhe shkolla duhet të marrë hapin e duhur për t'i shmangur ato.

Në vitin 1992, një incident fatkeq u zhvillua në shkollën e mesme Virginia, ku rezultuan 56 vdekje. Kjo ishte me siguri një nga ngjarjet më të turpshme në historinë e sistemit arsimor amerikan.

Masakra që ndodhi në vitin 1999 në shkollën e mesme Columbine, Kolorado ishte ndër incidentet më të llahtarshëm të dhunës në shkollë. Dy nxënës të dhunshëm: Dylan Klebold dhe Eric Harris vranë 1 mësues dhe 12 nxënës, 21 njerëz të tjerë u plagosën dhe vranë veten në fund.

Sjellja e dhunshme duhet patjetër të shmanget në nivelin e shkollës. Nëse fëmijët janë në nivel të lartë të dhunës në këtë moshë, atëherë imagjinoni në çfarë do të kthehen ata kur do të rriten?

Masakra në Universitetin e Teksasit është shembull i dhunës së tmerrshme në shkollë

Pse dhuna në shkollë është mjaft e njohur në shkollat e mëdha?

A ka ndonjë specialitet me sjelljen dhe qëndrimin e nxënësve që shkojnë në shkollat e mëdha?

Problemet e mëdha që rezultojnë për dhunën në shkolla përfshijnë probleme ndërpersonale, dëshirë për hakmarrje, mosmarrëveshje të bandës, diskriminim racor, izolim nga grupi i kolegëve dhe disa çështje psikologjike.

Shumica e njerëzve besojnë se ngacmimi është një element i mesëm i jetës shkollore, por nuk është kështu. Nëse nuk marrim kujdesin në kohën e duhur, atëherë mund të çojë në sjellje agresive nga të dyja anët dhe gjakmarrja bëhet vlerë. Sipas një studimi 14% e nxënësve të origjinës së Kaukazit kanë qenë viktimë e ngacmimit në vitin 2003-2004. Sipas një raporti klinik nxënësit, të cilët ngacmohen normalisht nga shokët e tyre kanë tendencë për sjellje të dhunshme. Kjo është thelbësore sepse

ngacmimi fizik, mendor apo seksual do të ketë një ndikim të thellë negativ në mendjen e personit.

Fakt: luftërat mes bandave janë gjithashtu të zakonshme dhe në zona të ndryshme urbane. Bandat normalisht përfshijnë adoleshentë. Ndonjëherë këta adoleshentë vizitojnë shkolla të tjera vetëm në mënyrë për të sulmuar anëtarin e bandës rivale dhe kërcënojnë jetën e të tjerëve.

Veprim i saktë mund të parandalojë pasoja serioze që ndodhin më vonë.

2.3 Dhuna në shkollat e Evropës

Dhuna në shkollë është një problem serioz në shkollat e vendeve të ndryshme të Evropës. E rëndësishme të theksohet se dhuna në shkollë është një problem, që krijon panik në mesin e nxënësve. Për shkak të dhunës shumica e nxënësve nuk duan as të shkojnë në shkollë. Me fjalë të tjera frika e dhunës në shkollë është në nivelin që të humbasin interesin e tyre në studime. Dhuna në shkollë jo vetëm ndikon te nxënësit, por edhe te mësuesit. Ajo po krijon shumë probleme për mësuesit, prindërit dhe shoqërinë.

2.3.1 Tendencat historike të dhunës në shkollat evropiane

Ka një perceptim të përbashkët se dhuna është në rritje, duke përfshirë dhunën në shkolla. E vërteta është shumë komplekse. Jo gjithmonë perceptimet përputhen me realitetin. Personat e moshuar i kujtojnë ditët në të supozuarën “koha e artë”, kur gjërat ishin më mirë, ka patur më pak dhunë ose krim ndaj të miturve një ose dy gjenerata të

mëparshme. Nëse shohim gjendjen e një ose dy gjeneratave të tjera, janë raportuar të njëjtat shprehje të brengës nga Pearson më 1983.

Nuk ka të dhëna të krahasueshme në Evropë për treguesit e krimit dhe sigurisë në shkollë. Departamenti Amerikan i Arsimit ka bërë thirrje të përsëritura për të dhëna të tilla që të mblidhen në gjithë Evropën sipas parametrave të zakonshme për krahasim dhe identifikim të trendeve nga Qendra Kombëtare për Statistikat e Arsimit, Departamenti Amerikan i Arsimit: *Treguesit e krimit dhe sigurisë së shkollës*, Washington DC 2003.

Në sondazhet e vendeve të raportuara tek Smith 2003, nuk ka pasur aq të dhëna në dispozicion në lidhje me tendencat me kalimin e kohës. Vende që kishin të dhëna kanë raportuar ndryshime të vogla ose vetëm një rritje shumë të vogël të dhunës në shkolla (Gjermania, Norvegjia), me rritje kthesore pastaj zbritje (Italia) dhe me rezultate të përziera në varësi nga lloji i dhunës (Austria).

Në Europë, ka pasur disa studime mbi dhunën ndaj mësuesve. Një raport i 1997: "Mbi dhunën kundër mësuesit në shkollat franceze"- tregoi se dhuna fizike ndaj mësimezhënësve nga studentët meshkuj ishte më e mundshme, një "gjyq i fuqisë ", një përpjekje për mbizotërim fizik, ku 44% e viktimave ishin mësues dhe 56% mësuese.

Në anën tjetër, 58% e viktimave të dhunës verbale ishin mësues, 42% mësuese dhe mësimezhënësit mes moshës 50 dhe 60 vjet ishin të mbi-përfaqësuar (Pinheiro, 2006:124).

Sondazhet tek Smith 2003 tregojnë se disa veprime janë provuar në secilin shtet. Disa janë nisma nacionale, disa janë rajonale ose lokale dhe disa në shkolla individuale. Veprimet e shkallës më të gjerë janë shpesh programe të zhvilluara mirë

që mund të përfshijnë punën e programit mësimor, punën individuale me nxënësit në rrezik dhe masa të tjera.

2.3.2 Kërkesat nacionale, nismat dhe programet

Programi Daphne

Projektet në fushën e dhunës në shkollë të mbështetur nga Programi Daphne nga viti 1997 ndahen në katër kategori kryesore:

1. projekte që synojnë për të parandaluar ngacmimet dhe dhunën.
2. nisma që përdorin shkollën si një vend për arsimim kundër-dhunës.
3. projekte që përqëndrohen në fuqizimin e mësimdhënësve dhe personelit arsimor si aktorë në mbrojtjen e fëmijëve.
4. zhvillimi i studimeve dhe mjetet në fushën e dhunës në shkollë.

"RESPEKTIMI" ishte një projekt 1vjeçar më 1997 i drejtuar nga Shoqata Metodiste e Klubeve Rinore në Mbretërinë e Bashkuar me partnerë në Suedi dhe Irlandë.

Qëllimi ishte për të mobilizuar të rinjtë që të punojnë kundër dhunës dhe në veçanti kundër ngacmimit.

Rëndësia e ndërgjegjësimit për ngacmimin dhe dhunën u theksua edhe në projekte të tjera me mesazhe të rëndësishme për fëmijët, të rinjtë dhe ata që punojnë me ta.

Një projekt i udhëhequr nga Jovenes Sin Fronteras në Francë dhe Skoci krijoi fushatat e ndërgjegjësimit publik mbi ngacmimin në shkollë.

Një projekt i koordinuar nga OJQ-ja gjermane Wildwasser Oldenburg. V më 1998 u përqëndrua në çështjen e dhunës seksuale ndaj adoleshenteve vajza dhe mësueseve, trajnim, materiale të zhvilluara të informacionit, paketa trajnuese dhe një konference ndërgjegjëse.

"Programi kundër - ngacmim" i Olweus është përdorur në Norvegji (së bashku me iniciativat e tjera), Austri, Finlandë dhe Gjermani. Programi është shqyrtuar në Islandë.

"Programi për shkolla të sigurta" është përdorur gjerësisht në Portugali dhe Britani të Madhe.

"Programi i sigurimit" është zhvilluar në rajonin spanjoll të Andaluzisë/Seviljes dhe Farsta të Suedisë. Këto programe janë të përshkruara mirë me broshura, materiale për personelin dhe nxënësit dhe kanë forma të standardizuara. Ekziston një nivel i vlerësimit të efektivitetit të mundshëm të programit. .

Studim TIMSS (Triends in International Mathematics and Science Study - Studimi Ndërkombëtar i Trendeve në Matematikë dhe Shkencë) u krye në njëmbëdhjetë vende evropiane: Belgjika, Qipro, Angli, Hungari, Itali, Letoni, Lituani, Holandë, Norvegjia, Skoci dhe Slloveni. Studiuesit kanë bërë pyetje të ngjashme për nxënësit rreth dhunës në shkolla.

Studimi Kombëtar i Zhvillimit të Fëmijës (NCDS Development British National Child) është një studim i thellë nga Brown dhe Taylor më 2005.

Studimi tregon se ngacmimi dhe dhuna fizike ka një ndikim negativ në arritjen më të lartë arsimore, tregun të punës dhe të ardhurat.

Konferenca EEEPE në Paris u bë arenë të dhënash të studimeve mbi dhunën në shkollë.

2.3.3 Kongrese shkencor, konferenca, akte, ligje...

Forma të tjera të dhunës në mjedisin e shkollës janë të lidhura me bandat e dhunës së rrugës. Në disa vende kjo është e njohur si "dhuna reprezalje", shantazh, përfshirja në drogë, mbajtja e armëve në shkollë.

Në qershor të vitit 2008 kryeministri britanik, Gordon Brown, kërkoi miratimin e ligjeve për të luftuar krimin në rritje.

Mbajtja e thikës mbi 16 vjeç do të përballlet me ndjekje penale automatike dhe rrezikon një dënim me burgim deri katër vjet.

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës në 2003 miratoi Rekomandimin 135 për partneritetet lokal në parandalimin dhe luftimin e dhunës në shkollë. Përparësi i jepet mbrojtjes dhe ndihmës së viktimës, ekuilibër mes parandalimit dhe reagimit, lidhjen midis dhunës në mjedisin e shkollës, faktorëve të jashtëm duke përfshirë prindërit, komunitetet lokale për të parandaluar dhunën dhe njihet " Shkolla si e tërë ”.

Në vitin 1998 Observatori Evropian mbi Dhunën në Shkollë i bazuar në Universitetin e Bordos mori hapat e parë për krijimin e një Federate Ndërkombëtare të Studiuesve mbi Dhunën në Shkollë.

Konferenca e Parë Ndërkombëtare e Dhunës në Shkollë u mbajt në Paris në vitin 2001.

Konferenca e Dytë Ndërkombëtare e Dhunës në Shkollë u bashkë-organizua nga Qendra De Rechercheet d'Intervention sur la Réussite Scolaire më 2003 në Quebec,

Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Dhunës në Shkollë u mbajt në Bordo më 2006.

Konferenca e Katërt Ndërkombëtare e Dhunës në Shkollë u mbajt në Mbretërinë e Bashkuar në 2007 bashkëorganizuar nga Observatori në Mbretërinë e Bashkuar për Promovimin e jo-dhunës www.ukobservatory.com.

Konferenca e Pestë Ndërkombëtare e Dhunës në Shkollë u mbajt në Otava në 2009.

Konferencat Ndërkombëtare dhe Revista Ndërkombëtare mbi Dhunën në Shkollë IJIME (Journal International Violence in School) janë të rejtat më të fundit.

Traktate ndërkombëtare për dhunën që lidhet me mjedisin shkollor nuk ka; tre nenet 19.28 dhe 29 të Konventës së OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC)

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, i ngritur në kuadër të KDF, ka theksuar nevojën për forcimin e lidhjeve në mes shkollës, familjes, komunitetit për t'i dhënë fëmijës një rol aktiv në parandalimin dhe për të trajtuar format e ndryshme të dhunës në mënyrë gjithëpërfshirëse. Ai ka bërë të qartë në mënyrë të përsëritur se përdorimi i ndëshkimit trupor dhe kufizimet e rrepta në disiplinën shkollore nuk respektojnë dinjitetin e lindur të fëmijës.

Komiteti theksoi se “Fëmijët nuk i humbasin të drejtat e tyre njerëzore me kapërcimin e pragut të shkollës” www.unviolencestudy.org.

Studimi kishte një sërë rekomandimesh gjithëpërfshirëse në lidhje me dhunën kundër fëmijëve në mjedisin shkollor.

2.3.4 Politikat e shkollës dhe rregullat e klasës


Rezultat i kërkesave ligjore në nivel kombëtar ose pasojë e programeve të strukturuar në vazhdim (Programi kudër ngacmim i Olweus-it) është të zhvilluarit e politikave arsimore ose rregullave të klasës që të merren me dhunën dhe të nxisin të ndihmuarit e viktimës.

Në Britaninë e Madhe theksi bie më shumë në politikat arsimore, në Austri, Holandë përqendrimi më i madh është në zhvillimin e rregullave të klasës. Një tipar dallues është se ato japin një mundësi për konsultime mes personelit, nxënësve me

bashkësinë e shkollës për politikën e shkollës. Personeli i shkollës ka një rol jetik në zhvillimin e rregullave të klasës ose politikave të shkollës duke përfshirë nxënësit.

Një studim i kohëve të fundit në Hollandë ka bërë përpjekje që të përcaktoj sasinë e nivelit të ngacmimit seksual të kryer nga mësuesit dhe nxënësit 14-15 vjeçarë në shkollat e mesme dhe tregon nivele shumë të larta nga Timmerman më 2003.

Nga shqyrtimi i literaturës së ngacmimit Stassen Berger më 2005, sugjeron se ngacmimi është një problem i rëndësishëm në të gjitha vendet, niveli i normës do të ndryshojë në varësi të vendit dhe moshës.



Grafiku 2.1: Klasifikimi i vendeve sipas frekuencës së sjelljeve agresive

Berger vë në dukje variacione brenda vendeve. Fëmijët flemisht në Belgjikë ka të ngjarë të thonë se ata janë më shumë dhunues se viktimë, por fëmijët francez në Belgjikë pretendojnë të kundërtën. Statistikat kombëtare mund të mos jenë plotësisht përfaqësuese dhe në studimet e ndërmarra në fusha të caktuara duhet të jemi të vetëdijshëm se një komunitet fqinj mund të ketë një ndërgjegjësim më të madh për trajtimin e dhunës psikologjike. Normat më të larta janë gjetur në Maltë, Portugali dhe

Turqi. Stassen Berger bën shpjegim interesant në lidhje me normat e larta të dhunës psikologjike që gjenden në Portugali.

Kultura në Portugali ose historia mund të inkurajojë sjelljet agresive, por e konsiderojnë një detaj të politikës arsimore: nxënësit në klasën e 6 duhet të përsërisin klasën nëse nuk kalojnë testin. Si pasojë, të paktën 10% e të gjithë klasës së 6 (më shpesh djem) janë përsëritës dy vjet ose më shumë. Nxënësit përsëritës kanë dy herë më shumë shanse që të jenë dhunues se mesatarja e klasës. Ky është studim nga Pereira. Mendonça. Neto. Valente. dhe Smith më 2004).

Një përqindje më e lartë e tyre janë emigrantë nga familjet me të ardhura të ulëta. Dështimi akademik, prejardhja familjare, statusi socio-ekonomik ose gjinia ndikojnë në nivelin e përqindjes portugeze, apo jo financimi në shkollë, dizajni i varfër i ambienteve sportive është pjesërisht për të fajësuar?

Pa të dhëna dhe analiza asnjë shkencëtar nuk mund të arrijë në përfundimin se kultura portugeze promovon ngacmimin nga Karen Moore. Nicola Jones and Emma Broadbent më 2008.

Shumë programe të vlefshme nga qendrat hulumtuese evropiane dhe të Britanisë së Madhe kundër dhunës në shkolla dhe botimeve si *"Dhuna në shkolla: Reagim në Evropë"* nga Peter Smith më 2003. Studimi ka pasur një mungesë të dukshme të ndikimit në shkolla.

(http://www.unicef.org/tfymacedonia/Violence_Handbook_ALB.pdf).

Shembull i punës aktuale në Britaninë e Madhe është Programi për Reduktim të Dhunës në Shkolla (Violence Reduction in Schools Programme - VIRIS) në kuadër të Departamentit të Arsimit në Angli merr në konsideratë koleksionin e gjerë të përvojës në Evropë, këmben rregulla dhe praktika përmes një programi të bashkëpunimit

ndërqeveritar me Ministrinë e Arsimit të Francës. Programi VIRIS, është studim në shkollat Angli dhe Evropë, që pretendojnë të kenë zgjidhje të identifikuara të dhunës në institucionet e tyre. Studimi analizon arsyet se pse këto zgjidhje të dukshme duhet të jenë efektive. Metodologjia e kërkimit përfshin analiza të shkakut pa të cilat analizat e prirjes do të jenë më pak të nevojshme për praktikuesit në shkolla. Rezultati në Angli do të jetë botimi i udhëzuesit të rishikuar për të gjitha shkollat së bashku me materialet për trajnim të personelit në të gjitha nivelet. Kjo punë ka zbuluar themelin e bashkëpunimit me nevojat e kolegëve praktikues evropian dhe ka bërë të vetëdijshëm ekipin e programit se sa pak dinë ata për përvojat e suksesshme në shtetet e tjera.

Mundësitë për këmbimin e praktikave të mira përmes takimeve dhe shkëmbimeve. Ky informacion është vetëm majë e ajsbergut, kur është fjala për vargun e ushtrimit efektiv në Evropë. Përkundër epërsisë së pashmangshme të shembujve nga Anglia dhe Republika e Irlandës, janë bërë të gjitha përpjekjet që të përshtatin punën në kuadër të shkollave evropiane dhe veçanërisht këtë ua kemi borxh Peter Smith, Helen Cowie dhe Mona O'Moore për njohuritë e tyre në perspektiva aktuale evropiane në bazë të punës së tyre shumëvjeçare në Evropë. Megjithatë, ata na kanë paralajmëruar në mënyrë të vazhdueshme për atë që nuk është përfshirë. Punë mbresëlënëse dhe shumë e rëndësishme është zhvilluar në Skoci në kuadër të Programit Daphne <http://www.ltscotland.org.uk>.

2.3.5 Masat e përgjithshme

Disa nga nismat nuk fokusohen drejtëpërdrejt në dhunë, por në përmirësimin e faktorëve parandalues të dhunës.

Dita e Parlamentit.

Danimarka ka Ditën e Parlamentit, ku nxënësit mund të ngrenë zërin për shqetsimet në shkolla dhe të përcaktojnë politikat që duhet të ndiqen ndaj dhunës në shkolla.

"Ditë Parlamentare" është bërë përpjekje të ketë në Francë dhe Suedi. Disa programe janë dizajnuar për të përmirësuar klimën e shkollave, klasave përmes edukimit të personelit, arsimit të zgjeruar personal dhe social të nxënësve. "Programi për aftësi në jetë" është zbatuar në Islandë. Disa tendenca në Holandë dhe Norvegji sugjerojnë se është konsideruar si më premtues se sa programet, të cilat përqendrohen në mënyrë specifike në dhunë dhe frikësim. Studim i kryer nga Roland dhe Galloway më 2004.

Përmirësimi i mjedisit shkollor për reduktimin e dhunës

Ambienti fizik i shkollës është një faktor i rëndësishëm për shfaqjen e mundshme të incidenteve të dhunshme. Një faktor mund të jetë rreziku i sherreve të vogla si të ndeshurit e rastësishëm në korridore, stresi gjatë pritjes së gjatë në marrjen e ushqimit apo ndërrimit të kabineteve, etj. Fushat e sportit mund të ndërtohen ndryshe dhe të jenë më lakmuese, në mënyrë që të largojë monotoninë dhe mundësinë e akteve të dhunës si rezultat i argëtimit, kur nuk ka asgjë më të mirë për t'u bërë. Faktori më i rëndësishëm në mjedisin fizik të shkollës të paktën për dhunën mes nxënësve është mbikëqyrja nga të rriturit. Pamja e mirë e vendeve të përdorura nga nxënësit si dhe trajnimi i mbikëqyrësve gjatë pushimeve, nëse atë detyrë nuk e bën personeli ka mundësi të jenë e dobishme.

Programet dhe aktivitetet mësimore

Ekziston një përdorim i gjerë i materialeve të dizajnuara për të ngritur vetëdijen në lidhje me dhunën, ngacmimin, për të ndryshuar sjelljet, sugjeruar mjetet dhe

përballimin e tyre si: literatura, teatri, filmat dhe videot. Kohëve të fundit ka zhvillim të materialeve multi – mediale dhe aktivitete, si CD-ROM-et dhe ndërveprime në ambiente virtuale. Studim i kryer nga Wolke. Ekzistojnë disa programe për mësim të aftësive sociale dhe emocionale, Pacific Primary Programme (i mundshëm vetëm në gjuhën franceze dhe angleze) dhe Programi SEPS në Angli. Dëshmitë sugjerojnë se këto janë të dobishme në punën kundër dhunës, por vetëm si komponent i një programi më të gjerë të ndërhyrjeve.

Të ndihmuarit individual të nxënësve në rrezik për të qenë të dhunshëm

Disa ndërhyrje parandaluese më tepër përqendrohen tek disa nxënës, të cilët janë në rrezik. Këto mund të përfshijnë një skemë "karta e raportit pozitiv" (e përdorur në Belgjikë), trajnim në kompetencë sociale dhe aftësi sociale, trajnim të ngritjes së vetëbesimit dhe gjetja e mënyrave për rritje të vet-respektimit të nxënësve (Programi Pathways në Irlandë). Programet si qasja "No Blame – Pa akuza" nga Maines dhe Robinson 1992 ose "Metoda e ndarjes së përgjegjësisë" nga Pikas 2002 janë mënyra të strukturuar ku nxënësit agresiv dhe arrogant mund të inkurajohen për ndryshim të sjelljeve të tyre.

Mbështetja për viktimat e dhunës

Ekziston një shumëllojshmëri e mënyrave për mbështetje të viktimave të dhunës. Programi i përgjithshëm mësimor mund të ndihmojë për zhvillim më të madh të sjelljes për përkrahje të grupit të nxënësve viktimë të dhunës nëpërmjet Klubeve të Dhunës.

Do të ishte ideale kombinimi i seminareve dhe konferencave mbarë evropiane të cilat do të diskutonin për dhunën në shkollë.

Ndërsa këto përfaqësojnë përparime të rëndësishme, ka ende sfida të rëndësishme të zbatimit, veçanërisht në aspektin e vëmendjes së kufizuar të dhunës seksuale dhe në baza gjinore nga Witkowska, Menckel më 2005.

(http://www.unicef.org/tfymacedonia/Violence_Handbook_ALB.pdf).

2.4. Dhuna në shkollat e Kosovës

Vrasjet, plagosjet dhe rrahjet që kanë ndodhur kohët e fundit në shkolla dhe jashtë shkollave kanë qenë shqetësuese për qytetarë dhe institucione dhe kanë filluar të bëhen si dukuri shoqërore. Rastet e dhunës që paraqiten në shkollat e Kosovës janë në forma të ndryshme si: fyerje, rrahje, ngacmim gjinor, trajtim jo human, deri te rastet me ekstreme që kanë përfunduar me epilog fatal vrasjet me armë të ftohta dhe armë zjarri. Shqetësuese mbetet fakti që jemi në fillim të vitit 2014 dhe për dy muaj kemi 3 vrasje, që tregon se gjendja e sigurisë në shkolla është alarmante dhe kërkon trajtim urgjent nga institucionet e vendit. Përdorimi i narkotikëve nga nxënës të shkollave të mesme ndikon në degjenerimin e sjelljeve shkollore dhe rrezikimin e sigurisë në shkolla. Forca, dhuna, manipulimi, korrupsioni janë bërë gjuhë, mjet për arritjen e suksesit social në çdo sferë të jetës.

2.4.1 Dhuna në shkollë plagë e vjetër në debat parlamentar dhe tryeza të rrumbullakëta

Me 8 janar në shkollën fillore “Emin Duraku” Prishtinë nxënësi Fitim. K vritet për motive hakmarrje në oborrin e shkollës dhe plagoset Çlirim. B, një tjetër vritet në shkollën e mesme teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë, dy nxënës u goditën me

thikë në shkollën e mesme Aleksandër Xhuvani në Podujevë, një tjetër në Ajvali, dy grupe rivalësh në Kolovicë qëlluan me automatik kundër njëri tjetrit, një i ri vritet në Pejë, 19-vjeçari i shkollës së mesme "Frang Bardhi" në Mitrovicë pësoi plagë të rënda, pasi ishte goditur me thikë nga një nxënës tjetër brenda oborrit të shkollës pas një zënke gjatë lojës së futbollit, në Podujevë dy nxënës e kanë rrahur profesorin e tyre duke i shkaktuar lëndime të rënda, një tjetër është vrarë në Gjilan, 3 raste në Prizren, rasti "Duda" - rrahja e një nxënëseje nga një nxënëse tjetër dhe postimi i xhirimit të kësaj rrahjeje në Youtube ka bërë bujë, ...

Të gjitha këto janë raste të raportuara brenda një intervali kohor jo më të gjatë se 30 ditë. Kaq shumë gjak, kaq shumë dhunë edhe për një raport nga fronti i luftës do të ishin shumë, jo për një vend në të cilin lufta ka përfunduar 15 vjet më parë (<http://kuvendi.kv.sayit.parldata.eu/speech/46414>).

Këto që ndodhën janarin e 2014 nuk janë një situatë e re. Dhuna në shkollë, rrahjet, therrjet me thikë, abuzimi me drogë, ngacmimet seksuale, ambienti i pasigurtë brenda dhe rreth shkollës, përdorimi i alkoolit, duhanit dhe drogave të tjera janë probleme për të cilat dihet shumë kohë.

Debat i ri për një plagë të vjetër. U desh që të derdhet gjaku, të humbin jetën dhe lëndohen disa të rinj, që Parlamenti i Kosovës të debatoj për sigurinë në shkolla.

Viti 2011 ka evidentuar 440 raste, viti 2012 ka shënuar 351, ndërsa viti 2013 ka evidentuar 315 raste. Vetëm në gjashtë mujorin e parë të 2014 janë raportuar 327 raste të incidenteve që kanë ndodhur në mjediset shkollore. Nga viti 2011 në 2013 ka pasur rënie të incidenteve të shkaktuara mjediset shkollore, por nuk mund të themi se ka rënie të incidenteve në 2014.

Këto incidente kanë të bëjnë me prishje të rendit dhe qetësisë publike, lëndime të lehta, të rënda trupore, mbajtje të armëve të ftohta dhe të substancave narkotike (<http://www.evropaelire.org/content/article/26620433.html>).

Tryezë e rumbullakët në Suharekë: "Parandalimi i dhunës në shkolla".

Kjo tryezë nxori si shkaktar mungesën e bashkëpunimit mësues – prind - nxënës në shkolla.

Debatet vënë në dukje se prindërit fajësojnë shkollat për problemin e sigurisë, shkollat fajësojnë prindërit, policinë, Ministria e Arsimit thirret në ligjet e bukura dhe kritikon Drejtoritë Komunale të Arsimit, Drejtorët e Arsimit ankohen për numrin e vogël të policëve, ndërsa OJQ fajësojnë pak a shumë të gjithë, thirrin për masa të shpejta, shtimin e numrit të pedagogëve dhe psikologëve në shkolla dhe institucione arsimore (http://www.vetevendosje.org/news_post/siguria-ne-shkolla/).

2.4.2 Nismat dhe programet kombëtare në Kosovë

Në vitin 2008, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme duke pas parasysh gjendjen e vështirë të sigurisë në shkolla filloi punën për hartimin e një strategjie kombëtare për sigurinë në shkolla. Të dy ministritë nënshkruan një memorandum mirëkuptimi dhe premtuan se do t'i qasen këtij problemi në bashkëpunim.

Qendra për Arsim e Kosovës në shkurt të vitit 2009 publikoi një raport për sigurinë në shkollat e Kosovës duke sjellë të dhëna alarmante. Sipas këtij raporti 50% e fëmijëve në Kosovë kanë frikë, ndjehen të pasigurtë, ndërsa dhuna ndaj fëmijëve kalon shifrën prej 40%. Kjo shifër tregon se mjediset shkollore ende janë të dhunshme, në

masë të konsiderueshme ndikojnë në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të arsimit në Kosovë.

Në vitin 2009 Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) publikoi një raport tjetër për sigurinë në shkollat e mesme duke nënvizuar shkeljen e rregullave, praninë e armëve të ftohta, të zjarrit dhe problemin e dhunës në shkollat e Kosovës.

Me 07 Prill 2009 si rrjedhim i pasigurisë, dhunës në shkolla, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme prezantuan draft dokumentin "Strategjia për siguri në shkolla 2009-2011". Dokument që nuk u publikua kurrë.

Raporti i Qendrës për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (QHDP), shpalosi studimin: "Dhuna në mesin e nxënësve në sistemin shkollor në Kosovë" (<http://koha.net/?id=27&l=35927>).

Ky studim synon që të ofrojë një kontribut ndaj dhunës në mjediset shkollore si dhe të mbështesë dialogun në mes aktorëve në fushën e arsimit dhe të sigurisë. Legjislacioni kosovar është plotësuar me akte të shumta ligjore që trajtojnë çështjen e dhunës në mjedise shkollore, ndërsa fëmijët ndeshen me një mungesë të konsiderueshme të sigurisë në shkolla, rrugës për në shkollë nga agresiviteti dhe trafiku i dendur i makinave pranë mjediseve shkollore.

Dhuna psikologjike është rritur dhe është përdorur nga mësimdhënësit dhe nxënësit.

Nuk ka mekanizma në sistemin shkollor që të parandalojnë dhe adresojnë aktet e dhunës në mjedise shkollore, mësuesi kujdestari paraqet një zinxhir të rëndësishëm të komunikimit dhe të mbështetjes për sistemin shkollor, por rrallë ia del të zgjidhë çështjen duke qenë se legjislacioni vendor në lidhje me të drejtat e nxënësve ndalon përdorimin e forcës fizike si mjet për të trajtuar sjelljen problematike, mësimdhënësit

nuk janë trajnuar në mënyrë të duhur që të drejtojnë në mënyrë pozitive sjelljen apo qëndrimin problematik. (Mbetet shqetësim rritja e dhunës tek të rinjtë në shkolla 5 Dhjetor 2014 - 17:35).

Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë 2009 – 2018

Shëndeti gjithëpërfshirës shkollor është një mundësi e integruar në promovimin shëndetësor me qëllim të edukimit, informimit dhe sigurimit të mundësive për të krijuar qëndrime të drejta lidhur me shëndetin dhe për të mësuar e zbatuar sjellje të shëndosha.

Në mjedise të tilla është e mundur që mësimi të bëhet proces i vazhdueshëm dhe në vazhdimësi për tërë jetën. Kjo do të mundësojë që secili person të kontribuojë në familje, bashkësi duke zbatuar në praktikë aftësitë dhe shkathtësitë (http://www.fiq-fci.org/repository/docs/Siguria_ne_shkolla_nje_mision_i_pamundur.pdf).

Koncepti i shkollave "Mike për Fëmijët" i zhvilluar nga UNICEF-i

Shkolla "Mike për Fëmijët" është përkufizuar si shkollë e shëndoshë, e efektshme, mbrojtëse, ku janë përfshirë në mënyrë aktive familja dhe komuniteti.

Në shtator 2013 Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, si hap i parë dhe urgjent për ta ngritur nivelin e sigurisë në shkolla.

Nëse institucionet arsimore nuk shndërrohen në institucion edukativo-arsimor duke arsimuar dhe duke edukuar, prindërit dhe mësuesit nuk angazhohen më shumë, atëherë dhuna në shkollë do të jetë dukuri e zakonshme. Përderisa të mos funksionojë trekëndëshi institucion-prind-mësues, dhuna në shkolla mund të këtë burim dështimin e komunikimit dhe të bashkëpunimit në mes autoriteteve shkollore, nxënësve dhe prindërve.

2.5 Dhuna në shkollat e Maqedonisë

Problem i kujt është dhuna në shkollë? Ka vetëm një përgjigje: është problem dhe përgjegjësi e të gjithëve. Nuk është vetëm problem me të cilin duhet të përballemi, por duhet ta zgjidhim. Dhuna kthehet në metodë për zgjidhjen e konflikteve, ndërsa dhunuesi në model, prandaj nuk duhet të habitemi për nivelin e lartë të dhunës në shkolla. Në këtë kuptim dhuna është model që trashëgohet jo në kuptimin biologjik, por sociologjik. Dhuna e një të riu është thirrje për ndihmë.

2.5.1 Dhuna në shkolla, sjellje jo normale që kalon në kriminalitet

Në Republikën e Maqedonisë në shkolla po ndodh diçka shumë e dhimbshme. Për fat të keq dhuna po bëhet dukuri e përgjithshme. Dhuna, që dikur cilësohej si diçka jo e moralshme dhe dukuri devijuese, sot po bëhet përditshmëri e nxënësve, thotë sociologu Sadik Emroja. Në literaturat pedagogjike dhe psikologjike ekziston një tezë që thotë se kjo sjellje tek adoleshentët është normale dhe pas një kohë ajo zhduket, por si duket dhuna po merr përmasa më të mëdha dhe nga një agresivitet ose sjellje jonormale po kalon në një kriminalitet të qartë (<http://www.radiojehona.com.mk/lajme-dhuna-n%C3%AB-shkolla-sjellje-jo-normale-q%C3%AB-kalon-n%C3%AB-kriminalitet-5532>).

Incidentet mes nxënësve në shkollat e mesme të vendit janë vazhdimisht aktuale ditë më parë u përsërit incidenti mes nxënësve shqiptar dhe maqedonas në qytetin e Strugës, ku një nxënës përfundoi me lëndime më të rënda. Incident ndodhi në qytetin e Kërçovës, në të cilin u përfshinë jo vetëm nxënësit e shkollave, por edhe prindërit e tyre.

Dhuna ndëretnike është tipar dallues i dhunës në shkollat e Maqedonisë shfaqet mes nxënësve shqiptarë dhe maqedonas ku një numër i madh nxënësish u përket etniteteve të ndryshme si: shqiptarë, maqedonas, turq, turbesh, ballkano-egjiptian, romë, vlllehë. Në shumicën e rasteve, për fat të keq kanë prapavijë politike, por nuk mungojnë dhe format e tjera të dhunës.

Faktorët themelorë që të rinjtë të futen lehtë në konflikte dhe në dhunë me pasoja shumë të rënda (Dhuna në shkollë është problem social, 02/05/2011 14:21:00 www.koha.mk).

2.5.2 Nismat dhe programet kombëtare

Konkursin për prodhim më të mirë medial "Shprehu përmes mediave", nëpërmjet tekstit, fotografisë dhe videos prej një minute me temë "Së bashku për shkolla pa dhunë".

Qëllimi i projektit është t'i stimulojë nxënësit e shkollave të mesme për t'i shprehur pikëpamjet e tyre për tejkalimin e dhunës në shkollë përmes përpunimit të prodhimeve mediale.

Fushata mediale me titull "Thuaj jo dhunës!" për promovimin e vlerave pozitive dhe sjelljeve jo të dhunshme në mesin e nxënësve të shkollave të mesme (OSBE, *Fushatë mediale, jo dhunës në shkolla* 11/03/2014 13:15:00).

Fushatë ka publikuar dy videoklipe në televizionet kombëtare, lokale, ëeb faqen e OSBE-së, YouTube dhe në web-faqet e institucioneve përkatëse, të shkollave dhe rrjete sociale.

"Dhuna në shkolla është një kërcënim real i sigurisë jo vetëm për mësuesit dhe nxënësit, por edhe për anëtarët e tjerë të komunitetit. Kjo lloj dhune është dukuri e

ndërlikuar dhe është e qartë se përpjekjet individuale të zyrtarëve të shkollave nuk do të jenë të mjaftueshme për të luftuar këtë tendencë të papranueshme. Në vend të kësaj nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndër- institucionale për të trajtuar në mënyrë efikase këtë çështje",- tha Shefi i Misionit të OSBE-së në Shkup, ambasadori Ralf Breth

Projekti "Shkollat të sigurtë – Mjedis i harmonishëm" i cili ka për qëllim krijimin e një modeli të sigurisë nëpër shkolla për të parandaluar incidentet dhe sjelljet e dhunshme ndërmjet nxënësve në shkollat e mesme.

Projekti "Shkolla të sigurtë – sëbashku kundër dhunës", në sheshin e qytetit në Gostivarit dhe Tetovës u mbajt manifest, ku në mënyrë të organizuar morën pjesë nxënës të shkollave të mesme dhe aktorët shoqërorë.

Qëllimi i aktiviteteve është që të kontribuohet për ngritjen e ndërgjegjes te të rinjtë për mirëkuptim, respektim, lehtësim të parandalimit në kohë, zvogëlim praktik të dhunës në shkollë dhe mjedise të tjera.

Tryezë të rrumbullakët me temë: "Dhuna ndërmjet nxënësve në shkollat e mesme".

Kjo ngjarje u organizua si rezultat i kërkimit nga Forumi Rinor Arsimor gjatë periudhës shkurt - prill (*Forum Rinor Arsimor me 02.12.2014*).

Qëllimi i kërkimit është zhvillimi i diskutimit ndërmjet palëve të prekura si dhe të kontribuojë në promovimin e politikave që rregullojnë çështjen për parandalimin dhe zbatimin e dhunës në mesin e të rinjve në Maqedoni.

Projekti "Ndërtojmë ura" synon promovimin e tolerancës etnike dhe fetare, si vlerë, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet nxënësve të etniteteve të ndryshme në kuadër të arsimit të integruar, si një shtyllë bazë për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë multi-etnike.

Grevë të përgjithshme në shtator 2014 për shkak të kushteve të punës dhe ngritjes së pagave nga mësuesit e arsimit parauniversitar. Institucionet shtetërore (qeveria dhe parlamenti) ushtruan dhunë institucionale ndaj mësimeve duke i kërcënuar me largim nga puna dhe zëvendësimi i tyre me mësime të rinj (këtu ka hapësirë të kuptohet me ushtarë partiakë që kanë mbetur pa u punësuar deri më tani). Ligji për Notim Ekstern nëpërmjet testit i miratuar në Parlament jashtë standardeve, një dhunë psikologjike mbi nxënësit dhe personelin e shkollës.

Sistemi arsimor në Maqedoni çon në ndarje, duke realizuar mësim për etnitete të ndryshme në ndërrime të ndryshme, përkatësisht në objekte krejtësisht të ndara për dallim nga ato që mbështet komuniteti ndërkombëtar

(<http://www.radiojehona.com.mk/lajme-dhuna-n%C3%AB-shkolla-sjellje-jo-normale-q%C3%AB-kalon-n%C3%AB-kriminalitet-5532>).

2.6 Dhuna në shkollat e mesme të Shqipërisë

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm për të përmirësuar mbrojtjen e fëmijëve, zbatimi është i ngadaltë. Vlerësimet e kohëve të fundit:

1. Dhuna në shkollë ka një përhapje të madhe.
2. Përgjigje e dobët ndaj dukurisë së dhunës në shkollë.
3. Përgjigja e dobët është pasojë e mungesës së një ligji mbi dhunën, mandati të profesionistëve mbi raportimin e dhunës, strukturave shtetërore për raportim dhe ndërhyrje.

Nuk është skenari i vërtetë i kërkimit shkencor mbi dhunën në shkollë, por mund të përdoret për të krijuar ndërgjegjësimin e prindërve, mësuesve, nxënësve dhe organeve të tjera drejtuese, që të marrin hapat e nevojshme për të kontrolluar dhunën në shkollë.

Hyrja në Bashkimin Europian nuk është thjeshtë një dëshirë pa detyrime të caktuara. Procesi i integritetit është një rrugë e gjatë, që të detyron përmbushjen e standarteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë për të mitur. Shqipëria duhet të harmonizojë legjislacionin me standardet e Bashkimit Europian.

2.6.1 Statistika viktimash të dhunës në shkollën e mesme në Shqipëri.

Doreza hekuri, kaçavida, thika dhe në disa raste edhe armë zjarri janë përdorur nga adoleshentët gjatë sherreve dhe konflikteve me shokët e klasës apo të shkollës. Shpeshherë janë regjistruar incidente si vrasja e nxënësve në shkollën "Bajram Curri" në Tiranë, Vlorë nga vetë shokët e tyre, dhunimi i mësuesit të gjimnazit në Bulqizë nga nxënësi dhe të afërmit, por në 5-vjeçarin e fundit sherret banale kanë shënuar edhe viktima. Në Nëntor të vitit 2009, dy gjimnazistë të shkollës "Perikli Ikonimi" u grindën me njëri-tjetrin gjatë pushimit. pas fyerjeve të ndërsjellta, njëri prej tyre plagosi rëndë shokun e shkollës me armë të ftohtë. Në nëntor të vitit 2010, një gjimnazist i shkollës "Eqerem Çabej" u qëllua katër herë me thikë nga dy bashkëmoshatarët e tij në mjediset e shkollës. Shkaku i sherrit ishte shumë banal. Gjatë perleshjes mes të rinjve mbeti i plagosur një kalimtar, i cili tentoi të ndajë të rinjtë. Në tetor të vitit 2011 një 17-vjeçar humbi jetën në shkollën e mesme profesionale "Nazmi Rushiti" të qytetit të Peshkopisë. Krenar. B u qëllua me thikë në korridorin e shkollës nga nxënësi i të njëjtës shkollë Ermal. R.. Sherri i nisur për motive banale përfundoi në një tragjedi. Në shkurt të vitit 2012 një gjimnazist i shkolles "Ismail Qemali" u plagos

me armë zjarri nga një nxënës i shkollës. I dëmtuari R.Qoshja kishte rrahur një ditë para ngjarjes 16-vjeçarin me inicialet B.P. Pas grindjes në mjediset e shkollës, sherri përfundoi pas 24 orësh me përdorimin e armës së zjarrit. R.Qoshja shpëtoi mrekullisht, duke marrë një plumb në dorë. Me 3 tetor 2003 dy nxënës të gjimnazit "Naim Frashëri" në qytetin e Durrësit u përfshin në një konflikt, i cili nisi me fyerje, përfundoi me përdorim thikash dhe dorezë hekuri. Të rinjtë me inicialet E.K dhe Xh.T përfunduan të dy në spital. Në dhjetor të 2013, 16-vjeçari L.Milo u plagos në shkollën "Perikli Ikonomi" në Fier. Një tjetër nxënës rezultoi të ishte autori, i cili qëllloi Milon me hekur në kokë. Ngjarja pasoi me tragjedinë e shkollës "Beqir Çela" në Shkozë të Durrësit, ku humbi jetën 17-vjeçari Adriatik. T, i cili u qëllua me armë zjarri gjatë orës së mësimi nga nxënësi i vitit të parë, Edrin. V (<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=26898>).

2.6.2 Mendime dhe debatet akademike mbi dhunën në shkollë

Debate televizive kur media shfaq raste të vdekjeve nga dhuna

Qarkore e MASH në dhjetor 2006

Debate në ambientet e shkollave 2006; 2007; 2012, 2013

Konferenca Shkencore: "Dhuna kundër Fëmijëve në Shqipëri"

"Si e parandalojnë dhunën kundër fëmijëve Sistemi i Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimet Sociale në Shqipëri?"

Organizator janë UNICEF së bashku me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Fakultetin e Juridikut, Fakultetin e Shkencave Sociale, Koalicionin BKTF, Terre des Hommes, CRCA, ACA/Observatorët për të Drejtat e

Fëmijës dhe Qendrën "Fëmijët Sot", me mbështetjen e Komisionit Evropian dhe Bashkëpunimit për Zhvillim Austriak.

Ambasadori i Delegacionit Evropian në Shqipëri, z.Ettore Sequi theksoi se: "Mbrotjtja e Fëmijëve nga Dhuna në Rajonin e Europës Juglindore" është inisiativë që synon të forcojë kapacitetet e shoqërisë civile në monitorimin e pavaruar në lidhje me dhunimin e të drejtave të fëmijëve, veçanërisht të dhunës fizike të ushtruar ndaj tyre. Të drejtat e fëmijëve kanë një rëndësi të veçantë për Bashkimin Evropian, e cila e ka kriter të fortë politik mbrojtjen e tyre duke e vendosur edhe si një nga 12 prioritetet për statusin kandidat të Shqipërisë.

Z.Detlef Palm- UNICEF theksoi se: "Dhuna përfshi atë fizike dhe psikologjike është gjithmonë një eksperiencë shumë e dhimbshme dhe degraduese, aq më tepër kur viktima të saj janë fëmijët. Shqipëria ka bërë progres në fushën e hartimit dhe miratimit të një legjislacioni mbrojtës për fëmijët dhe në ngritjen e mekanizmit të referimit të rasteve të fëmijëve në rrezik".

2. Projekti COMBI në shkolla dhe përdorimi i kartave PEET

Plani COMBI (Communication for Behavioral Impact-Komunikim për Ndryshimin e Sjelljes) është studim 4-vjeçar.

Ky Plan COMBI për Fëmijët dhe Dhunën u kërkua nga MASH dhe UNICEF Shqipëri si pjesë e strategjisë së përbashkët për t'u fokusuar në një numër çështjesh mbi Fëmijët dhe Dhunën në Shqipëri. Plani COMBI për Fëmijët dhe Dhunën mbështetet mbi konsultimet me nivele të ndryshme, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punës, ekipit të UNICEF, vizitat në shkolla, kopshte dhe institucione të përkujdesjes sociale, deputetë dhe një numër OJQ partnere, të cilat punojnë me fëmijët dhe dhunën.

Qëllim i Përgjithshëm: Të sigurojë mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna e çdo forme, që është parashikuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara të ratifikuar nga Shqipëria, dhe parashikohet në parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në planin COMBI u angazhuan: 640.000 fëmijë, 40.000 mësues dhe 54 kujdestarë në rang kombëtar, të cilët ishin agjentët e ndryshimit të sjelljes.

Nryshimi i pritur ne sjellje:

Të arrihet brenda një periudhe 4-vjeçare nga fillimi i këtij programi COMBI:

Ky është konteksti në të cilin ne ofrojmë një sjellje të re për të zëvendësuar Mënyrën e Vjetër të Disiplinës, që është Mënyra e Re e Disiplinës (NewWay Discipline) – MRD me mikro-veprimet e saj. Mësuesit dhe kujdestarët do të bëjnë përsëri llogaritë e tyre kosto/vlerë në lidhje me sjelljen e rekomanduar dhe do ta krahasojnë atë me Mënyrën e Vjetër të Disiplinës, që është konkurenca dhe llogarinë e saj kosto/vlerë.

Konferencë kombëtare 29 Janar 2013 - Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA) në Shqipëri prezantoi të dhënat e Studimit "Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri" në kuadër të Studimit Epidemiologjik Ballkanik mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve (B.E.C.A.N)

Në studim u përfshin 640000 nxënës, 40000 mësues të sistemit arsimor parauniversitar dhe 54 kujdestarë të institucioneve publike. Objekt i studimit kanë qenë dhe shkollat e mesme të rrethit Dibër.

Sipas z. Altin Hazizaj: "ajo çka është e rëndësishme nga ky studim është të zbulojmë si këto të dhëna do të kthehen në politika të mbrojtjes së fëmijëve dhe në

prioritete të punës së Organizatave të Shoqërisë Civile, institucioneve publike, arsimtarëve, donatorëve etj.

Karta PEET ka të bëjë me zbatimin e Metodave të Reja të Disiplinës (MRD) në klasë.

3. Konferenca e Frankofonisë, 19-20 shtator 2013, Paris

" Mbrojtja e fëmijëve, të drejtat e tyre në ekranet televizive, zbatimi i akteve ligjore dhe problematikat në këtë fushë".

Ligji i ri për mediat audiovizive i miratuar në Parlament dhe aktet nënligjore në zbatim të tij i kushtojnë vëmendje të posaçme mbrojtjes së fëmijëve nga pushteti mediatik nga Endira Bushati AMA

Grupmosha më e rrezikuar nga programet radiotelevizive që nuk respektojnë kërkesat e ligjit dhe standardet etike janë fëmijët dhe të rinjtë.

AMA (Autoritet i Medias Audiovizive) Autoritet rregullator për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ka hartuar dhe miratuar Rregulloren "Për shenjat paralajmëruese", si dhe është në proces konsultimit publik e institucional për kalimin e Kodit të Transmetimit dhe Kartës për Mbrojtjen e Fëmijëve në Media.

4. Festivali i Filmit për të Drejtat e Njeriut

"Krimi i organizuar, korrupsioni, terrorizmi, fundamentalizmi, trafikimi i qenieve njerëzore dhe drogës, shfrytëzimi i të miturve, skllavëria moderne dhe shfrytëzimit të pasurive natyrore".

Iniciativat e organizatave jofitimprurëse lidhur me dhunën kundër fëmijëve janë bërë më superiore në krahasim me iniciativat qeveritare nga ana sasiore dhe cilësore. Stukturat qeveritare në nivel qendror dhe lokal janë bërë mbështetëse të veprimtarisë

së organizatave jofitimprurëse. Roli mbështetës ka të bëjë me nënshkrimin e marrëveshjeve OJQ - struktura të qeverisë, sipas të cilave lejohen të kryejnë aktivitetet e tyre në kuadrin e projekteve të caktuara. OJQ shprehin si kërkesë të tyre që strukturat qeveritare të ndihmojnë më shumë duke u dhënë informacionin e nevojshëm, që disponojnë.

Media në Shqipëri ka qenë dhe është shumë e ndjeshme ndaj problematikës së dhunës kundër fëmijëve. Mjaft gazetarë janë përfshirë në trajnime lidhur me pasqyrimin në media të rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut, gruas dhe fëmijëve në veçanti. Rastet kur në shtypin e shkruar dhe elektronik trajtohen çështje të dhunës janë të shpeshta. Temat më të prekura lidhur me dhunën mbi fëmijët janë trafikimi, shfrytëzimi i punës, përdorimi për prostitucion dhe transplante, të përfshirjes në krime, etj.

Me pasqyrimin e tyre media ka arritur të ndërgjegjësojë qarqet politike dhe segmente të caktuara të administratës shtetërore dhe opinionin publik. Në shumë raste mbulimi mediatik i problematikës së fëmijëve ka shërbyer për të nxitur organet e specializuara që të ndërmarrin veprimet e duhura për hetime, ndjekje penale, etj. Mbulimi mediatik i dhunës kundër fëmijëve ka ardhur në ngjitje dhe ka shërbyer pozitivisht për ndërgjegjësimin e disa niveleve.

Media e trajton fenomenin e dhunës, që ushtrohet kundër fëmijëve në mënyrë episodike. Ajo ka lënë pa mbuluar format më të moderuara të llojeve të ndryshme të dhunës kundër fëmijëve dhe është më e interesuar për format e rënda. Në shumë raste, media e shkruar dhe elektronike e ka trajtuar këtë fenomen pa respektuar etikën profesionale, në mënyrë të zhurmshme dhe për qëllime fitimi.

2.7 Interpretimi i akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijës.

Me ndryshimet, që pëson jeta jonë e përditshme në çdo hap të saj, lind nevoja e njohjes sa më të mirë të legjislacionit dhe bazës ligjore për aktivitetet, që ne kërkojmë të zhvillojmë dhe veçanërisht problemit të dhunës ndaj fëmijëve në shkollë.

2.7.1. Deklarata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut

Në dokumentet ndërkombëtare dhe kombëtare i kushtohet rëndësi e madhe problemit të dhunës ndaj fëmijëve në shkollë.

Deklarata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut (1948)

Deklarata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut është i pari autoritarndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut. Ajo është e bazuar në mosdiskriminimin, barazinë dhe njohjen e dinjitetit të njeriut, duke përfshirë edhe fëmijët.

<http://www.un.org/en/documents/udhr/index.shtml>.

Neni 26 thotë se çdokush ka të drejtë për arsim.

Deklarata përshkruan dy funksione themelore të arsimit.

Funksioni i parë është se arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore..

Funksionii dytë është mbështetja e mirëkuptimit, tolerancës dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve racore ose fetare dhe ruajtjen e paqes.

2.7.2 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966)

Rëndësia e kushteve të punës për mësuesit është theksuar edhe në Konventë: "... kushtet materiale të personelit mësimor do të përmirësohen vazhdimisht". Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966).

Në nenin 26, ndalon diskriminim mbi çfarëdo baze të tilla si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, mendim politik apo mendimi tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes dhe garanto të gjithë personat për mbrojtje efektive kundër diskriminimit. <http://www.2.ohchr.org/english/law/cescr.htm>.

2.7.3 Korniza për Veprim e Dakarit

Korniza për Veprim e Dakarit u miratua në 2000 në Senegal.

Kornizashpreh lidhjen e të drejtës për arsim cilësor në një mjedis të sigurt dhe pa dhunë.

Shkollat duhet të respektohen dhe të mbrohen si faltore dhe zona të paqes.. .

Edukimi duhet të nxisë aftësitë për parandalimin e dhunës, zgjidhjen paqësore të konfliktit, vlera sociale dhe etike. "

2.7.4 Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve përbën gurin themeltar të konceptit të mbrojtjes së fëmijëve.

Neni 19

1. Mbrojtja e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose njërit prej tyre,

të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

Në bazë të nenit 19-të, Shtetet Palë duhet të mbrojnë fëmijëtprej të gjitha format e abuzimit nga ana e prindërve të tyre ose personave të tjerë të cilëve u janë besuar, përfshirë këtu mësuesit, personelin e qendrave të kujdesit të fëmijës, etj.

2.7.5 Rregullat e Pekinit

Sipas neni 38, çdo i miturnë moshën e shkollës së detyrueshme të drejtën e arsimimit të përshtatur me nevojat, aftësitë e tij ose të saj dhetë planifikuar në mënyrë të tillë, që të përgatisë atë për tu kthyer në shoqëri(www.rregullatepekinit.com).

Ky arsimim duhet siguruar jashtë ambientit të paraburgimit në shkollat e komunitetit, kudo që të jetë e mundur dhe në çdo rast nga mësues të kualifikuar përmes programeve të integruara në sistemin arsimor të vendit, në mënyrë që pas daljes në liri, të miturit të mund të vazhdojnë arsimimin e tyre pa vështirësi.....

2.7.6 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta është ligji suprem, në të cilin deklarohen politikat dhe vlerat më të thella të shtetit shqiptar. Sipas nenit 3 të Kushtetutës:”dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij,..., janë baza e këtij shteti, i cili ka të drejtë t’i respektojë dhe t’i mbrojë ato”(www.kushtetutaeshqiperise.com).

Neni 54 është i vetmi nen, që trajton dhunën ndaj fëmijëve në mënyrë specifike dhe të drejtëpërdrejtë duke përcaktuar që fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti dhe të mbrohen nga dhuna.

Neni 54

1-.Fëmijët, të rinjtë dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti.

2-.Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë e veçanërisht nën moshën minimale për punë të fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij (www.kushtetutaeshqiperise.com).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 54, Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Nga kjo dispozitë kushtetuese del qartë mbrojtja e fëmijëve nga dhuna dhe keqtrajtimi, ndërsa përsa i përket shfrytëzimit është i lidhur kryesisht me qëllimin për punë. Legjislacioni shqiptar nuk përmend mbrojtjen nga abuzimi dhe neglizhimi, gjë që e bën kushtetutën shqiptare të jetë pjesërisht në harmoni me Konventën e të Drejtave të Fëmijëve (SIDA, Save the Children. 2012:203).

2.7.7 Kodi Penal

Kodi penal i Republikës së Shqipërisë parashikon një sërë veprash penale me karakter ndëshkimin e veprimtarisë kriminale me subjekt të mitur të vendosur në një kuadër të përafërt me atë të parashikuar në nenin 19 të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve për mbrojtjen nga dhuna, abuzimi, keqtrajtimi dhe neglizhimi.

Përsa i përket mbrojtjes nga dhuna në Kodin Penal parashikohen si vepra penale një sërë nenesh:

Neni90

Rrahjasi dhe çdo lloj tjetër dhune përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

Po kjo vepër penale, kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj (www.kodipenal.com).

Neni 90 "Dëmtime me dashje", garanton një mbrojtje të përgjithshme të subjekteve nga dhuna fizike në formën e rrahjes apo në forma të tjera.

Çdo vepër penale e kryer kundër subjektit të mitur do të përbënte një rrethanë rënduese sipas nenit 50, pika e të Kodit Penal "kur vepra penale është kryer kundër fëmijëve,..."

Në nenet 88, 88a, 88b, 89, 91, 92 të Kodit penal parashikohen si vepra penale "plagosja e rëndë dhe e lehtë me dashje dhe nga pakujdesia. ...ose çdo dëmtim tjetër i përhershëm i shëndetit".

Në nenin 108 të Kodit Penal parashikohet si akt kriminal kryerja e veprave të turpshme me të mitur nën 14 vjeç.

Neni 106 i Kodit Penal garanton mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual, forma ekstreme e tij e marrëdhënies seksuale dënohet me 7 vjet burgim.

Neni 248 i Kodit Penal mbi shpërdorimin e detyrës nga personat që ushtrojnë funksione publike (SIDA, Save the Children. 2012:204).

2.7.8 Kodi i Procedurës Penale (KPP)

Neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, përcakton një sërë veprash penale si plagosja, dëmtime me dashje janë vepra penale. Prindi apo kujdestari ndjek procedimin apo gjykimin. Në rastin kur dhunuesi është prindi ky nen duhet të rishikohet për tu përshtatur me nenin 19 të Konventës së të drejtave të fëmijës, pasi kujdestari dhe

dhunuesi janë i njëjti person (SIDA, Save the Children, *"Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës"*, 2012: 2005-2006).

2.7.9 Kodi i Familjes

Në nenin 3 të Kodit të Familjes shteti shqiptar merr përsipër së bashku me shoqërinë detyrime më të forta për mbështetjen e familjeve në nevojë, që për shkak të kushteve ekonomike të vështira detyrohen të braktisin fëmijët në institucione të përkujdesjes. Parashikimi i ligjit është në koherencë të plotë me Konventën e të Drejtave të Fëmijës www.kodifamiljes.com (parë më 12 tetor 2012).

Neni 215 i Kodit të Familjes parashikon përgjegjësinë prindërore si një tërësi të drejtash dhe detyrimesh për t'i siguruar fëmijës mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale.

Neni 228 për heqjen e përgjegjësisë prindërore, kur shpërdoron ushtrimin e saj

Neni 281 për marrjen e masave urgjente për mbrojtjen e të miturit.

Këto tre nene përbëjnë një bazë të mirë të marrjes së masave të ndryshme nga ato penale për prindërit në mbrojtje të fëmijëve në rastet e dhunës, abuzimit, keqtrajtimit dhe neglizhimit (SIDA, Save the Children, *"Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës"*, 2012: 206-207).

2.7.10 Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar

Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar dhe Udhëzimi i Ministrit të Arsimit për eliminimin e dhunës në shkollë. Dispozitat normative për arsimin parauniversitar janë i vetmi dokument mbi të cilin është ndërtuar jeta në shkollë. Arsimi respekton të drejtat e fëmijëve dhe të të rriturve të sanksionuara në këtë

dokument. Në nenin 36 "Të drejtat" theksojnë: "Individualiteti dhe dinjiteti njerëzor i fëmijës parashkollor dhe i nxënësit respektohet, ai mbrohet nga dhuna fizike e psikologjike, diskriminimi dhe veçimi. Në kopsht dhe në shkollë janë kategorikisht të ndaluara ndëshkimet fizike apo trajtimet poshtëruese e denigruese të fëmijëve".

Në nenin 36 të Dispozitave Normative për Arsimin Parauniversitar parashikohet se individualiteti dhe dinjiteti njerëzor i fëmijës parashkollor dhe i nxënësit respektohet, ai mbrohet nga dhuna fizike dhe psikologjike, diskriminimi dhe veçimi. Në kopsht dhe në shkollë janë kategorikisht të ndaluara ndëshkimet fizike apo trajtimet poshtëruese e denigruese të fëmijëve.

Kjo dispozitë përbën një bazë të mirë për të krijuar konformitetin e legjislacionit shqiptar në fushën e arsimit me Konventën e të Drejtave të Fëmijës dhe në mënyrë specifike me nenin 19, megjithëse është i dukshëm karakteri i përgjithshëm i saj (SIDA, Save the Children, *"Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës"*, Tiranë 2012: 211).

2.7.11 Qarkorja e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Qarkorja e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës është një hap i parë drejt ndërgjegjësimin të personelit të shkollave rreth rolit të tyre si aktorë të mbrojtjes së fëmijëve.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve e ka përdorur këtë nen të Dispozitave Normative si bazë për të detajuar një sërë masash detyrash për tu ndërmarrë nga Drejtoria Arsimoredheshkollat në të gjithë vendin për sa i përket evidentimit dhe analizimit të formave të dhunës në kopshte dhe shkolla, organizimit të trajnimeve dhe seminareve, bisedave me mësues për rritjen e njohurive të tyre në lidhje me trajtimin e problemeve

të dhunës, zhvillimin e veprimtarive ekstrakurrikulare me fëmijët dhe nxënësit me tematikë mbi dhunën. Theks i vihet përdorimit të formave, mënyrave të disiplinimit, menaxhimit të klasës, që nuk bazohen në frikë, kërcënim, poshtërim apo përdorim të forcës fizike. Drejtoritë Arsimore detyrohen të programojnë monitorimin e sjelljes së mësuesve me nxënësit dhe diskutime të gjera me prarinë e prindërve, nxënësve dhe mësuesve (SIDA. Save the Children. 2012:211).

2.7.12 Kodi i Etikës

"Komisioni i etikës dhe i sjelljes i propozon drejtuesit të institucionit për shqyrtimet dhe veprime të mëtejshme, në rast kur sjelljet në fjalë konsiderohen shkelje të ligjit apo dispozitave ligjore. Të gjitha masat ndaj mësuesit merren vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nga institucionet përkatëse", thuhet në Kodin e Etikës. Midis të tjerave në kod thuhet se mësuesi duhet të veprojë me përgjegjshmëri ndaj nxënësve, duke respektuar privatësinë e informacioneve të veçanta, që ai ka për vetë nxënësin dhe familjen e tij duke mos i keqpërdorur të dhënat pa pëlqimin e tij.

2.8 Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve

Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve përbëhet nga:

1. Sektori i Shërbimeve Sociale
2. Policia dhe Sektori i Brendshëm
3. Sektori i Drejtësisë
4. Sektori i Arsimit
5. Sektori i Shëndetësisë

2.8.1. *Sektori i Shërbimeve Sociale*

Pamje e përgjithshme

Në strukturën e shërbimeve sociale, përgjegjësia e përgjithshme për zhvillimin e politikave të shërbimeve sociale, legjislacionit, planifikimit, menaxhimit të fondeve, shpalljes së standardeve dhe liçencimit të ofruesve privat të shërbimeve bie mbi Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale. Ministria mbikqyr ofrimin e shërbimeve nëpërmjet institucionit të saj ndërmjetës, Shërbimi Social Shtetëror, nëpërmjet pushtetit vendor. Organizatat joqeveritare ofrojnë një nivel të lartë të shërbimeve sociale për fëmijët. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale mbykqyr administrimin e ndihmës ekonomike për familjet që nuk kanë të ardhura, kanë të ardhura të ulëta dhe ndihmë ekonomike për personat me aftësi të kufizuar. Administratorët social në bashki dhe komunë shpërndajnë ndihmë ekonomike dhe mbështesin organizatat joqeveritare për bashkërendim shërbimesh.

Grafiku paraqet strukturën institucionale të sektorit të shërbimeve sociale.

Shërbimi Social Shtetëror funksionon si institucion ndërmjetës mes nivelit politikbërës të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe nivelit të ofruesve të shërbimeve. Ai është përgjegjës për zbatimin e politikave të ministrisë në fushat e ndihmës sociale dhe shërbimeve të përkujdesjes.

Shërbimi Social Shtetëror ka dy funksione:

1. Monitorim, inspektim i përdorimit të fondeve dhe ofrimit të shërbimeve.
2. Trajnim për personelin dhe për ofruesit e shërbimit social.

Zyraqendrore në Tiranë bashkërendon me zyrat nëpër qarqe. Çdo zyrë përbëhet nga drejtori dhe inspektorët e shërbimit. Nuk mund të marrin vendime në lidhje me ofrimin e shërbimeve, sepse nuk kanë buxhete vetjake.




Figura 1: Sektori i Shërbimeve Sociale

Administratori social

Është i vendosur në strukturën e pushtetit vendor të bashkisë. Ai kordinon dhe ofron shërbime sociale.

Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe komitetet e monitorimit të punës së fëmijëve janë struktura që funksionojnë si mekanizma referimi (Hamilton,C. Malby,S. Ross,G.2007:27).

2.8.2. Policia dhe Sektori i Brendshëm

1. Pamje e përgjithshme

Policia dhe sektori i brendshëm luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve.

Sektori është përgjegjës së bashku me sektorin gjyqësor për zbatimin e legjislacionit, që penalizon dhunën, abuzimin, shfrytëzimin dhe neglizhimin e fëmijëve. Ai është shpesh pika e parë e kontaktit, kur fëmijët vuajnë nga abuzimi.

Duke parë këtë rol është kritike që policia dhe sektori i brendshëm të jetë në gjendje të përgjigjet ndaj fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit.

Standardet ndërkombëtare mbi trajtimin e fëmijëve viktime dhe dëshmitarë sugjerojnë që policia duhet të luajë rol kyç në sigurimin që çdo fëmijë i tillë të drejtohet tek shërbimet e duhura sociale dhe të trajtohet në një mënyrë miqësore.

Policia dhe sektori i brendshëm në Shqipëri nuk kanë qenë subjekt i një reforme të tillë si sektori i shërbimeve sociale dhe ndjek një strukturë të rregullt. Komisariatet lokale të policisë varen nga drejtoritë e qarkut në secilin prej 12 qarqeve të Shqipërisë. Drejtoritë e qarkut varen nga një Drejtori e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në

Tiranë. Drejtori i Përgjithshëmi së cilës varet drejtëpërdrejtë nga Ministria e Brendshme.

Politikat dhe legjislacioni i rëndësishëm, qërregullon sektorin përfshin Kodin Penal, Kodin e procedurës Penale, Ligjin për Policinë dhe Policinë Gjyqësore, Strategjinë Kombëtare Kundër Trafikimit dhe Legjislacioni dytësor përkatës.

Grafiku tregon strukturën institucionale të policisë dhe sektorit të brendshëm në Shqipëri.

Ngjyrat tregojnë nivelet e hierarkisë:

niveli qendror(e kuqe), niveli rajonal (blu), bashki (e gjelbër)dheofrues shërbimesh (e verdhë).

Shigjetat e trasha brenda grafikut paraqesin marrëdhëniet strukturore institucionale, prandaj janë vijat e varësisë kryesore. Shigjetat e holla ndërmjet institucioneve apo personave janë shënuar me "flamuj" për të treguar rëndësinë e tyre, p.sh "referime të rasteve të trafikut". Grafiku nuk paraqet të gjithë drejtoritë apo sektorët në Ministrinë e Brendshme apo Drejtorinë e Përgjithshmetë Policisë së Shtetit. Ai kërkon të identifikojë aktorët kryesorë, që lidhen me policinë dhe sektorin e brendshëm si një komponent brenda sistemit të mbrojtës së fëmijëve. Gjithashtu madhësia e kutisë nuk ka lidhje me numrin e stafit apo burimet në një drejtori, seksion apo institucion tjetër (Hamilton,C. Malby,S. Ross,G. 2007:34).




Figura 2: Policia dhe Sektori i Brendshëm

2.8.3. Sektori i Drejtësisë

Sektori i Drejtësisë luan një rol të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në dy drejtime.

Së pari, ofron mbrojtje për fëmijët viktime dhe dëshmitarë gjatë procesit.

Së dyti, përcakton statusin ligjor të fëmijëve, që kanë humbur kujdestarin e tyre parësor.

Sektori i Drejtësisë në Shqipëri përfshin një Gjykatë Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apelit, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore dhe Zyrat e Rretheve të Prokurorisë së Përgjithshme. Pjesa më e rëndësishme e legjislacionit, që rregullon rolin e dytë të Sektorit të Drejtësisë, që lidhet me fëmijët pa kujdes prindëror është Kodi i Familjes. Propozime të rëndësishme mbrojtëse përmbahen në një Projekt ligj mbi dhunën.

Grafiku paraqet stukturën institucionale të Sektorit të Drejtësisë në Shqipëri.

Ngjyrat janë përdorur në grafik për të dalluar midis niveleve të ndryshme:

qendrore (e kuqe), qark/rajonale (blu), bashki (e gjelbër) dhe ofrues shërbimesh (e verdhë).

Shigjetat e trasha brenda grafikut paraqesin marrëdhëniet dhe janë vijat e varësisë kryesore. Shigjetat e holla ndërmjet institucioneve apo personave janë shënuar me "flamuj" për të treguar rëndësinë e tyre. Grafiku nuk paraqet të gjithë drejtoritë apo sektorët e Ministrisë së Drejtësisë. Ai kërkon të identifikojë aktorët kryesorë, që lidhen me Sektorin e Drejtësisë si një komponent brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Madhësia e kutisë nuk ka lidhje me numrin e stafit apo burimet në një drejtori, seksion apo institucion tjetër.

Ligji dhe politikat e zbatueshme

Ligjet kryesore të zbatueshme për mbrojtjen e fëmijëve janë Ligji i Organizimit të Pushtetit Gjyqësor, Ligji i Organizimit të Prokurorisë, Ligji i Organizimit të Gjykatave të Krimeve të Rënda, Kodi i Procedurës Penale, Kodi i Familjes dhe Ligji mbi Dhunën.

(Hamilton, C. Malby, S. Ross, G. 2007:48).

Diagrama 3: Sektori i Drejtësisë




Figura 3: Sektori i Drejtësisë

2.8.4. *Sektori i Arsimit*

Standartet ndërkombëtare për një sistem të mbrojtjes së fëmijëve përfshin një numër tëmadh dispozitash në lidhje me identifikimin dhe referimin e rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit apo pakujdesisë. Këto standarte janë të zbatueshme për çdo ofrues shërbimesh, që ka kontakt me fëmijën. Një ofrues kyç shërbimeshështë sistemi arsimor, që ka kontakttë "vijës së parë" me fëmijët nëpërmjet frekuentimit të përditshëm të shkollës nga fëmijët.

Standartet ndërkombëtare rekomandojnë që duhet të ketë rregulloreose udhëzime për regjistrimin dhe referimin e rasteve të dhunës të hasuranga ofruesit e shërbimeve(shkolla). Personeli pedagogjik duhet të ketë njohuri mbi rregulloren dhe të trajnohet për identifikimin e rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit apo pakujdesisë dhe të referojë rastet tek organet ose shërbimet kompetente.

Grafiku tregon strukturën institucionale të sektorit shqiptar të arsimit. Ngjyrat janë përdorur në grafik për të dalluar midis niveleve të ndryshme:qendrore (e kuqe), qark/rajonale (blu), bashki(e gjelbër) dhe ofrues shërbimesh (e verdhë).

Shigjetat e trasha brenda grafikut paraqesin marrëdhëniet strukturore institucionale dhe janë vijat e varësisë kryesore. Shigjetat e holla ndërmjet institucioneve apo personave janë shënuar me "flamuj" për të treguar rëndësinë e tyre. Grafiku nuk paraqet të gjithë drejtoritë apo sektorët në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve. Ai kërkon të identifikojë aktorët kryesorë, që lidhen me Sektorin e Drejtësisësi një kompetent brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Madhësia e kutisë nuk ka lidhje me numrin e personelit apo burimet nënjë drejtori, seksion apo institucion tjetër (Hamilton,C. Malby,S. Ross,G. 2007:57).

**Grafiku 4:
Sektori i Arsimit**




Figura 4: Sektori i Arsimit

2.8.5. *Sektori i Shëndetësisë*

Standardet ndërkombëtare për një sistem të mbrojtjes së fëmijëve përfshin një numër të madh dispozitash në lidhje me identifikimin dhe referimin e rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit apo pakujdesisë. Këto standarde janë të zbatueshme për ofruesit e shërbimeve, që ka kontakt me fëmijën. Përveç ofruesve të shërbimeve arsimore, kjo përfshin ofruesit e shërbimeve në sistemin e shëndetësisë, që ka kontakt të "vijës së parë " me fëmijët nëpërmjet paraqitjes së fëmijës në mjediset e shëndetit parësor apo spitale në rastet e lëndimit a sëmundjes.

Standardet ndërkombëtare rekomandojnë që duhet të ketë rregullore ose udhëzime për regjistrimin ose referimin e rasteve të dhunës të hasura nga ofruesit e shërbimeve siç janë qendrat shëndetësore.

Personeli duhet të ketë njohuri mbi këto rregullore dhe të trajnohet për identifikimin e situatave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit, pakujdesisë dhe të referojë këto raste tek organet ose shërbimet kompetente (UNICEF, *Treguesit globalë të dhunës*).

Sistemi shëndetësor shqiptar nuk mban të dhëna specifike të sakta mbi lëndimet jo-aksidentale apo vdekjet e dyshimta jo-aksidentale të fëmijëve. I vetmi informacion i dobishëm mund të gjendet në një publikim të INSTAT mbi shkaqet e vdekjeve 2002 (Projekt, *Strategjia e shëndetit të Fëmijëve*, Janar 2007).

Personeli shëndetësor nuk merr trajnim për në identifikimin e lëndimeve jo-aksidentale.

Grafiku tregon strukturën institucionale të sektorit shqiptar të shëndetësisë.

Grafiku tregon strukturën institucionale të sektorit shqiptar të arsimit. Ngjyrat janë përdorur në grafik për të dalluar midis niveleve të ndryshme – qendrore (e kuqe), qark/rajonale (blu), bashki ose komunë (e gjelbër) dhe ofrues shërbimesh (e verdhë).

**Diagrama 5:
Sektori i Shëndetësisë**




Figura 5:Sektori i Shëndetësisë

Shigjetat e trasha brenda grafikut paraqesin marrëdhëniet strukturore institucionale dhe janë vijat e varësisë kryesore. Shigjetat e holla ndërmjet institucioneve apo personave janë shënuar me "flamuj" për të treguar rëndësinë e tyre. Grafiku nuk

paraqet të gjithë drejtoritë apo sektorët në Ministrinë e Shëndetësisë. Ai kërkon të identifikojë aktorët kryesorë, që lidhen me Sektorin e Drejtësisësi një kompetent brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Madhësia e kutisë nuk ka lidhje me numrin e personelit apo burimet nënjë drejtori, seksion apo institucion tjetër (Hamilton,C. Malby,S. Ross,G. 2007:77).

2.8.6. *Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri*

Koncepti për mjedisin mbrojtës.

Instrumentatparësore ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve janë Konventat Kombeve të Bashkuarapër të Drejtat e Fëmijëvevitit 1989, ratifikuar nga Shqipëria më 27 Shkurt 1992 dhe Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (Konventa Evropiane) e ratifikuar në vitin 1996.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC) i referohet drejtëpërdrejtëtë drejtës së fëmijës për tu mbrojtur. Nenet 3 dhe 8 të Konventës Evropiane përcaktojnë që fëmijët kanë të drejtën të mbrohen nga trajtimi apo ndëshkimi çnjerëzor dhe degradues dhe të drejtën të kenë një familje apo jetë private. E drejta për të drejtë private përfshin të drejtën për integritet fizik.

Neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara(KB) mbi të Drejtat e Fëmijës përbën gurin e themelitpër konceptin e mbrojtjes së fëmijëve. Ai përcakton kategoritë e dëmit nga i cili duhet të mbrohen fëmijët-*"të gjithë format e dhunës fizike, lëndimit apo abuzimit, neglizhimit apo trajtimit të neglizhuar, keqtrajtimit apo shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual"*si dhe specifikon hapat konkrete, që duhet të ndërmerren shtetet për të siguruar këtë mbrojtje - *"të gjithë masat e përshtatshme legislative, administrative, sociale dhe edukative...për të dhënë mbështetjen e nevojshme për*

fëmijën...si dhe format e tjera të parandalimit dhe për identifikimin, raportimin, referimin, hetimin, trajtimin, dhe ndjekjen e rasteve të keqtrajtimin të fëmijëve".

Kjo mbrojtje ka të bëjë me temën e doktoraturës. Dhunë në shkollë përkufizohet si: *"forcimi i mjedisit, kapaciteteve dhe ndërhyrjeve për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi, neglizhimi dhe efektet e konfliktit".*

Ky përkufizim përmban një numërvlerash shumë të rëndësishme, të cilat aty ku forcohen apo dobësohen mund të kenë ndikim mbi masën në të cilën fëmijët përjetojnë mbrojtjen nga dëmi: *"mjedisi", "kapacitetet", dhe "përgjigjet"* e vendit.

Termi *"mjedisi i vendit"* përfshin familjen më të afërt të fëmijës dhe komunitetin në të cilin ai jeton, përveç kontekstit më të gjërësocio-ekonomik, politik dhe kulturor të vendit. Çdo kërcënim për integritetin dhe sigurinë e fëmijës, si rregull duhet të vijë nga ky mjedis qoftë nëse dhuna vjen nga një anëtar i afërt i familjes apo një person, që njihet pak nga fëmija i cili kërkontë shfrytëzimin e fëmijës.

Termet *"kapacitete"* dhe *"përgjigje"* kanë të bëjnë me sistemet specifike formale dhe joformale, që punojnë për të mbrojtur fëmijën. Këto sisteme janë mburoja e fëmijës kundër dhunës. Ato përbëhen nga struktura konkrete dhe institucione të krijuara nga shteti, aktorë përkatës jo-publikë, rrjetet informale dhe modelet e sjelljes. Nëse punojnë në mënyrë efektive, ato duhet të plotësojnë kërkesat e parashtruara nënë 19 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës: dhënia e mbështetjes, parandalimit, identifikimit, raportimit, referimit, hetimit, trajtimit dhe të ndjekjes së fëmijës në rrezik dhe fëmijës viktimë. Në kuadrin konceptual për mbrojtjen e fëmijëve parashikohet një *"mjedis mbrojtës"*, në të cilin secili i përgjigjet përgjegjësit të tij për të siguruar, që fëmijët të mbrohen nga dhuna.

Ky mjedis ka të bëjë me 8 elementë:

1. Qëndrimet, traditat, zakonet, sjellja dhe praktika.
2. Angazhimi qeveritar për të plotësuar të drejtat e mbrojtjes së fëmijëve.
3. Diskutim i hapur dhe angazhim në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
4. Legjislacion dhe zbatim mbrojtës.
5. Kapaciteti në rradhët e atyre, që janë pranë fëmijëve.
6. Aftësitë e fëmijëve për jetën, njohuritë dhe pjesëmarrja.
7. Monitorimi dhe raportimi i çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve.
8. Shërbime për rikuperimin dhe riintegrimin.

Shteti, komunitetet dhe familjet mund të parandalojnë dhe trajtojnë dhunën, shfrytëzimin dhe abuzimin nëpërmjet sistemeve efektive kombëtare të mbrojtjes së fëmijëve, praktikave të përshtatshme sociale, mbikqyrjes dhe monitorimit të sistemeve, praktikës dhe fuqizimit të fëmijëve.

Një sistem funksional i mbrojtjes së fëmijëve duhet të përfshijë të gjithë sektorët kyç (shërbimet sociale, arsimin, shëndetin, policinë dhe drejtësinë) në një përpjekje për të bashkërenduar identifikimin, regjistrimin, vlerësimin, referimin, dhënien e mbështetjes së specializuar, ndjekjen riintegruese të fëmijëve dhe familjeve të prekura nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi.

Shtyllat e mjedisit mbrojtës:

1. Aftësia, njohuritë, praktikat dhe burimet e prindërve ose familjes, apo kujdestarit tjetër më të afërt, i cili është përgjegjës për fëmijën.
2. Normat, praktikat, vlerat dhe mbështetja e komunitetit dhe shoqërisë ku jeton fëmija.

3. Elementë specifike të sistemit të qeverisjes si: kuadri ligjor dhe politik, standardet,mandatet, që udhëheqin shërbimet sociale dhe kompetenca, sjellja dhe përgjegjshmëria e profesionistëve në kontakt me fëmijët.

Sistemi ligjor dhe rregullator dhe sistemi i mbrojtjes sociale kanë mundësinë të luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. (Hamilton,C. Malby,S. Ross,G. 2007:96).



Figura 6: Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve




Figura 7: Përgjigjet urgjente të mbrojtjes së fëmijëve

PJESA E DYTË: STUDIMI EMPIRIK

KAPITULLI III: METODOLOGJIA E KËRKIMIT

3.1. Shfrytëzimi i kuadrit teorik në funksion të realizimit të studimit empiric

Teoritë mbi dhunën janë të shumta. Një pjesë e mirë e tyre është përfshirë në kuadrin teorik të këtij punimi. Megjithatë, në funksion të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave bazë të këtij studimi, vetëm një pjesë e kuadrit teorik do të shfrytëzohet në mënyrë më të detajuar tek pjesa e studimit empirik, mbledhjes, përpunimit dhe interpretimit të të dhënave. Çështjet kryesore të kuadrit teorik të cilat do të shërbejnë si instrumente për të realizuar analizën e të dhënave empirike janë:

Së pari, pjesa e kuadrit teorik që shpjegon çfarë është dhuna dhe cilat janë përmasat e saj përbën një nga elementët më të rëndësishëm në këtë punim .

Së dyti, dhuna ndikon në performancë dhe rezultatet akademike, realizon pjesën e studimit empirik dhe ka të bëjë me analizën e detajuar.

Së treti, indikatorët e matjes së dhunës do të jenë pjesë integrale e këtij studimi. Pavarësisht se matja e nivelit të dhunës mund të realizohet përmes indikatorëve të ndryshëm, për efekt të këtij studimi do të merren në konsideratë vetëm indikatorët e matjes së dhunës në nivel shkolle, klase, gjinie dhe niveli.

Së fundmi, metodologjia e kërkimit do të jetë në funksion të studimit dhe analizës së të dhënave empirike. Në mënyrë të veçantë, analiza SWOT do të jetë pjesë e rëndësishme e asaj çfarë do të tentohet të shtohet si element i ri në modelin ekzistues

dhe do të zërë gjithashtu një vend të rëndësishëm në pjesën e rekomandimeve të këtij punimi.

3.2. Burimet e informacionit

Rikujtojmë edhe njëherë se katër pyetjet bazë kërkimore të këtij punimi janë:

- 1. A ekziston dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme të Peshkopisë, Prizrenit dhe Dibrës së Madhe?*
- 2. Kush janë përmasat e dhunës në shkollat e mesme?*
- 3. Sa ndikon dhuna në performancën dhe arritjet e nxënësve ?*
- 4. Si mund të trajtohet nga ana pedagogjike dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme?*

Ndërkohë, Hipotezat bazë të këtij studimi janë:

- 1. Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është në rritje.*
- 2. Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ndikon në performancë dhe rezultatet arsimore të nxënësit.*

Siç është saktësuar që në fillim të këtij studimi, bazuar tek literatura dhe hulumtimet ekzistuese mbi dhunën, dhuna do të jetë variabël e pavarur dhe performanca, rezultatet e nxënësit, niveli i dhunës, do të jenë variabla të ndryshuara.

Dy burimet kryesore të informacionit për testimin e këtyre hipotezave janë:

I-Burime Parësore:

Të dhënat e mbledhura drejtëpërdrejtë në 520 nxënës, 50 mësues, 100 prindër, 5 mjekë dhe 20 të intervistuar. Meqë numri i rasteve individuale është shumë i madh jemi përcaktuar që problemi të kërkohet vetëm në një grup përfaqësues nga 1 shkollë të zonës rurale, 2 shkolla të zonës urbane dhe 2 shkolla të zonës rajonale.

Këto të dhëna janë mbledhur nga një pyetësor i integruar, i përgatitur posaçërisht për këtë studim. Pyetësi i nxënësve ka në total 23 pyetje me fund të mbyllur dhe 4 me fund të hapur. Pyetësi i mësuesve ka në total 17 pyetje me fund të mbyllur dhe 5 pyetje me fund të hapur.

Pyetësi i prindërve ka në total 9 pyetje me fund të mbyllur.

Pyetësi i mjekëve ka në total 7 pyetje me fund të mbyllur.

Pyetësi është përpunim i pyetësit të Projektit COMBI (Communication for Behavioral Impact-Komunikim për Ndryshimin e Sjelljes) në shkolla dhe përdorimi i kartave PEET.

II-Burime Dytësore:

Shfrytëzimi i literaturës ekzistuese dhe studimeve të ndryshme mbi dhunën në shkollat e mesme.

Citimi i të dhënave nga raporte të ndryshme të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me dhunën në shkolla.

3.3 Kampioni i studimit

Studimi është realizuar në shkollat e mesme: “Gjimnazi Maqellarë“, “Said Najdeni”, “Nazmi Rushiti” Peshkopi, “Remzi Ademaj” Prizren, Kosovë dhe “28 Nëntori” Dibër e Madhe, Maqedoni.

Lista e plotë e shkollave, përzgjedhja si dhe kontaktet e tyre janë siguruar pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale.

Pas autorizimit nga DAR është ndërhyrë me pyetësorët në këto shkolla.

Popullacioni: nxënësit, mësuesit, prindërit, psikologët, drejtuesit në “Gjimnazi Maqellarë”, Gjimnazi “Said Najdeni”, Shkolla e Mesme Profesionale “Nazmi Rushiti” Peshkopi, Gjimnazi “Remzi Ademaj” Prizren, Gjimnazi “28 Nëntori” Dibër e Madhe dhe përfaqësues të Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve.

Madhësia e kampionit. Kërkimin e problemit në planin teorik e kemi arritur nëpërmjet konsultimit të literaturës dhe të burimeve të tjera, prandaj në mbështetje të realizimit të detyrave, të qëllimit dhe metodave të kërkimit është shtruar mënyra e organizimit të kërkimeve. Madhësia e mostrës:

$$p = P \times 10\%$$

Madhësia e kampionit: 520 nxënës, 50 mësues, 100 prindër, 5 mjekë dhe 20 të intervistuar. Meqë numri i rasteve individuale është shumë i madh jemi përcaktuar që problemi të kërkohet vetëm në një grup përfaqësues nga disa shkolla të zonës rurale, urbane dhe rajonale.

Në studim përdorëm intervistën, si metodën më të njohur të kërkimit cilësor pasi ajo siguron material për analiza cilësore.

20 intervista janë realizuar me persona kyç. Të intervistuarit janë zgjedhur nga pozicionet më të larta në institucionet e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve.

Ata u gjykuan se kanë më tepër përvojë profesionale dhe përgjegjësi aktuale.

Gjatë intervistave u bënë të gjitha pyetjet e përgatitura në varësi të personit që jepte sqarime dhe pyetje të tjera shtesë me qëllim trajtimin më të detajuar të problemit. Kohëzgjatja e intervistave sillej nga 30 - 40 deri në 60 minuta. Kohëzgjatja ndryshonte në varësi të rastit.

3.4 Metodologjia, metodat dhe instrumentet bazë të hulumtimit

Ky punim ka karakter vlerësues. Metodatat bazë sipas të cilave do të realizohet një analizë e tillë vlerësuese kanë të bëjnë me korrelacionin ndërmjet variablave si dhe analizën e regresionit. Një pjesë të rëndësishme të analizës zë krahasimi i dhunës ndërmjet shkollave, klasave gjatë periudhës kohore 2012-2014. Instrumenti bazë i mbledhjes së të dhënave të studimit empirik është pyetësori.

Krahasimi i të dhënave sasiore (të marra nga raporte dhe analiza të ndryshme statistikore) me të dhënat cilësore të studimit empirik (të siguruarat përmes pyetësorëve të shpërndarë në shkollat) me synim testimin e hipotezave të shtruarat në këtë punim. Përpunimi i të dhënave të studimit është bërë në programin SPSS Statistics 26. Pyetjet janë koduar në këtë program sipas tipit numerik në mënyrë që të ishte i mundur përpunimi statistikor i tyre.

3.5. Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre

3.5.1 Pyetësi

Të dhënat i përkasin periudhës 2012-2014. Këto të dhëna janë mbledhur nga një pyetësor i integruar, i përgatitur posaçërisht për këtë studim. Pyetësi i nxënësve ka në total 23 pyetje me fund të mbyllur dhe 4 pyetje me fund të hapur. Pyetësi i mësuesve ka në total 17 pyetje me fund të mbyllur dhe 5 pyetje me fund të hapur.

Pyetësi i prindërve ka në total 9 pyetje me fund të mbyllur.

Pyetësi i mjekëve ka në total 7 pyetje me fund të mbyllur.

Pyetësi është përpunim i pyetësorit të Projektit COMBI (Communication for Behavioral Impact - Komunikim për Ndryshimin e Sjelljes) në shkolla dhe përdorimi i kartave PEET.

Një pjesë e konsiderueshme e pyetjeve kanë disa nënseksione. Në pjesën më të madhe të rasteve përgjigjet e pyetjeve në pyetësor janë të shkallëzuara sipas 5 shkallëve të Likert, nga asnjëherë në më shumë se tre herë. Të dhënat në SPSS janë hedhur të koduara, në mënyrë që të kuantifikohet natyra cilësore e pyetjeve në pyetësor. Në ato raste ku ka qenë e nevojshme është aplikuar edhe procesi i rikodimit të të dhënave me qëllim standartizimin logjik të përgjigjeve.

Pyetësi është i ndarë në tre pjesë kryesore. Pjesa e parë e pyetjeve tentojnë të japin të dhëna demografike të shkollës. Përmes kësaj pjese synohet të jepet një informacion i përgjithshëm i gjendjes së shkollës për të zgjedhur kampionin. Ndërkohë, pjesa e dytë e pyetjeve kanë të bëjnë me dhunën në shkollë, përmasat e saj dhe ndikimin në performancë dhe qëndrimin ndaj shkollës. Pjesa e fundit e pyetësorit

ka të bëjë me qasjen ndaj Internetit dhe TIK në *"Teen Dating Violence"* dhe *"Bulling Violence"* *"Cyberbullying"* dhe *Projekte ndërkurrikulare*.

3.5.2. Pyetësi Pilot

Përpara se të shpërndahej version final i pyetësit tek të gjitha shkollat është eksperimentuar me një pyetësor paraprak pilot. Ky pyetësor pilot i është dërguar shkollës për ta plotësuar si dhe për të bërë të gjithë vërejtjet e mundshme dhe rekomandimet lidhur me përmirësimin e këtij pyetësi. Të gjithë shkollat përdorin gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare. Ndryshimi është në sistemin shkollor 3-4 vjeçar.

Të dyja këto rekomandime u morën në konsideratë duke bërë një modifikim të pyetjeve që kishin të bënin me klasën. Disa kërkonin të shmangeshin, por në bashkëbisedim e sipër u bindën për të plotësuar pyetësin si faktorë të kerkimit shkencor. Psikologët dhe mjekët nuk qenë shumë bashkëpunues duke u shprehur për parimin e konfidencialitetit, por në të vërtetë nuk kishin statistika të punës së tyre. Me ta u diskutua se rezultatet nga pyetësi do të shfrytëzohen vetëm për qëllime shkencore.

3.5.3. Përpunimi i të dhënave

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësit të përmendur më sipër, janë hedhur në Programin IBM SPSS Statistics 26 në bazë të kodimit përkatës. Kodet për pyetjet kategorike po/jo janë 1/2 ndërsa kodet për pyetjet asnjëherë deri në më shumë se tre herë janë koduar me shifrat nga 1 në 5.

Më pas, analiza e të dhënave ka kaluar në disa faza.

a.Faza e I-rë: Analiza përshkruese statistikore - kjo lloj analize përshkruese statistikore jep një panoramë të përgjithshme të rezultateve të punimit. Në këtë analizë përshkruhen rezultatet e përgjithshme të studimit në përqindje. Përmes saj bëhet i mundur identifikimi paraprak i disa prej variablave më të rëndësishëm të cilët mund të shpjegojnë variablin kryesorë të varur i cili në rastin konkret është niveli i dhunës në shkollë.

Faza e II-të: Rikodimi i të dhënave - kjo fazë është shumë e rëndësishme pasi gjatë hartimit të pyetësorit, me qëllim që ky i fundit të mos plotësohet në mënyrë mekanike, ka renditje të ndryshme të vlerave të përgjigjeve. Për shembull, në një pyetje mund të kërkohej 'të menduarit për vetëvrasje' dhe përgjigjia e pyetjeve kodohet nga asnjëherë =1 deri në më shumë se tre herë =5, ku vlera 5 në këtë rast është pozitive, ndërkohë që në një pyetje tjetër mund të kërkohej të mbahet qëndrim lidhur me 'si ndikojnë rastet e dhunës, dhe kodimi nga bëheni më njerëzor=1 dhe veprimtari-sport =5 do të nënkuptonte totalisht diçka tjetër. Për këtë arsye, rikodimi është një proces i domosdoshëm i cili minimizon gabimet logjike gjatë përpunimit të të dhënave.

Faza e III-të: Agregimi i të dhënave përmes Analizës Faktoriale - duke qenë se pyetësi ka në total 23 pyetje për nxënësit, 17 pyetje për mësuesit, 9 pyetje për prindërit, 7 pyetje për mjekët dhe një numër të konsiderueshëm indikatorësh për secilën prej tyre, agregimi i tërësisë së variablave të veçantë në disa variabla kryesorë të përveçëm është një hap i domosdoshëm. Sa shpesh përdoret dhuna në secilën prej shkollave është tendenca e frekuencës së dhunës duke iu përgjigjur 1 pyetjeje nga të gjitha shkollat ose frekuenca e ushtrimit të dhunës verbale sipas klasave në secilën shkollë.

Faza e IV-t: Analiza cross-tabulation – përmes kësaj analize do të kemi mundësinë të shohim nëse ekziston ndonjë lidhje ndërmjet nivelit të dhunës në shkollë dhe variablave të pavarur që kushtëzojnë nivelin e dhunës. Në mënyrë specifike, përmes analizës cross-tabulation do të shohim nëse ekziston ndonjë lidhje ndërmjet nivelit të dhunës dhe performancës si dhe ndërmjet nivelit të dhunës dhe qëndrimit ndaj shkollës.

Faza e V-të: Analiza e regresionit linear - pas analizës cross-tabulation, bëjmë testin e besueshmërisë dhe vlefshmërisë për nxënësit dhe për mësuesit, Analizën e regresionit linear dhe ANOVA.

KMO duhet të jetë më e madhe se 0.5 dhe Chi Square më e madhe se 5000 ($\chi^2 > 5000$).

Kjo do të thotë që testimi i bërë është i vlefshëm, rezultatet janë të vlefshme dhe rrjedhimisht pasqyrojnë siç duhet dukurinë e dhunës në shkollë, që po studiojmë.

3.6. Vështirësitë e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave në terren

Vështirësitë e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave në terren për këtë studim kanë qenë të shumta:

Shtrirja gjeografike, ndryshimet e drejtuesve të institucioneve të komanduar nga DAR.

Mungesa e gadishmërisë së tyre për të bashkëpunuar dhe për të plotësuar pyetësonin. është justifikuar me pretekstin e konfidencialitetit të të dhënave të institucionit.

Niveli i ulët të besimit ndaj reformave dhe rikonceptim të kërkimit shkencor dhe në aftësinë për të përmirësuar konkretisht aktivitetet e përditshme të jetës së shkollës.

Drejtuesit nuk ishin të familjarizuar me konceptin e studimit shkencor.

Mungesa e psikologut të shkollës në Maqellarë dhe Prizren.

Mungesë statistikash nga psikologët dhe mosbashkëpunim me drejtorët (rivalë), pasi varen nga DAR dhe nuk asistuan në plotësimin e pyetësorit duke e konsideruar si monitorim i punës së tyre.


Megjithatë, pavarësisht këtyre vështirësive të hasura, realizimi i 520 pyetësorëve tregon që është arritur një nivel i konsiderueshëm bashkëpunimi dhe se ky bashkëpunim mund të përmirësohet edhe më tej në të ardhmen me projekte të përbashkëta ndërkufitare. Forcimi i bashkëpunimeve gjimnaz-universitet konsiderohet një element shumë i rëndësishëm që ndikon pozitivisht në arsimimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të një vendi.

3.7 Përmbledhje e kapitullit

Kemi shpjeguar kështu pjesën e kuadrit teorik që është shfrytëzuar për këtë studim, metodologjinë e punimit, metodat dhe instrumentat e studimit. Gjithashtu, në këtë kapitull u shpjeguan burimet e informacionit, mënyra e mbledhjes së të dhënave, si dhe mënyrën e formulimit të pyetësorit. Pjesa e fundit e kapitullit ka shpjeguar në detaje popullatën dhe kampionimin e studimit, si dhe llojet e analizave të përdorura për përpunimin e të dhënave. Vështirësitë e hasura në mbledhjen e të dhënave janë trajtuar në fund të këtij kapitulli metodologjik. Ndërkohë, kapitulli vazhdon me analizën e të dhënave empirike dhe testimin e hipotezave të studimit rajonal mbi dhunën në shkollat e mesme.

3.8 Analizë e pyetësorit të nxënësve

Pasi kemi diskutuar në nivel teorik dhe kuadër konceptual thuajse pjesën më të madhe të teorive, modeleve dhe diskutimeve mbi dhunën në shkollë, në dy kapitujt vijues do të diskutojmë rezultatet empirike të studimit të shtrirë në 5 shkolla të rajonit. Përmes këtyre rezultateve do të bëhet i mundur vërtetimi ose hedhja poshtë e hipotezave të ngritura që në fillim të këtij studimi. Pjesa e parë e analizës jep një informacion të përgjithshëm lidhur me shkollat e përfshira në studim, ndërkohë që pjesa e dytë analizon më në detaje lidhjen ndërmjet nivelit të dhunës (si variabël i varur) dhe faktorëve të tjerë (si variabla të pavarur). Analiza e regresionit do të na ndihmojë të kuptojmë se si qëndron lidhja ndërmjet këtyre variablave, duke shpjeguar edhe mënyrën e ndryshimit të tyre .



Grafiku 3.8.1: Pjesëmarrja sipas gjinisë

Kampioni në Gjimnazin "Said Najdeni" përbën 10% të popullatës të marrë në studim ose 170 nxënës prej të cilëve 75 djem ose 14.42% dhe 95 vajza ose 18.27%. Mbizotërojnë vajzat. Kjo është një anë e fortë e gjimnazit. Duke pasur parasysh që në Peshkopi ka shumë familje që kanë ardhur nga zonat rurale është rritur ndërgjegjësimi i prindërve për të arsimuar vajzat. Gjithashtu anë e dobët është se djali në shtëpi shihet si mbështetje e fortë e ekonomisë financiare dhe shumë nga djemtë kanë emigruar jashtë duke kërkuar azil ose kanë vazhduar studimet në institucione jopublike. Fakti që shumë nga djemtë janë larguar drejt vendeve të Evropës Perëndimore është një problem social dhe mund të çojë në plakje të shoqërisë ose shkretim të saj. Mendoj se duhet të ndryshojnë politikat arsimore dhe të jetë një studim më vete.


Kampioni në Shkollën Profesionale "Nazmi Rushiti" përbën 10% të popullatës të marrë në studim ose 70 nxënës prej të cilëve 35 djem ose 6.73% dhe 35 vajza ose 6.73%. Kemi një barazi gjinore. Duke patur parasysh se është shkollë profesionale me konvikt prindërit kanë prirje të dërgojnë vajzat në drejtim gjuhësor dhe djemtë në drejtim teknologjik. Shkollën ka një qasje drejt projekteve dhe dixhitalizimit të saj.

Kampioni në Gjimnazin Maqellarë përbën 10% të popullatës të marrë në studim ose 70 nxënës prej të cilëve 35 djem ose 6.73% dhe 35 vajza ose 6.73%. Barazia gjinore është një anë e fortë e gjimnazit. Qëllimi im si ish-nxënëse dhe mësuese e gjimnazit prej 20 vitesh ka qenë arsimimi i vajzave dhe ia kemi dalë me sukses. Problem i kohëve të fundit është se gjimnazi ashtu si dhe në shumë shkolla të tjera është prekur nga sindromi i azilit ekonomik në vende të Evropës Perëndimore si: Gjermania, Franca, Suedia, Norvegjia, Holanda dhe Italia. Gjë u vu në dukje në vitin shkollor 2015-2016, ku 42 nxënës braktisën shkollën. Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë, Bashkia Dibër dhe Drejtoria Arsimore Dibër

duhet të hartojnë politika arsimore, që shkolla të ketë përparësi, sepse shumë shpejt do të kemi plakje të shoqërisë.

Kampioni në Gjimnazin "Remzi Ademaj" përbën 10% të popullatës të marrë në studim ose 140 nxënës prej të cilëve 50 djem ose 9.62% dhe 90 vajza ose 17.31%. Mbizotërojnë vajzat, pasi është gjimnaz me drejtim gjuhësor.

Kampioni në Gjimnazin "28 Nëntori" përbën 10% të popullatës të marrë në studim ose 70 nxënës prej të cilëve 35 djem ose 6.73% dhe 35 vajza ose 6.73%. Fakti që shumë nga djemtë janë larguar drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës është një problem social dhe mund të çojë në plakje të shoqërisë ose shkretim të saj. Mendoj se duhet të ndryshojnë politikat arsimore dhe të jetë një studim më vete.



Grafiku 3.8.2: Pjesëmarrja sipas klasës

Kampioni në Gjimnazin "Said Najdeni" përbëhet nga 60 nxënës ose 11.54 % të klasës së 10-të, 50 nxënës ose 9.62 % të klasës së 11-të, 60 nxënës ose 11.54 % të klasës së 12 dhe nuk kemi asnjë nxënës nga klasa e 13, pasi ishin me korrespondencë dhe vinin vetëm për provim në fund të vitit. Vihet re një numër më i vogël në klasë të 11. Një numër i madh nxënësish, që mbeten në klasë të 10 janë përsëritës të klasës së 10 mund të jenë një faktor plus që ndikojnë në rritjen e dhunës në klasë në shenjë hakmarrje për suksesin e dobët dhe zgjedhin dhunën për t'u bërë lider të shkollës.

Kampioni në Shkollën Profesionale "Nazmi Rushiti" përbëhet nga 20 nxënës ose 3.85% të klasës së 10-të, 20 nxënës ose 3.85 % të klasës së 11-të, 20 nxënës ose 3.85 % të klasës së 12 dhe 10 nxënës ose 1.925 % nga klasa e 13. Vihet re një numër më i vogël në klasë të 13. Shkolla është profesionale dhe ka patur drejtim gjuhësor, drejtimi teknologjik ka qenë pjesë e politikës së shkollës, por kjo gjeneratë nuk ka arritur në klasë të 13-të, por vetëm drejtimi gjuhësor.

Kampioni në Gjimnazin Maqellarë përbëhet nga 25 nxënës ose 4.81 % të klasës së 10-të, 25 nxënës ose 4.81% të klasës së 11-të, 20 nxënës ose 3.85 % të klasës së 12 dhe nuk kemi asnjë nxënës nga klasa e 13 pasi sistemi arsimor është 3-vjeçar. Vihet re një numër më i vogël në klasë të 12. Kjo vjen për arsye se një numër i madh nxënësish mbeten në klasë të 10 dhe 11. Nxënësit e klasës së 12 kalojnë ndrrimin e orës në korridorret e shkollës ose pas pushimit të gjatë vijnë me vonesë duke u bërë jo vetëm shkak, por dhe aktorë në shfaqje të dhunës në oborrin e shkollës.


Kampioni në Gjimnazin "Remzi Ademaj" përbëhet nga 53 nxënës ose 10.19 % të klasës së 10^{-të}, 47 nxënës ose 9.04 % të klasës së 11^{-të}, 40 nxënës ose 7.69 % të klasës së 12^{-të} dhe nuk kemi asnjë nxënës nga klasa e 13, pasi është sistemi 9+3. Vihet re një numër më i vogël në klasë të 11^{-të} dhe të 12^{-të}. Kjo vjen për arsye se një numër i madh

nxënësish mbeten në klasë të 10^{-të} dhe 11^{-të}. Kjo pjesë e nxënësve përsëritës të klasës së 10^{-të} mund të jenë një faktor plus, që ndikojnë në rritjen e dhunës në klasë në shenjë hakmarrje për suksesin e dobët dhe zgjedhin dhunën për t'u bërë lider të shkollës.

Kampioni në Gjimnazin " 28 Nëntori " përbëhet nga 17 nxënës ose 3.27 % të klasës së 9^{-të}, 20 nxënës ose 3.85 % nxënës të klasës së 10^{-të}, 17 nxënës ose 3.27 % të klasës së 11^{-të}, 16 nxënës ose 3.08 % të klasës së 12^{-të}.

Mbizotëron dhuna në klasë të 10^{-të}, që do të thotë se në kulturën shqiptare djemtë janë rritur, pra problem të moshës. Ne duhet të ngremë ura komunikimi.

II. Dhuna fizike dhe psikologjike



Grafiku 3.8.3 : A jeni dhunuar?

Në Gjimnazin "Said Najdeni" 156 nxënës ose 29.89 % janë përgjigjur pozitivisht dhe 14 nxënës ose 2,68 % janë përgjigjur negativisht. Dhuna ekziston në shkallë shumë të lartë.

Në Shkollën Profesionale “Nazmi Rushiti” pyetjes jeni dhunuar: 54 nxënës ose 10.65 % janë përgjigjur pozitivisht dhe 16 nxënës ose 3.07 % janë përgjigjur negativisht. Nga grafiku mbisundon dukuria e dhunës në shkollë.

Në Gjimnazi Maqellarë pyetjes a jeni dhunuar: 66 nxënës ose 12.64 % janë përgjigjur pozitivisht dhe 4 nxënës ose 0.77 % janë përgjigjur negativisht. Dhuna ekziston në shkallë shumë të lartë.

Në Gjimnazin “Remzi Ademaj” pyetjes jeni dhunuar: 120 nxënës ose 22.99 % janë përgjigjur pozitivisht dhe 20 nxënës ose 3.83 % janë përgjigjur negativisht. Dhuna ekziston në shkallë shumë të lartë.

Në Gjimnazin “28 Nëntori” pyetjes jeni dhunuar: 64 nxënës ose 12.26 % janë përgjigjur pozitivisht dhe 6 nxënës ose 1.15 % janë përgjigjur negativisht. Dhuna ekziston në shkallë shumë të lartë.


Tabela 3.8.3 : A jeni dhunuar

VAR00003					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1.00	460	88.5	88.5	88.5
	2.00	60	11.5	11.5	100.0
	Total	520	100.0	100.0	

Pra, sipas pohimeve të shumicës së subjekteve nxënës ata janë viktimë të dhunës. Bazuar në vlerat e variablit: A jeni dhunuar sipas nxënësve rezulton se 88.5% e tyre pohojnë jo, ndërsa 11.5 % e tyre pohojnë (M= 1.1154; DS= .31979).

Pra, sipas pohimeve të shumicës së subjekteve nxënës ata janë viktimë të dhunës.

Sa shpesh përdoret dhuna ?



Grafiku 3.8.4 : Sa shpesh përdoret dhuna

Në Gjinnnazi " Said Najdeni" pyetjes ndodh përherë dhunë, 112 nxënës ose 21.54 % janë përgjigjur se ndodh shpesh dhunë, 31 nxënës ose 5.96 % janë përgjigjur se ndodh rrallëherë dhunë dhe 4 nxënës ose 0.77 % janë përgjigjur se nuk ndodh dhunë. Po të njëjtët nxënës në pyetjet e tjera të pyetësorit janë përgjigjur se janë dhunuar, gjë që tregon se në fillim hezituan ta pranojnë dukurinë e dhunës në shkollën e tyre. Në pyetjet e tjera ata na besuan mendimin e tyre duke bashkëpunuar. Vlen të theksohet fakti se asnjë nxënës nuk kundërshtoi t'i përgjigjet pyetësorit, pra nxënësit qenë bashkëpunues duke u bërë faktor i rëndësishëm i studimit.

Në Shkollën Profesionale "Nazmi Rushiti" pyetjes për dendurinë e dhunës 14 nxënës ose 2.69 % janë përgjigjur që ndodh përherë dhunë, 38 nxënës ose 7.31 % janë përgjigjur se ndodh shpesh dhunë, 12 nxënës ose 2.31 % janë përgjigjur se ndodh rrallëherë dhunë dhe 6 nxënës ose 1.15 % janë përgjigjur se nuk ndodh dhunë. Të

njëjtët nxënës që nuk janë dhunuar e pranojnë se në shkollë ka dhunë. Po të njëjtët nxënës në pyetjet e tjera të pyetësorit janë përgjigjur se janë dhunuar, gjë që tregon se në fillim hezituan ta pranojnë dukurinë e dhunës në shkollën e tyre. Në pyetjet e tjera ata na besuan mendimin e tyre duke bashkëpunuar.

Në Gjimnazi Maqellarë pyetjes për dendurinë e dhunës 4 nxënës ose 0.77 % janë përgjigjur që ndodh përherë dhunë, 41 nxënës ose 7.88 % janë përgjigjur se ndodh shpesh dhunë, 13 nxënës ose 2.5 % janë përgjigjur se ndodh rrallëherë dhunë dhe 2 nxënës ose 0.38 % janë përgjigjur se nuk ndodh dhunë. Po të njëjtët nxënës në pyetjet e tjera të pyetësorit janë përgjigjur se janë dhunuar, gjë që tregon se në fillim hezituan ta pranojnë dukurinë e dhunës në shkollën e tyre. Në pyetjet e tjera ata na besuan mendimin e tyre duke bashkëpunuar.

Në Gjimnazin "Remzi Ademaj" pyetjes për dendurinë e dhunës 12 nxënës ose 2.31 % janë përgjigjur që ndodh përherë dhunë, 38 nxënës ose 7.31 % janë përgjigjur se ndodh shpesh dhunë, 70 nxënës ose 13.46 % janë përgjigjur se ndodh rrallëherë dhunë dhe 20 nxënës ose 3.85 % janë përgjigjur se nuk ndodh dhunë. Po të njëjtët nxënës në pyetjet e tjera të pyetësorit janë përgjigjur se janë dhunuar, gjë që tregon se në fillim hezituan ta pranojnë dukurinë e dhunës në shkollën e tyre. Në pyetjet e tjera ata na besuan mendimin e tyre duke bashkëpunuar. Vlen të theksohet fakti se asnjë nxënës nuk kundërshtoi t'i përgjigjet pyetësorit, pra nxënësit qenë bashkëpunues duke u bërë faktor i rëndësishëm i studimit.


Në Gjimnazin "28 Nëntori" pyetjes për dendurinë e dhunës 4 nxënës ose 0.77 % janë përgjigjur që ndodh përherë dhunë, 16 nxënës ose 3.08 % janë përgjigjur se ndodh shpesh dhunë, 44 nxënës ose 8.46 % janë përgjigjur se ndodh rrallëherë dhunë dhe 6 nxënës ose 1.15 % janë përgjigjur se nuk ndodh dhunë.

Tabela 3.8.4: Sa shpesh përdoret dhuna

VAR00004					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1.00	57	11.0	11.0	11.0
	2.00	256	49.2	49.2	60.2
	3.00	169	32.5	32.5	92.7
	4.00	38	7.3	7.3	100.0
	Total	520	100.0	100.0	

Bazuar në vlerat e variablit: Sa shpesh përdoret dhuna se 60.2 % e tyre pohojnë përherë dhe shpesh, ndërsa 39.8% e tyre pohojnë rrallëherë dhe nuk ndodh (M= 2.00; DS= .77289).

Pra, sipas pohimeve të shumicës së subjekteve nxënës dhuna është e pranishme në shkollë.



Grafiku 3.8.5 : Jeni dhunuar?

Në Gjimnazin "Said Najdeni" 38 nxënës ose 7.31 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga një person, 48 nxënës ose 9.23 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga dy persona dhe 84 nxënës ose 16.15 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga të njëjtët tipa. Meqë mbisundon dhuna nga të njëjtët tipa, atëherë shkolla shihet si vend i krijimit të bandave dhe oborri apo korridoret e shkollës shërbejnë si arenë gladiatorësh ku shpesh depërtojnë dhe "të fortit" e rrugës.

Në Shkollën Profesionale "Nazmi Rushiti" pyetjes jeni dhunuar: 22 nxënës ose 4.23 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga një person, 22 nxënës ose 4.23 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga dy persona dhe 84 nxënës ose 16.15 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga të njëjtët tipa. Meqë mbisundon dhuna nga të njëjtët tipa, atëherë shkolla shihet si vend i krijimit të bandave dhe oborri apo korridoret e shkollës shërbejnë si arenë gladiatorësh ku shpesh depërtojnë dhe "të fortët" e rrugës. Fakti që shkolla ka konviktorë përpara shkollës nuk janë të pakta arenat e gladiatorëve apo nofkat mes palëve "burg" dhe kapërcimet e mureve. Policia shpesh bëhet zgjidhje e situatave.

Vlen të theksohet fakti se një nxënëse, të preferuarat e mësueses kujdestare kundërshtoi t'i përgjigjet pyetësorit, pasi në shkollën e saj nuk ka dhunë. Rasti Krenar.B ish nxënës i kësaj shkolle, ajo na besoi se ish dhunuar.

Në Gjimnazin Maqellarë 15 nxënës ose 2.88 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga një person, 37 nxënës ose 7.12 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga dy persona dhe 18 nxënës ose 3.46 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga të njëjtët tipa. Meqë mbisundon dhuna nga dy persona, atëherë shkolla ka tendencë për krijim të bandave dhe oborri apo korridoret e shkollës shërbejnë si arenë gladiatorësh ku shpesh depërtojnë dhe "të fortët" e rrugës.

Kohëve të fundit ka një tendencë të zënive të vajzave, ku fillojnë me debatet në facebook dhe mbarojnë me spektakle në oborrin e shkollës. Paaftësia për t'u bërë lidere të shkollës nëpërmjet të mësuarit zgjedhin dhunën si rrugën më të lehtë.

Në Gjimnazin "Remzi Ademaj" 103 nxënës ose 19.81 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga një person, 12 nxënës ose 2.31 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga dy persona dhe 25 nxënës ose 4.81 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga të njëjtët tipa. Meqë mbizotëron dhuna nga një person, duhet të jetë shenjë alarmi për drejtuesit e shkollës të ndërhyjnë që dhuna të mos bëhet vlerë e shkollës.


Në Gjimnazin " 28 Nëntori " 35 nxënës ose 6.73 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga një person, 20 nxënës ose 3.85 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga dy persona dhe 15 nxënës ose 2.88 % janë përgjigjur se janë dhunuar nga të njëjtët tipa. Meqë mbizotëron dhuna nga një person mundet që dhuna në shkollë të izolohet si dukuri.

Tabela 3.8.5 : Jeni dhunuar?

VAR00005					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1.00	213	41.0	41.0	41.0
	2.00	139	26.7	26.7	67.7
	3.00	168	32.3	32.3	100.0
	Total	520	100.0	100.0	

Bazuar në vlerat e variablit: Jeni dhunuar se 41% e tyre pohojnë 1 person, ndërsa 59% e tyre pohojnë 2 persona dhe të njëjtët tipa (M= 1.9135; DS= .85241).

Pra, sipas pohimeve të shumicës së subjekteve nxënës dhunuesit kanë tendencë të bëhen grup i " të fortit".



Grafiku 3.8.6 : Shkak i dhunës

Në Gjimnazin "Said Najdeni" shkakët e dhunës: 39 nxënës ose 7.5 % janë përgjigjur se shkak i dhunës në shkollë është mospërgatitja, 51 nxënës ose 9.81 % janë përgjigjur se shkak ka qenë sjellja jokorrekte, 35 nxënës ose 6.73 % janë përgjigjur se shkak i dhunës është person i dhunshëm dhe 45 nxënës ose 8.65 % konsumim i pijeve. Nxënësit tregojnë që pas pushimit të gjatë shkolla kthehet në vend gumëzhitjeje.

Në Shkollën Profesionale "Nazmi Rushiti" pyetjes shkakët e dhunës: 12 nxënës ose 2.31 % janë përgjigjur se shkak i dhunës në shkollë është mospërgatitja, 28 nxënës ose 5.38 % janë përgjigjur se shkak ka qenë sjellja jokorrekte, 17 nxënës ose 3.27 % janë përgjigjur se shkak i dhunës është person i dhunshëm dhe 13 nxënës ose 2.5 % konsumim i pijeve. Nxënësit tregojnë që pas pushimit të gjatë shkolla kthehet në vend gumëzhitjeje. Shkak bëhet dhe pozicioni i shkollës afër stacionit të linjave me qytetet e Tiranës, Durrësit, Kukësit, Prizrenit dhe Dibrës së Madhe. Fakti që shumë të rinj janë

pa punë apo kthehen nga emigracioni sezonal dhe bëhen gardianë para derës së shkollës.

Jo të pakta janë rastet e dyluftimeve mes gardianëve të jashtëm me nxënësit e shkollës dhe ndërhyrjeve të forcave të rendit.

Në Gjimnazin Maqellarë pyetjes shkaqet e dhunës: 8 nxënës ose 1.54 % janë përgjigjur se shkak i dhunës në shkollë është mospërgatitja, 37 nxënës ose 7.12 % janë përgjigjur se shkak ka qenë sjellja jokorrekte, 13 nxënës ose 2.5 % janë përgjigjur se shkak i dhunës është person i dhunshëm dhe 12 nxënës ose 2.31 % konsumim i pijes. Nxënësit tregojnë që pas pushimit të gjatë shkolla kthehet në vend gumëzhitjeje. Rritja e numrit të orëve të edukimit fizik, mungesa e mjediseve sportive, mungesa e punonjësit të sigurisë te porta kryesore, familjarizimi me inspektorët e policisë dhe ndrimi i 4 drejtorëve brenda dy viteve ndikojnë në dukurinë e dhunës në shkollë.

Në Gjimnazin "Remzi Ademaj" pyetjes shkaqet e dhunës: 97 nxënës ose 18.65 % janë përgjigjur se shkak i dhunës në shkollë është mospërgatitja, 14 nxënës ose 2.69 % janë përgjigjur se shkak ka qenë sjellja jokorrekte, 21 nxënës ose 4.04 % janë përgjigjur se shkak i dhunës është person i dhunshëm dhe 8 nxënës ose 1.54 % konsumim i pijeve. Objekt i rrjeteve sociale është bërë dhuna mes vajzave në mjediset e shkollës.


Në Gjimnazin " 28 Nëntori " pyetjes shkaqet e dhunës: 10 nxënës ose 1.92 % janë përgjigjur se shkak i dhunës në shkollë është mospërgatitja, 38 nxënës ose 7.31 % janë përgjigjur se shkak ka qenë sjellja jokorrekte, 22 nxënës ose 4.23 % janë përgjigjur se shkak i dhunës është person i dhunshëm dhe asnjë nxënës ose 0 % konsumim i pijeve. Nxënësit tregojnë që pas pushimit të gjatë shkolla kthehet në vend gumëzhitjeje.

Tabela 3.8.6 : Shkaku i dhunës

VAR00006					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1.00	166	31.9	31.9	31.9
	2.00	169	32.5	32.5	64.4
	3.00	107	20.6	20.6	85.0
	4.00	78	15.0	15.0	100.0
	Total	520	100.0	100.0	

Bazuar në vlerat e variablit: Shkaku i dhunës se 31.9% e tyre pohojnë mospërgatitja, ndërsa 53.1% e tyre pohojnë sjellja jokorrekte dhe person i dhunshëm, 15 % konsumon pije (M= 2.1865; DS= 1.04583).

Pra, sipas pohimeve të shumicës së subjekteve nxënës dhuna kanë tendencë të rritet



Grafiku 3.8.7 : Format e dhunës verbale

Pyetjes mbi formën e dhunës në Gjimnazin "Said Najdeni": 22 nxënës ose 4.23 % janë përgjigjur bërtitja, 31 nxënës ose 5.96 % janë përgjigjur sharja, 18 nxënës ose 3.46 % janë përgjigjur ironizimi, 33 nxënës ose 6.35 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të prindit, 20 nxënës ose 3.85 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të drejtorit, 8 nxënës ose 1.54 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të provimit, 26 nxënës ose 5 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të notës dhe 12 nxënës ose 2.31 % janë përgjigjur nënvlerësim i përgjigjes. Kërcënimi me anë të prindit mbisundon, por që vazhdon me sharjen dhe kërcënimin me anë të notës. Nota shihet një armë e fortë në duart e mësuesit.

Në Shkollën Profesionale "Nazmi Rushiti" pyetjes mbi formën e dhunës: 28 nxënës ose 5.38 % janë përgjigjur bërtitja, 16 nxënës ose 3.08 % janë përgjigjur sharja, 4 nxënës ose 0.77 % janë përgjigjur ironizimi, 2 nxënës ose 0.38 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të prindit, 7 nxënës ose 1.56 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të drejtorit, 3 nxënës ose 0.58 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të provimit, 4 nxënës ose 0.77 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të notës dhe 6 nxënës ose % janë përgjigjur nënvlerësim i përgjigjes. Bërtitja mbisundon, por që vazhdon me sharjen dhe kërcënimin me anë të drejtorit. Meqë drejtore e shkollës është një nga ish-nxënëset dhe mësueset e shkollës shihet si një armë e fortë në menaxhimin e situatave problemore.

Në Gjimnazi Maqellarë pyetjes mbi formën e dhunës: 14 nxënës ose 2.69 % janë përgjigjur bërtitja, 12 nxënës ose 2.31 % janë përgjigjur sharja, 6 nxënës ose 1.15 % janë përgjigjur ironizimi, 14 nxënës ose 2.69 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të prindit, 6 nxënës ose 1.15 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të drejtorit, 4 nxënës ose 0.77 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të provimit, 8 nxënës ose 1.54 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të notës dhe 6 nxënës ose 1.15% janë përgjigjur nënvlerësim i përgjigjes. Kërcënimi me anë të prindit dhe bërtitja mbisundojnë, por që

vazhdon me sharjen dhe kërcënimin me anë të notës. Nota shihet një armë e fortë në duart e mësuesit.

Në Gjimnazin "Remzi Ademaj" pyetjes mbi formën e dhunës: 30 nxënës ose 5.77 % janë përgjigjur bërtitja, 21 nxënës ose 4.04 % janë përgjigjur sharja, 42 nxënës ose 8.08 % janë përgjigjur ironizimi, 14 nxënës ose 2.69 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të prindit, 6 nxënës ose 1.15 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të drejtorit, 7 nxënës ose 1.35 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të provimit, 12 nxënës ose 2.31 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të notës dhe 8 nxënës ose 1.54 % janë përgjigjur nënvlerësim i përgjigjes. Mbizotëron ironizimi që pasohet me bërtitje, sharje, etj. Nota mbetet një armë e fortë në duart e mësuesit.

Në Gjimnazin " 28 Nëntori " pyetjes mbi formën e dhunës: 28 nxënës ose 5.38 % janë përgjigjur bërtitja, 6 nxënës ose 1.15 % janë përgjigjur sharja, 8 nxënës ose 1.54 % janë përgjigjur ironizimi, 13 nxënës ose 2.5 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të prindit, 2 nxënës ose 0.38 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të drejtorit, 3 nxënës ose 0.58 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të provimit, 6 nxënës ose 1.15 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të notës dhe 4 nxënës ose 0.77% janë përgjigjur nënvlerësim i përgjigjes. Kërcënimi me anë të prindit mbizotëron, por që vazhdon me kërcënimin me anë të notës. Nota shihet një armë e fortë në duart e mësuesit.

Tabela 3.8.7 : Format e dhunës verbale


VAR00007					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1.00	122	23.5	23.5	23.5
	2.00	86	16.5	16.5	40.0
	3.00	78	15.0	15.0	55.0
	4.00	76	14.6	14.6	69.6

5.00	41	7.9	7.9	77.5
6.00	25	4.8	4.8	82.3
7.00	56	10.8	10.8	93.1
8.00	36	6.9	6.9	100.0
Total	520	100.0	100.0	

Bazuar në vlerat e variablilit: Forma e dhunës se 23.5 % janë përgjigjur bërtitja, 16.5 % janë përgjigjur sharja, 15 % janë përgjigjur ironizimi, 14.6 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të prindit, 7.9 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të drejtorit, 4.8 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të provimit, 10.8 % janë përgjigjur kërcënimi me anë të notës dhe 6.9 % janë përgjigjur nënvlerësim i përgjigjes. Bërtitja mbisundon, por që vazhdon me sharjen dhe kërcënimin me anë prindit dhe të notës. Nota shihet një armë e fortë në duart e mësuesit. (M= 3.5904; DS= 2.26124).

Pra, sipas pohimeve të shumicës së subjekteve nxënës dhuna po bëhet zëri i klasës.

Format e dhunës joverbale



Grafiku 3.8.8 : Format e dhunës joverbale

Në Gjimnazin "Said Najdeni" pyetjes mbi format e dhunës joverbale janë përgjigjur: 46 nxënës ose 8.85 % mosaktivizim, 92 nxënës ose 17.69 % shikim me inat dhe 32 nxënës ose 6.15 % shikim me fytyrë të ngrysur. Pra mbisundon kundërshtimi me anë të mimikës.

Në Shkollën Profesionale "Nazmi Rushiti" pyetjes mbi format e dhunës joverbale janë përgjigjur: 41 nxënës ose 7.88 % mosaktivizim, 13 nxënës ose 2.5 % shikim me inat dhe 16 nxënës ose 3.08 % shikim me fytyrë të ngrysur. Pra mbisundon mosaktivizim, ku mësuesi shpesh bie pre e mentalitetit dhe e rrezes së botës së tij të vogël.

Në Gjimnazi Maqellarë pyetjes mbi format e dhunës joverbale janë përgjigjur: 13 nxënës ose 2.5 % mosaktivizim, 26 nxënës ose 5 % shikim me inat dhe 31 nxënës ose 5.9 % shikim me fytyrë të ngrysur. Pra mbisundon kundërshtimi me anë të mimikës.


Në Gjimnazin "Remzi Ademaj" pyetjes mbi format e dhunës joverbale janë përgjigjur: 46 nxënës ose 8.85 % mosaktivizim, 71 nxënës ose 13.65 % shikim me inat dhe 23 nxënës ose 4.4 % shikim me fytyrë të ngrysur. Pra mbizotëron kundërshtimi me anë të mimikës.

Në Gjimnazin "28 Nëntori" pyetjes mbi format e dhunës joverbale janë përgjigjur: 11 nxënës ose 2.12 % mosaktivizim, 50 nxënës ose 9.62 % shikim me inat dhe 9 nxënës ose 1.73 % shikim me fytyrë të ngrysur. Pra mbisundon kundërshtimi me anë të mimikës.

Tabela 3.8.8 : Format e dhunës joverbale

VAR00008					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1.00	156	30.0	30.0	30.0
	2.00	252	48.5	48.5	78.5
	3.00	112	21.5	21.5	100.0
	Total	520	100.0	100.0	

Bazuar në vlerat e variablit: Forma e dhunës joverbale janë përgjigjur: 30 % mosaktivizim, 48.5 % shikim me inat dhe 21.5 % shikim me fytyrë të ngrysur. Pra mbisundon kundërshtimi me anë të mimikës. (M= 2.00; DS= 0.71359).



Grafiku 3.8.9 : Format e dhunës fizike

Në Gjimnazin "Said Najdeni" pyetjes mbi format e dhunës fizike nxënësit janë përgjigjur: 66 nxënës ose 12.69% janë gjuajtur me shkumës, 24 nxënës ose 4.62 % shkulje veshi, flokëve, 49 nxënës ose 9.42 % janë goditur me shuplakë e mjete të tjera

dhe 31 nxënës ose 5.96 % janë dhunuar me armë të ftohta. Përdorimi i armëve të ftohta shpjegohet nga fakti se shumë prej nxënësve janë nga zona rurale ku ekziston mentaliteti si zonë e zgjidhjes së problemit me anë të forcës fizike dhe janë të prekur nga dukuria e gjakmarrjes, që është një plagë e hapur gjatë viteve të tranzicionit.

Në Shkollën Profesionale “Nazmi Rushiti” pyetjes mbi format e dhunës fizike nxënësit janë përgjigjur: 21 nxënës ose 4.04% janë gjuajtur me shkumës, 14 nxënës ose 2.69 % shkulje veshi, flokëve, 23 nxënës ose 4.42 % janë goditur me shuplakë e mjete të tjera dhe 12 nxënës ose 2.31 % janë dhunuar me armë të ftohta. Përdorimi i mjeteve dhe armëve të ftohta shpjegohet dhe me faktin që konvikti dhe shkolla janë shumë afër dhe nuk mund të bëhet kontroll i përditshëm i nxënësve. Tragjedia Krenar.B ka prekur jo vetëm personelin e shkollës, por mbarë komunitetin dibran. Nuk janë të pakta rastet kur drejtuesit apo personeli i sigurisë kërkojnë mbështetje nga punonjësit e rendit për shqetësimin më të vogël. Kjo ka bërë që shkolla mos shkretohet, por politikat arsimore të drejtuesve të shkollës ta gjallërojnë jetën e saj me projektet, degët më afër tregut të punës apo aktivitete të ndryshme me trupën teatrore që mbushin jetën kulturore, sportive të qytetit të Peshkopisë, Dibrës së Madhe, Strugës,...

Në Gjimnazi Maqellarë pyetjes mbi format e dhunës fizike nxënësit janë përgjigjur: 18 nxënës ose 3.49% janë gjuajtur me shkumës, 10 nxënës ose 1.92 % shkulje veshi, flokëve, 34 nxënës ose 6.54 % janë goditur me shuplakë e mjete të tjera dhe 8 nxënës ose 1.57 % janë dhunuar me armë të ftohta. Përdorimi i armëve të ftohta shpjegohet nga fakti se nxënësit që japin provimet e vjeshtës në klasë të 9^{-të} janë të parët që regjistrohen në gjimnaz. Ata janë përsëritës dhe mbartin në gjimnaz kulturën e rrugës.

Në Gjinnnazin "Remzi Ademaj" pyetjes mbi format e dhunës fizike nxënësit: 74 nxënës ose 14.23% janë gjuajtur me shkumës, 56 nxënës ose 10.77 % shkulle veshi, flokëve, 8 nxënës ose 1.54 % janë goditur me shuplakë e mjete të tjera dhe 2 nxënës ose 0.38 % janë dhunuar me armë të ftohta. Pavarësisht se mbizotëron gjuajtja me copa shkumësi, përdorimi i armëve të ftohta duhet të jetë shenjë alarmi për drejtuesit dhe punonjësit e sigurisë.


Në Gjinnnazin " 28 Nëntori " pyetjes pyetjes mbi format e dhunës fizike nxënësit: 25 nxënës ose 4.81 % janë gjuajtur me shkumës, 19 nxënës ose 3.65 % shkulle veshi, flokëve, 17 nxënës ose 3.27 % janë goditur me shuplakë e mjete të tjera dhe 9 nxënës ose 1.73 % janë dhunuar me armë të ftohta. Nuk duhet të harrojmë se mësimi bëhet me turne dhe pasdite janë nxënës maqedonas.

Grafiku 3.8.9 : Format e dhunës fizike

VAR00009					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1.00	204	39.2	39.2	39.2
	2.00	123	23.7	23.7	62.9
	3.00	131	25.2	25.2	88.1
	4.00	62	11.9	11.9	100.0
	Total	520	100.0	100.0	

Bazuar në vlerat e variablit: Format e dhunës fizike nxënësit janë përgjigjur: 39.2 % janë gjuajtur me shkumës, 23.7 % shkulle veshi, flokëve, 25.2 % janë goditur me shuplakë e mjete të tjera dhe 11.9 % janë dhunuar me armë të ftohta. Përdorimi i armëve të ftohta ka tendencë rritjeje (M= 2.0981; DS= 1.05531). Një fjalë e urtë thotë: Personit që i mbarojnë idetë, godet tjetrin.

Dhunë më shumë ushtrohet mbi



Grafiku 3.8.10 : Dhunë më shumë ushtrohet mbi

Në Gjimnazin "Said Najdeni" dhunë më shumë ushtrohet: 65 nxënës ose 12.5 % përgjigjen mbi nxënësit, 71 nxënës ose 13.65 % mbi nxënëset, 15 nxënës ose 2.88 % mbi mësuesit dhe 19 nxënës ose 3.65 % mbi mësueset. Fakti që mbisundon dhuna mbi nxënëset apo mbi mësueset shpreh diskriminimin gjinor, ku nxënëset dhe mësueset shihen si forcë e dobët dhe e brishtë.

Në Shkollën Profesionale "Nazmi Rushiti" pyetjes dhunë më shumë ushtrohet: 27 nxënës ose 5.19 % përgjigjen mbi nxënësit, 21 nxënës ose 4.04 % mbi nxënëset, 9 nxënës ose 1.73 % mbi mësuesit dhe 13 nxënës ose 2.5 % mbi mësueset. Fakti që mbisundon dhuna mbi nxënëset apo mbi mësueset shpreh diskriminimin gjinor, ku nxënëset dhe mësueset shihen si forcë e dobët dhe e brishtë. Fakti që vajzat vijnë nga zona rurale të thella janë shpesh objekt dhune.

Në Gjinnazi Maqellarë pyetjes dhunë më shumë ushtrohet: 18 nxënës ose 3.46 % përgjigjen mbi nxënësit, 16 nxënës ose 3.08 % mbi nxënëset, 12 nxënës ose 2.31 % mbi mësuesit dhe 24 nxënës ose 4.62 % mbi mësueset. Fakti që mbisundon dhuna mbi nxënësit është se po formohen liderit e dhunës apo mbi mësueset shpreh diskriminimin gjinor, ku mësueset shihen si forcë e dobët, e brishtë dhe nxënësit po keqpërdorin marrëdhëniet me ta, pasi ata nuk e kanë të theksuar kontradiktën e brezave.

Në Gjinnazin "Remzi Ademaj" pyetjes dhunë më shumë ushtrohet: 80 nxënës ose 15.38 % përgjigjen mbi nxënësit, 36 nxënës ose 6.92 % mbi nxënëset, 4 nxënës ose 0.77 % mbi mësuesit dhe 20 nxënës ose 3.85 % mbi mësueset. Pavarësisht faktit se gjinnazi është i drejtimit gjuhësor djemtë janë objekt dhe shkak i dhunës.


Në Gjinnazin " 28 Nëntori " pyetjes dhunë më shumë ushtrohet: 36 nxënës ose 6.92 % përgjigjen mbi nxënësit, 16 nxënës ose 3.08 % mbi nxënëset, 8 nxënës ose 1.54 % mbi mësuesit dhe 10 nxënës ose 1.92 % mbi mësueset. Mbizotëron dhuna mbi nxënësit si zhurmuesit e klasës, mbi mësueset si krijesë delikate dhe e brishtë.

Tabela 3.8.10 : Dhunë më shumë ushtrohet mbi

VAR00010					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1.00	225	43.3	43.3	43.3
	2.00	160	30.8	30.8	74.0
	3.00	49	9.4	9.4	83.5
	4.00	86	16.5	16.5	100.0
	Total	520	100.0	100.0	

Bazuar në vlerat e variablit: Dhunë më shumë ushtrohet mbi 43.3% përgjigjen mbi nxënësit, 30.8 % mbi nxënëset, 9.4 % mbi mësuesit dhe 16.5 % mbi mësueset. Fakti

që mbisundon dhuna mbi nxënëset apo mbi mësueset shpreh diskriminimin gjinor, ku nxënëset dhe mësueset shihen si forcë e dobët dhe e brishtë ($M=1.9923$; $DS= 1.09119$).



Grafiku 3.8.11 : Dhunë më shumë ushtrohet në

Në Gjimnazin "Said Najdeni" dhunë më shumë ushtrohet: 78 nxënës ose 15 % në klasën e 10-të, 47 nxënës ose 9.04 % në klasën e 11-të dhe 45 nxënës ose 8.65 % në klasën e 12-të. Fakti se dhunë më shumë ushtrohet në klasë të 10-të shpjegohet me faktin se nxënësit vijnë nga sistemi 9-vjeçar, ku në Dispozitat Normative është e ndaluar përjashtimi i nxënësit nga shkolla ose nga ora e mësimit kur ai bëhet problem në klasë dhe në gjimnaz vazhdojnë të njëjtën sjellje për inerci, gjithashtu shkëmbejnë kulturat e shkollave nga vijnë, ku dhuna në shkollë nga antivlerë po kthehet në vlerë. Rregullimi i tyre nëpër klasa dhe mungesa e regjistrimit zgjasin deri në dy muaj.

Në Shkollën Profesionale “Nazmi Rushiti” pyetjes dhunë më shumë ushtrohet: 31 nxënës ose 5.96 % në klasën e 10-të, 11 nxënës ose 2.12 % në klasën e 11-të, 21 nxënës ose 4.04 % në klasën e 12-të dhe 7 nxënës ose 1.35% në klasën e 13. Dhuna më shumë ushtrohet në klasë të 10-të shpjegohet me faktin se nxënësit vijnë nga sistemi 9-vjeçar, ku në Dispozitat Normative është e ndaluar përjashtimi i nxënësit nga shkolla ose nga ora e mësimi kur ai bëhet problem në klasë dhe vazhdojnë të njëjtën sjellje për inerci, gjithashtu shkëmbejnë kulturat e shkollave nga vijnë, ku dhuna në shkollë nga antivlerë po kthehet në vlerë si dhe rregullimi i tyre nëpër klasa dhe mungesa e regjistrimit zgjasin deri në dy muaj. Shumica e djemve janë me mesatare poshtë 7 nga shkolla 9-vjeçare si dhe larg familjes. Drejtoria e shkollës dhe e konviktit përpiqen të menaxhojnë situatat. Shumica e prindërve janë larg ose në emigracion dhe krijon vështirësi në bashkëpunim.

Në Gjimnazi Maqellarë pyetjes dhunë më shumë ushtrohet: 32 nxënës ose 6.15 % në klasën e 10-të, 17 nxënës ose 3.27 % në klasën e 11-të dhe 21 nxënës ose 4.04 % në klasën e 12-të. Dhunë më shumë ushtrohet në klasë të 10-të shpjegohet me faktin se nxënësit vijnë nga sistemi 9-vjeçar, ku në Dispozitat Normative është e ndaluar përjashtimi i nxënësit nga shkolla ose nga ora e mësimi, kur ai bëhet problem në klasë dhe në gjimnaz vazhdojnë të njëjtën sjellje për inerci, gjithashtu shkëmbejnë kulturat e shkollave nga vijnë, ku dhuna në shkollë nga antivlerë po kthehet në vlerë si dhe rregullimi i tyre nëpër klasa dhe mungesa e regjistrimit zgjasin deri në dy muaj. Gjithashtu shumë klasa janë në prag të shkrirjes dhe nxënësit e dhunshëm e shohin si anë e dobët të drejtuesit dhe mësuesit kujdestar.

Në Gjimnazin “Remzi Ademaj” pyetjes dhunë më shumë ushtrohet: 76 nxënës ose 14.62 % në klasën e 10-të, 36 nxënës ose 6.92 % në klasën e 11-të dhe 28 nxënës ose 5.85 % në klasën e 12-të. Shkëmbimi i kulturave nga nxënësit e klasës së 10-të shoqërohet me jehonën e ulërimeve nga klasa përgjatë korridorit.


Në Gjimnazin “28 Nëntori” pyetjes dhunë më shumë ushtrohet: 26 nxënës ose 5 % në klasën e 9-të, 18 nxënës ose 3.46 % në klasën e 10-të, 16 nxënës ose 3.08 % në klasën

11^{-të} dhe 10 nxënës ose 1.92 % në klasën e 12^{-të}. Dhunë më shumë ushtrohet në klasë të 9-të, pasi është ndryshimi i statusit social dhe euforia e moshës. Të debatosh nuk do të thotë të ulërasësh.

Tabela 3.8.11 : Dhunë më shumë ushtrohet në

VAR00011					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1.00	243	46.7	46.7	46.7
	2.00	129	24.8	24.8	71.5
	3.00	131	25.2	25.2	96.7
	4.00	17	3.3	3.3	100.0
	Total	520	100.0	100.0	

Bazuar në vlerat e variablit: Dhunë më shumë ushtrohet në 46.7 % në klasën e 9-10-të, 24.8 % në klasën e 11-të, 25.2 % në klasën e 12-të dhe 3.3 në klasën e 13-të. Fakti se dhunë më shumë ushtrohet në klasë të 9- 10^{-të} shpjegohet me faktin se nxënësit vijnë nga sistemi 8- 9-vjeçar. (M=1.8500; DS= .91055).



Grafiku 3.8.12 : Dhunë më shumë ushtrohet nga

Në Gjimnazin "Said Najdeni" dhunë më shumë ushtrohet: 67 nxënës ose 12.88 % përgjigjen nga mësuesit, 31 nxënës ose 5.96 % janë përgjigjur nga mësueset, 43 nxënës ose 8.27 % përgjigjen nga nxënësit dhe 29 nxënës ose 5.58 % nga nxënëset. Mbisundon dhuna nga mësuesit dhe nxënësit si të "fortët natyrorë", por nuk përjashtohet fakti se vajzat të paafta për të kundërshtuar jo në pak raste përdorin dhunën psikologjike, ku mallkimet dhe përgojimet janë në një shkallë për të dëshiruar.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	a	10	20	20	20
	b	4	8	8	28
	c	8	16	16	44
	d	11	22	22	66
	e	16	32	32	98
	f	1	2	2	100
	Total	50	100	100	
	Mendimi juaj për projektet që zbatohen në shkolla				

Bazuar në variablin : Mendimi për projektet në shkolla 20 % përgjigjen se projektet janë betejë e shkollës, 8 % përgjigjet dështim, 16 % përgjigjet sondazh, 22% përgjigjen ndryshim i jetës së shkollës dhe 32 % përgjigjen se projektet rritin efektivitetin e procesit mësimor-edukativ duke i ndërgjegjësuar nxënësit si qytetarë global dhe 2 % tjetër. Projektet mund të jenë një mënyrë e mirë për të rritur buxhetin e shkollës dhe zgjidhjen e problemeve.

Analizë e pyetjeve cilësore të pyetësorit të mësuesve.

Një pjesë e mësuesve të rinj janë në hap me kohën duke zbatuar metodat ndërvepruese nëpërmjet TIK, duke u bërë pjesë e projekteve dhe nismave globale si "Earth Hour", "Java e të Drejtave të Fëmijës", "15 ditë pa dhunë në shkollë", "Java Globale e Parasë"apo "SABBAT"...

Ata kanë një sens të lartë krenarie dhe pronësie, që vjen nga roli që ndërmerr individi për ta bërë shkollën një vend më të mirë. Ndërsa për një pjesë tjetër mosha e re shihet si dobësi nga ana e nxënësve duke abuzuar me marrëdhëniet e krijuara.

Një pjesë jo e vogël shprehet për dhunën institucionale të drejtuesve të shkollave ndaj mësuesve.

Garat elektorale çdo dy vjet e kanë hipnotizuar edhe mësuesin duke u bërë një vegël e bindur e shtetit. Nuk duhet harruar se shkolla nuk është hija e zgjatur e drejtuesit për 4 vjet dhe 36 vite të tjerë do të jetë i poshtëruar.

Projektet në shkolla dizajnojnë jetën e shkollës dhe i ndërgjegjëgjeson nxënësit se ka dhe mënyra të tjera për tu bërë i famshëm në shkollë apo për të fituar universitetin pa mbaruar Maturën Shtetërore si projekti SABBAT, një orë mësimi me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë edhe pse je i fshatit, bashkëpunimi me IKT në Australi si lider global apo Java e Globale e Arsimit si ambasador i gjimnazit "Said Najdeni" në shkollat e mesme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjithsesi këto janë raste sporadike për nxënësit dhe mësuesit e Gjimnazit Maqellarë, " Said Najdeni" dhe shkollës " Nazmi Rushiti".

Mbetemi ende shoqëri tradicionale, e cila bazohet në zgjidhjen e problemeve përmes forcës. Ky fenomen nuk manifestohet vetëm në shkolla, por dhe në familje dhe në rrethe të tjera shoqërore, ku zgjidhjet kërkohen duke u bazuar në forcën, pra ka prejardhje kulturore.

Për shkak të dhunës shumica e nxënësve nuk duan as të shkojnë në shkollë. Me fjalë të tjera, frika e dhunës në shkollë i ka kapluar ata aq sa ata të humbasin interesin e tyre në studime. Dhuna në shkollë jo vetëm ndikon te nxënësit, por edhe te mësuesit. Ajo po krijon shumë probleme për mësuesit dhe prindërit. Për parandalimin e dhunës në

shkollë është e nevojshme që mësuesit duhet të jenë të trajnuar për të ndihmuar në zgjidhjen e këtij problemi.


Shkolla e Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti": Një krim i rëndë është diçka shumë shqetësuese dhe të gjithë ende besojmë se shkolla është një vend tjetër në qiell

Pas dhunës në shkollë ka shumë lloje të kaosit. Gjithkush merr zhgënjimin nga akti i vrasjes. Njerëzit refuzojnë të dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë. Imazhi dhe respekti i shkollës dhe mësuesve të shkollë merr të tatëpjetën nga dhuna në shkollë. Ka shumë raste të dhunës në shkollë dhe një numër i madh njerëzish janë të prekur negativisht.

3.10 Analizë e pyetësorit të prindërve

Mendimi i prindërve është shumë i rëndësishëm, sepse ata janë partnerë për zgjidhjen e dhunës në shkollë. Në kampion m arrin pjesë dhe 100 prindër. Po japim dhe paraqitjen e tyre grafike.


a. dobët b. mjaftueshëm c. mirë d. sh.mirë



Grafiku 3.10.1: Vlerësimi për dhunën në shkollë


Përsa i përket dukurisë së dhunës në shkollë: 54 prindër ose 54 % përgjigjen se ndërhyrja për dukurinë e dhunës ka qenë e dobët, 27 prindër ose 27% është ndërhyrë mjaftueshëm, 11 prindër ose 11 % ndërhyrja vlerësohet mirë dhe 8 prindër ose 8 % është ndërhyrë shumë mirë.

Dhuna në shkollë mund të zgjidhet nga prindët



Grafiku 3.10.2: Dhuna në shkollë mund të zgjidhet nga prindët


64 prindër ose 64% përgjigjen se zgjidhja vetëm nga prindërit është e dobët, 20 prindër ose 20 % përgjigjen mjaftueshëm, 14 prindër ose 14 % përgjigjen mirë dhe 2 prindër ose 2 % përgjigjen se zgjidhja vetëm nga prindërit do të jetë shumë mirë. Pra prindërit janë ndërgjegjësuar që dhuna në shkollë nuk mund të zgjidhet vetëm nga prindërit.



Grafiku 3.10.3: Dhuna në shkollë zgjidhet nga profesionistë


41 prindër ose 41% përgjigjen se zgjidhja vetëm nga profesionistë është e dobët, 31 prindër ose 31% përgjigjen mjaftueshëm, 24 prindër ose 24 % përgjigjen mirë dhe 4 prindër ose 4 % përgjigjen se zgjidhja do të jetë shumë mirë. Pra prindërit janë ndërgjegjësuar që dhuna në shkollë nuk mund të zgjidhet vetëm nga profesionistët edhe pse ka një ulje të % së zgjidhjes së dhunës në krahasim nga zgjidhja vetëm nga prindërit.

Përfshirja e prindërve në veprimtaritë e shkollës



Grafiku 3.10.4: Përfshirja e prindërve në veprimtaritë e shkollës


31 prindër ose 31% përgjigjen se përfshirja e prindërve në mënyrë aktive në veprimtaritë e shkollës është e dobët, 40 prindër ose 40% përgjigjen mjaftueshëm, 20 prindër ose 20 % përgjigjen mirë dhe 9 prindër ose 9 % përgjigjen shumë mirë. Prindërit janë ndërgjegjësuar që përfshirja e tyre në veprimtaritë e shkollës është nën kufijtë normalë.



Grafiku 3.10.5: Mendimi i prindërve për problemet e shkollës

43 prindër ose 43% përgjigjen marrja e mendimit të prindërve për problemet e shkollës është e dobët, 38 prindër ose 38% përgjigjen mjaftueshëm, 12 prindër ose 12 % përgjigjen mirë dhe 7 prindër ose 7 % përgjigjen shumë mirë. Prindërit janë ndërgjegjësuar që jo vetëm përfshirja e tyre në veprimtaritë e shkollës, por edhe marrja e mendimit të tyre për problemet e shkollës është nën kufijtë normalë, pra Bordi i shkollës nuk është funksional.


Zgjidhja e problemeve të shkollës nga prindërit



Grafiku 3.10.6: Zgjidhja e problemeve të shkollës nga prindërit


57 prindër ose 57% përgjigjen se ndihma e prindërve për problemet e shkollës është e dobët, 29 prindër ose 29% përgjigjen mjaftueshëm, 13 prindër ose 13 % përgjigjen mirë dhe 1 prindër ose 10 % përgjigjen shumë mirë. Pra prindërit janë ndërgjegjësuar që ndihma e tyre për problemet e shkollës është nën kufijtë normalë.

Njoftimi i prindërve nga drejtori




Grafiku 3.10.7: Njoftimi i prindërve nga drejtori

84 prindër ose 84% përgjigjen se njoftimi i prindërve për problemet e fëmijës së tyre është i dobët, 12 prindër ose 12 % përgjigjen mjaftueshëm, 3 prindër ose 3 % përgjigjen mirë dhe 1 prindër ose 1 % përgjigjen shumë mirë. Shteti apo shkolla është përgjegjëse për gjithçka. Takimet me prindër janë dy herë në vit të planifikuara, por edhe në këto mbledhjet dështojnë.



Grafiku 3.10.8: Prindërit pjesë e ekipit për vlerësimin e shkollës

76 prindër ose 76% se prindërit janë pjesë e ekipit për vlerësimin e shkollës përgjigjen dobët, 20 prindër ose 20 % përgjigjen mjaftueshëm, 2 prindër ose 2 % përgjigjen mirë dhe 2 prindër ose 20 % përgjigjen shumë mirë. Prindërit jo vetëm nuk kanë informacion për gjimnazin, por është dera e vetme ku trokasin për arsimimin e fëmijës së tyre. Asnjë nga prindërit nuk ka vizituar ndonjë shkollë tjetër të mesme, gjithsesi në shumicën e rasteve kanë mbaruar të njëjtin gjimnaz. Le ta shohim si kulturë e shkollës, që të shërbejë në vetëvlerësimin e shkollës.




Grafiku 3.10.9: Bashkëpunimi - çelësi i formimit të qytetarit global

45 prindër ose 45 % se bashkëpunimi DAR- shkollë – Komunë – prind si çelës i formimit të qytetarit global përgjigjen dobët, 24 prindër ose 24 % përgjigjen mjaftueshëm, 23 prindër ose 23 % përgjigjen mirë dhe 1 prindër ose 10 % përgjigjet shumë mirë.


3.11 Analizë e pyetësorit të mjekëve të urgjencës

Kontakte me pacientë të dhunuar ?




Grafiku 3.11.1: Kontakte me pacientë të dhunuar

Përsa i përket kontakteve me pacientë, që kanë qenë viktima të dhunës në shkollë 5 mjekë ose 100 % përgjigjen po. Dhuna në shkollë edhe nga mjekët shihet si dukuri normale. Nuk përjashtohet mundësia se nxënës të gjimnazit mbushin korridoret e spitalit nga pasojat e pijeve alkoolike dhe narkotike.




Grafiku 3.11.2: Format e dhunës

2 mjekë ose 40 % përgjigjen se kanë patur të bëjnë me dhunë fizike dhe 3 mjekë ose 60 % me dhunë psikologjike.



Grafiku 3.11.3: Viktima të dhunës


3 mjekë ose 60 % përgjigjen se disa pacientë janë viktima të dhunës në shkollë, ndërsa 2 mjekë ose 40 % përgjigjen se shumica e pacientëve të tyre janë viktima të dhunës në shkollë.



Grafiku 3.11.4: Identifikimi i personave të dhunuar

3 mjekë ose 60 % përgjigjen se gjithmonë identifikojnë pacientët e dhunuar në shkollë dhe 2 mjekë ose 40 % përgjigjen shpesh identifikojnë personat e dhunuar në shkollë.


Trajtim viktimave të dhunës



Grafiku 3.11.5: Trajtim viktimave të dhunës

2 mjekë ose 40 % përgjigjen se ofrojnë gjithmonë ndihmë për personat e dhunuar në shkollë dhe 3 mjekë ose 60 % përgjigjen se ofrojnë shpesh ndihmë.


Ndërgjegjësimi mbi dhunën



Grafiku 3.11.6: Ndërgjegjësimi mbi dhunën

3 mjekë ose 60 % përgjigjen se shpesh i pyesin pacientët nëse janë viktima të dhunës në shkollë dhe 2 mjekë ose 40 % përgjigjen herë pas here. Ata thonë që është pjesë e punës së tyre që të dinë shkakun e gjendjes së pacientit.

Mendimi mbi dhunën në shkollë



Grafiku 3.11.7: Mendimi mbi dhunën në shkollë

5 mjekë ose 100 % përgjigjen se dhuna në shkollë është dukuri e zakonshme në jetën e sistemit arsimor shqiptar. Pra e shohin dhunën si dukuri normale.

3.12 Analiza statistikore

Hipoteza 1: Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është në rritje.

Ndërmjet dhunës fizike dhe psikologjike në shkollë dhe nivelit të rëndësisë së saj nëpërmjet nxënësve ekzistojnë marrëdhënie statistikisht domethënëse.

Rezultatet e kërimit përmes analizës statistikore

Intervali i besueshmerise 50%

Testi i besueshmërisë lejon fillimin e analizës së përgjigjeve

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	N of Items
.787	23

Tabela 3.12.1: Testi i besueshmërisë për nxënësit

Meqë vlera e Alpha është më e madhe se 70% ($\alpha > 70\%$), testi dhe instrumenti i përdorur për vlerësim është i besueshëm. Për realizimin e testit u përdorën të gjitha pyetjet e pyetësorit.

Testi i vlefshmërisë

KMO and Bartlett's Test

Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.		.797
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square	10938.791
	Df	253
	Sig.	.000

Tabela 3.12.2 : Testi i vlefshmërisë për nxënësit

VAR00001 * VAR00002 Crosstabulation

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal	by Phi	.829	.000
Nominal	Cramer's V	.829	.000
	Contingency Coefficient	.638	.000
N of Valid Cases		520	

Bootstrap for Symmetric Measures

		Value	Bootstrap ^a			
			Bias	Std. Error	95% Confidence Interval	
					Lower	Upper
Nominal	by Phi	.829	.000	.000	.829	.829
Nominal	Cramer's V	.829	.000	.000	.829	.829
	Contingency Coefficient	.638	.000	.000	.638	.638
N of Valid Cases		520	0	0	520	520

Tabela 3.12.3 : Vlerat e korrelacionit linear bivariat ndërmjet variablave dhunë dhe shpeshtësisë së saj

Bazuar në korrelacionin linear bivariat ndërmjet variablit të pavarur - dhunës në shkollë dhe variablit të varur-shpeshtësia e dhunës për nxënësin rezulton se:

Koeficienti i phi-së përdoret për të kërkuar lidhjen ndërmjet dy ndryshoreve e cila rezulton me përgjigjen po ose jo. Koeficienti Phi, vlera r është 0.829 e përfituar në fund të analizës, paraqet korrelacionin ndërmjet ndryshoreve, lidhja e tyre është pozitive

Vlera Cramer's V është llogaritur për 0.829. Me fjalë të tjera, një analizë e këtillë, nuk tregon marrëdhënien shkak-pasojë, mirëpo jep idenë se në çfarë niveli dhe në çfarë drejtimi do të ndryshojnë ndryshoret.

Niveli i rëndësisë Contingency Coefficient - koeficientit të korrelacionit (rho) është 0.638 dhe është pozitive. Kjo na tregon se dhuna jo vetëm është e pranishme, por me kalimin e viteve është rritur. Meqë koeficienti i korrelacionit është ndërmjet 0,50 – 1,00 konsiderohet të jetë një lidhje e lartë, prandaj kjo na tregon se ekziston një lidhje e fuqishme ndërmjet këtyre dy variablave.

.

One-Sample Test

	Test Value = 0					
	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
					Lo2er	Upper
Sa shpesh përdoret dhuna	69.675	519	.000	2.362	2.29	2.43

Tabela 3.12.4 : Niveli i rëndësisë së dhunës në shkollë

Vlera e testit që krahasojmë popullatën është Sig. (2-tailed) = 0. Niveli i rëndësisë që dhuna e ushtruar të jetë në vlerën 0 është 0, pra dhuna ekziston. Thënë ndryshe, ne jemi rreth 52% të sigurt për këtë rezultat (df = 0.519)

Ekuacioni bazë i një modeli regresioni linear është:

$$Y = \beta_0 + \beta_1 X_i + \varepsilon_i$$

Koeficienti i besueshmërisë = 95%

Variables Entered/Removed^a

Model Summary				
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.793 ^a	.629	.628	.30320

a. Predictors: (Constant), VAR00002

Tabela 3.12.5. Modeli i shumës së regresit linear

Në tabelë është dhënë vlera R^2 . Vlera e gjetur këtu është 0.629. Sipas këtij rezultati, 62.9 % e ndryshimit në ndryshoren e varur shpjegohet nga ndryshorja e pavarur e përfshirë në model. Me fjalë të tjera, pjesa e ndryshimit prej 62.9% në rritjen e dhunës me kalimin e kohës.

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	80.648	1	80.648	877.259	.000 ^b
	Residual	47.621	518	.092		
	Total	128.269	519			

a. Dependent Variable: VAR00001

b. Predictors: (Constant), VAR00002

Tabela 3.12.6 : Analiza Anova

Vlerë me rëndësi e cila duhet të interpretohet në tabelë është vlera F e cila tregon rëndësinë e modelit dhe vlera Sig. e cila tregon nivelin e rëndësisë. Në qoftë se vlera F është 877.259 e rëndësishme çon në përfundim se modeli statistikisht është plotësisht i rëndësishëm. Modeli jonë i cili shpjegon ndikimin e dhunës me kalimin e kohës është një model i rëndësishëm.

Coefficients ^a					
Model	Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
	B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	.667	.033	20.292	.000
	VAR00002	.431	.015	.793	.000

a. Dependent Variable: VAR00001

Tabela 3.12.7 : Tabela e koficientëve të standartizimit

Dhe në fund, marrin pjesë vlerat e parashikimit të koeficientëve të modelit dhe vlerat t në lidhje me këto. Sipas tabelës ndikimi është me 0,431 njësi. Vlerat t në lidhje me këtë koeficient janë të rëndësishme në çdo nivel (Sig. = 0,000) dhe prandaj koeficienti i ndryshores së dhunës është i rëndësishëm statistikisht.

Për ta përmbledhur, rezultati i parashikimit të modelit është si më poshtë:

$$\hat{y} = 0,667 + 0,431x$$

Këtu y paraqet dhunën dhe x nivelin e rëndësisë së dhunës.

Përfundim verifikohet:

Hipoteza 1: Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është në rritje

Vërtetimi i hipotezës nga pyetësi i mësuesve

Hipoteza 1: Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është në rritje.

Ndërmjet dhunës fizike dhe psikologjike në shkollë dhe nivelit të rëndësisë së saj nëpërmjet nxënësve ekzistojnë marrëdhënie statistikisht domethënëse.

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	N of Items
.924	17

Tabela 3.12.8: Testi i besueshmërisë për mësuesit

Meqë vlera e Alpha është më e madhe se 90% ($\alpha = 0.924$), testi dhe instrumenti i përdorur për vlerësim është i besueshëm. Për realizimin e testit u përdorën të gjitha pyetjet e pyetësit.

KMO and Bartlett's Test

Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.		.838
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square	880.827
	Df	153
	Sig.	.000

Tabela 3.12.9: Testi i vlefshmërisë për mësuesit

Meqë testi KMO ka vlerën 0.838 që është më e madhe se 0.7.

Kjo do të thotë që testimi i bërë është i vlefshëm, rezultatet janë të vlefshme dhe rrjedhimisht pasqyrojnë siç duhet fenomenin që po studiojmë.

Nga ana tjetër vlera e Chi Square është e rëndësishme, gjë që e përforcon idenë e vlefshmërisë së pyetësit. Të dy këto teste na lejojnë të bëjmë analizën e përgjigjeve për secilën prej pyetjeve.

VAR00007 * VAR00008 Crosstabulation

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal	by Phi	.838	.000
Nominal	Cramer's V	.838	.000
	Contingency Coefficient	.612	.000
N of Valid Cases		50	

Bootstrap for Symmetric Measures

		Value	Bootstrap ^a			
				Std. Error	95% Confidence Interval	
			Bias		Lower	Upper
Nominal	by Phi	.838	.000	.000	.838	.838
Nominal	Cramer's V	.838	.000	.000	.783	.838
	Contingency Coefficient	.612	.000	.000	.612	.612
N of Valid Cases		50	0	0	50	50

Tabela 3.12.10 : Vlerat e korrelacionit linear bivariat ndërmjet variablave dhunë dhe shpeshhtësisë së saj.

Bazuar në korrelacionin linear bivariat ndërmjet variablit të pavarur - dhunës në shkollë dhe variablit të varur-shpeshtësia e dhunës për nxënësin rezulton se:

Koeficienti i phi-së përdoret për të kërkuar lidhjen ndërmjet dy ndryshoreve e cila rezulton me përgjigjen po ose jo. Koeficienti Phi, vlera r është 0.838 e përfutur në fund të analizës, paraqet korrelacionin ndërmjet ndryshoreve, lidhja e tyre është pozitive

Vlera Cramer's V është llogaritur për 0.838. Me fjalë të tjera, një analizë e këtillë, nuk tregon marrëdhënien shkak-pasojë, mirëpo jep idenë se në çfarë niveli dhe në çfarë drejtimi do të ndryshojnë ndryshoret.

Niveli i rëndësisë Contingency Coefficient - koeficientit të korrelacionit (ρ) është 0.612 dhe është pozitive. Kjo na tregon se dhuna jo vetëm është e pranishme, por me kalimin e viteve është rritur. Meqë koeficienti i korrelacionit është ndërmjet 0,50 – 1,00 konsiderohet të jetë një lidhje e

Për shkak se kampioni i mësuesve është $N=50 < 100$ Analiza ANOVA nuk mund të zbatohet

Përfundim verifikohet:

Hipoteza 1: Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është në rritje .

Hipoteza 2: Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ndikon në performancë dhe rezultatet arsimore të nxënësit.

Ndërmjet dhunës fizike dhe psikologjike në shkollë dhe performancës si dhe rezultatet arsimore nëpërmjet nxënësve ekzistojnë marrëdhënie statistike domethënëse.

VAR00001 * VAR00014 Crosstabulation

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.723	.000
	Cramer's V	.723	.000
	Contingency Coefficient	.614	.000
N of Valid Cases		520	

Bootstrap for Symmetric Measures

		Bootstrap ^a				
		Value	Bias	Std. Error	95% Confidence Interval	
					Lower	Upper
Nominal by Nominal	Phi	.723	.002	.033	.358	.491
	Cramer's V	.723	.002	.033	.358	.491
	Contingency Coefficient	.614	.001	.026	.337	.441
N of Valid Cases		520	0	0	520	520

Tabela 3.12.11: Vlerat e korrelacionit linear bivariat ndërmjet variablave dhunë dhe ndikimit së saj në performancë.

Bazuar në korrelacionin linear bivariat ndërmjet variablit të pavarur - dhunës në shkollë dhe variablit të varur-ndikimit të dhunës në performancë për nxënësin rezulton se:

Koeficienti i phi-së përdoret për të kërkuar lidhjen ndërmjet dy ndryshoreve e cila rezulton me përgjigjen po ose jo. Koeficienti Phi, vlera r është 0.723 e përfituar në fund të analizës, paraqet korrelacionin ndërmjet ndryshoreve, lidhja e tyre është pozitive

Niveli i rëndësisë Contingency Coefficient - koeficientit të korrelacionit (rho) është 0.614 dhe është pozitive. Kjo na tregon se dhuna jo vetëm është e pranishme, por me kalimin e viteve është rritur. Meqë koeficienti i korrelacionit është ndërmjet 0,50 – 1,00 konsiderohet të jetë një lidhje e lartë, prandaj kjo na tregon se ekziston një lidhje e fuqishme ndërmjet këtyre dy variablave.

. Ndërmjet dhunës fizike dhe psikologjike në shkollë dhe rezultatet arsimore nëpërmjet nxënësve ekzistojnë marrëdhënie statistikisht domethënëse.

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.691	.000
	Cramer's V	.691	.000
	Contingency Coefficient	.568	.000
N of Valid Cases		520	

Bootstrap for Symmetric Measures

			Bootstrap ^a			
					95% Confidence Interval	
Value			Bias	Std. Error	Lower	Upper
Nominal by Nominal	Phi	.691	.002	.023	.645	.737
	Cramer's V	.691	.002	.023	.645	.737
	Contingency Coefficient	.568	.001	.013	.542	.593
N of Valid Cases		520	0	0	520	520

Tabela 3.12.13: Vlerat e korrelacionit linear bivariat ndërmjet variablave dhunë dhe ndikimit së saj në rezultatet arsimore.

Bazuar në korrelacionin linear bivariat ndërmjet variablilit të pavarur - dhunës në shkollë dhe variablilit të varur-ndikimit të dhunës në rezultatet arsimore për nxënësin rezulton se:

Koeficienti i phi-së përdoret për të kërkuar lidhjen ndërmjet dy ndryshoreve e cila rezulton me përgjigjen po ose jo. Koeficienti Phi, vlera r është 0.691 e përfituar në fund të analizës, paraqet korrelacionin ndërmjet ndryshoreve, lidhja e tyre është pozitive

Niveli i rëndësisë Contingency Coefficient - koeficientit të korrelacionit (rho) është 0.568 dhe është pozitive. Kjo na tregon se dhuna jo vetëm është e pranishme, por me kalimin e viteve është ndikon në rezultatet arsimore të nxënësit. Meqë koeficienti i korrelacionit është ndërmjet 0,50 – 1,00 konsiderohet të jetë një lidhje e lartë, prandaj kjo na tregon se ekziston një lidhje e fuqishme ndërmjet këtyre dy variablave.

Ndikimi i rasteve të dhunës

One-Sample Test

	Test Value = 0					
	T	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
					Lower	Upper
Si ndikojnë rastet e dhunës	53.523	519	.000	2.842	2.74	2.95

Tabela 6.13.14: Ndikimi i dhunës në performancën e nxënësit

Jemi mbi 50 % të sigurt që dhuna ka pasoja në përgatitjen e nxënësve dhe performancën e tyre.

Ekuacioni bazë i një modeli regresioni linear është:

$$Y = \beta_0 + \beta_1 X_i + \varepsilon_i$$

Koeficienti i besueshmërisë = 95%

Model Summary

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.794 ^a	.631	.032	.48908

a. Predictors: (Constant), VAR00014

Tabela 3.12.15. Modeli i shumës së regresit linear

Në tabelë është dhënë vlera R^2 . Vlera e gjetur këtu është 0.631.

Sipas këtij rezultati, 63.1 % e ndryshimit në ndryshoren e varur shpjegohet nga ndryshorja e pavarur e përfshirë në model. Me fjalë të tjera, pjesa e ndryshimit prej 63.1% në performancën e nxënësit.

Model Summary

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.680 ^a	.4624	.229	.43662

a. Predictors: (Constant), VAR00023

Tabela 3.12.16. Modeli i shumës së regresit linear

Në tabelë është dhënë vlera R^2 . Vlera e gjetur këtu është 0.4624. Sipas këtij rezultati, 46.24 % e ndryshimit në ndryshoren e varur shpjegohet nga ndryshorja e pavarur e përfshirë në model. Me fjalë të tjera, pjesa e ndryshimit prej 46.24% në performancën e nxënësit.

ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	4.364	1	4.364	186.243	.000 ^b
	Residual	123.905	518	.239		
	Total	128.269	519			

a. Dependent Variable: VAR00001

b. Predictors: (Constant), VAR00014

Tabela 3.12.16 : Analiza Anova

Vlerë me rëndësi e cila duhet të interpretohet në tabelë është vlera F e cila tregon rëndësinë e modelit dhe vlera Sig. e cila tregon nivelin e rëndësisë. Në qoftë se vlera F është 186.243 e rëndësishme çon në përfundim se modeli statistikisht është plotësisht i

rëndësishëm. Modeli jonë i cili shpjegon ndikimin e dhunës në performancën e nxënësit është një model i rëndësishëm.

Coefficients ^a					
Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	Sig.
		B	Std. Error	Beta	
1	(Constant)	1.401	.042		.000
	VAR00014	.90	.021	.184	.000

Tabela 3.12.17 : Tabela e koficientëve të standartizimit

Dhe në fund, marrin pjesë vlerat e parashikimit të koeficientëve të modelit dhe vlerat t në lidhje me këto. Sipas tabelës ndikimi është me 0,90 njësi. Vlerat në lidhje me këtë koeficient janë të rëndësishme në çdo nivel (Sig. = 0,000) dhe prandaj koeficienti i ndryshores së dhunës është i rëndësishëm statistikisht.

Për ta përmbledhur, rezultati i parashikimit të modelit është si më poshtë:

$$\hat{y} = 1,401 + 0,90x$$

Këtu y paraqet dhunën dhe x performancën e nxënësit.

Model Summary				
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.580 ^a	.630	.229	.43662

a. Predictors: (Constant), VAR00023

Tabela 3.12.18. Modeli i shumës së regresit linear

Në tabelë është dhënë vlera R^2 . Vlera e gjetur këtu është 0.630.

Sipas këtij rezultati, 63 % e ndryshimit në ndryshoren e varur shpjegohet nga ndryshorja e pavarur e përfshirë në model. Me fjalë të tjera, pjesa e ndryshimit prej 63.1% në rezultatet arsimore të nxënësit.

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	29.519	1	29.519	154.846	.000 ^b
	Residual	98.750	519	.191		
	Total	128.269	520			

a. Dependent Variable: VAR00001

b. Predictors: (Constant), VAR00023

Tabela 3.12.19 : Analiza Anova

Vlerë me rëndësi e cila duhet të interpretohet në tabelë është vlera F e cila tregon rëndësinë e modelit dhe vlera Sig. e cila tregon nivelin e rëndësisë. Në qoftë se vlera F është 154.846 e rëndësishme çon në përfundim se modeli statistikisht është plotësisht i rëndësishëm. Modeli jonë i cili shpjegon ndikimin e dhunës në rezultatet arsimore e nxënësit është një model i rëndësishëm.

Coefficients ^a					
Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	Sig.
		B	Std. Error	Beta	
1	(Constant)	.926	.054		.000
	VAR00023	.661	.021	.480	.000

a. Dependent Variable: VAR00001

Tabela 3.12.20 : Tabela e koficientëve të standartizimit

Dhe në fund, marrin pjesë vlerat e parashikimit të koeficientëve të modelit dhe vlerat t në lidhje me këto. Sipas tabelës ndikimi është me 0, njësi. Vlerat në lidhje me këtë koeficient janë të rëndësishme në çdo nivel (Sig. = 0,000) dhe prandaj koeficienti i ndryshores së dhunës është i rëndësishëm statistikisht.

Për ta përmbledhur, rezultati i parashikimit të modelit është si më poshtë:

$$\hat{y} = 0.926 + 0,661x$$

Këtu y paraqet dhunën dhe x rezultatet e nxënësit.

Përfundim verifikohet:

Hipoteza 2 : Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ndikon në performancë dhe rezultatet arsimore të nxënësit.

3.13 Analiza e intervistave

U kryen intervista me persona kyç. 20 të intervistuarit janë zgjedhur nga pozicionet më të larta në institucionet e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve.

Ata u gjykuan se kanë më tepër përvojë profesionale dhe përgjegjësi aktuale.

K. J- Specialiste e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike ALCIRT

Komiteti Ndërmator për të Drejtat e Fëmijëve u themelua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 3 dhjetor 2008, është trupi me përfaqësimin më të lartë, dhe përfaqëson një përkushtim të rëndësishëm ndaj politikave për të drejtat e fëmijëve përgjatë të gjithë sektorëve relevantë të Qeverisë. Komiteti Ndërmator për të Drejtat e Fëmijëve është krijuar për të komunikuar dhe koordinuar politikat, programet dhe proceset në lidhje me çështjen e të drejtave të fëmijëve, për të lehtësuar realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe për t'u ofruar atyre mundësi të barabartë për pjesëmarrje aktive në shoqëri.

Për të realizuar përfshirjen e të drejtave të fëmijëve në të gjitha politikat shtetërore dhe koordinimin e aktiviteteve vendore për parandalimin e dhunës tek fëmijët si dhe të merren masa specifike për eliminimin e të gjitha formave të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, është hartuar "Protokolli për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar". Protokolli përcakton detyrimet, qartëson rolet dhe procedurat të institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin, mënyrën e raportimit të dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit parauniversitar. Përcaktimi i veprimeve të cilat pritet të përforcojnë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe multidisiplinar për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe për t'u mbrojtur fëmijët nga dhuna. Ndër qëllimet më

kryesore që adreson Protokollin është formimi i sistemit unik për grumbullimin e të dhënave mbi veprimet e dhunshme, i cili do të mundëson përdorimin e informacionit për të promovuar sigurinë në shkollë dhe të mësuarit, përcjelljen e trendit të shfaqjes së dhunës dhe ndërmarrjen e masave/veprimeve të nevojshme për të parandaluar dhe eliminuar dhunën brenda institucioneve edukativo-arsimore. Për të parandaluar dhunën në shkolla janë realizuar aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuëse të cilat ndikojnë në rritjen e mundësive për parandalimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, përfitues së të cilave ishin fëmijët/ nxënësit, ndërsa në projektin kundër dhunës janë përfshirë 416 shkolla. Përkundër përpjekjeve institucionale në luftimin e dhunës, ajo ende po vazhdon dhe atë jo në numër të vogël, prandaj duhet të bëhet më shumë për ta bërë shkollën mjedis më të sigurt për fëmijët. Këtij fenomeni padyshim që e shoqëron mungesa e hapësirës shkollore, numri i lartë i nxënësve në klasë, mungesa e kushteve për realizimin e aktiviteteve krijuese, përfshirja e pamjaftueshme e prindërve në veprimtaritë e shkollës, njohuritë e kufizuara të mësimeve për shenjat e abuzimit dhe format e dhunës.

Strategjitë në Republikën e Shqipërisë

Sipas strategjisë kombëtare për fëmijë dhe planit të veprimit 2005-2010 dhuna verbale dhe emocionale ndeshet shpesh në shkolla, ndërsa ajo fizike më rrallë. Shërbimi psikologjik në shkolla vlerësohet si një risi e mirëpritur si nga nxënësit ashtu edhe nga personeli pedagogjik i shkollës, por numri i profesionistëve në shkolla është i kufizuar.

Një psikolog mbulon afërsisht 3 shkolla, duke e mbingarkuar atë dhe duke mos i dhënë mundësi të trajtojë çështjet e të gjithë fëmijëve, por të bëjë një përzgjedhje të rasteve të vështira të cilat kërkojnë më shumë vëmendje për t'u trajtuar, që kryesisht

parashtrihen nga personeli pedagogjik dhe jo nga vetë fëmijët. Kjo bën që nxënësit të kërkojnë në mënyrë spontane ndihmën e psikologut për problemet e përditshme që mund t'i shqetësojnë. Në këtë mënyrë është e vështirë që të vendoset një ndjenjë besimi reciprok ndërmjet nxënësit dhe psikologut, ku nxënësit të përfitojnë më të vërtetë nga ky shërbim.

Në ndihmë të fëmijëve të neglizhuar apo që kanë braktisur më parë arsimin e detyruar, MAS ka ndërmarrë një iniciativë e re ” Braktisje zero në arsimin 9 vjeçar”. Aktualisht përveç projekteve të OJF-ve, nga MAS ka zbatuar edhe projektin ”Shansi i Dytë”, i cili vlerëson se ka pasur rritje të numrit të nxënësve që e frekuentojnë, por nuk është i shtrirë në të gjithë vendin dhe fëmijët që ndjekin këtë rrugë të edukimit nuk regjistrohen në amza dhe nuk pajisen me dëftesa.

Ka raste të mësuesve pa kualifikimin e nevojshëm për të punuar me këtë kategori fëmijësh. Për mbështetjen e fëmijëve romë është zbatuar Udhëzimi i MAS për pranimin në shkollë të këtyre fëmijëve edhe pa certifikata.

Në bashkëpunim me disa bashki janë siguruar mjete edhe pajisje mësimore për këta fëmijë. Për rastet e fëmijëve të abuzuar apo neglizhuar, të konstatuar nga shkollat është bashkëpunuar me punonjësin e mbrojtjes së fëmijëve në bashki (në ato bashki ku tashmë është ngritur kjo strukturë). Në disa raste bashkia dhe shkollat kanë bashkëpunuar edhe për organizimin e aktiviteteve sensibilizuese lidhur me zbatimin e të drejtave të fëmijëve duke shënuar një eksperiencë pozitive bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndryshme në nivel vendor.

Dhuna pengon një fëmijë të zhvillojë potencialin e tij/saj të plotë. Mungesa ose prania e dhunës do të ndikojë në suksesin në jetë më vonë. Pasojat e dhunës fizike, emocionale dhe psikologjike mund të kenë shumë ndikim në zhvillimin fizik dhe

mendor të fëmijëve dhe në aftësitë e tyre për të mësuar. Në shekullin e 21 nuk ka vend për dhunë ndaj fëmijëve. Gjithsesi ajo vazhdon të shkatërrojë jetë në çdo vend dhe në të gjithë shtresat e shoqërisë.

Megjithëse qeveria shqiptare ka bërë përpjekje për të reformuar ligjet që trajtojnë dhunën ndaj grave dhe fëmijëve, ka akoma shumë mangësi në legjislacion. Nuk ka asnjë strukturë qeveritare në nivel qendror dhe vendor që të jetë drejtpërdrejtë përgjegjëse për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve. Për më tepër nevojiten përpjekje për të dokumentuar më mirë përhapjen dhe karakteristikat e dhunës ndaj fëmijëve dhe për të kuptuar më mirë shkaqet e saj.

Ndryshimi i qëndrimeve dhe besimit ndaj kujdesit dhe vëmendjes që kemi për fëmijët është në krye të axhendave mbrojtëse të UNICEF. Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka zbatuar një program komunikimi 4 vjeçar në shkollat publike në të gjithë vendin duke u fokusuar në një ndryshim madhor; uljen e rasteve të dhunës nga mësuesit/kujdestarët ndaj nxënësve/fëmijëve nëpërmjet praktikave të Mënyrave të Reja të Disiplinës (NWD).

Programi parandalues synon të reduktoj shpeshësinë e sjelljeve të dhunshme të mësuesve dhe kujdestarëve ndaj fëmijëve dhe nxënësve nëpërmjet përdorimit të praktikave të reja.

Lufta ndaj dhunës mbi fëmijët është një shembull i mirë i qasjes së UNICEF për të bindur dhe për të formuar aleanca me aktorët kombëtarë për t'i dhënë prioritet kësaj çështje. Bazuar në një përpjekje të fortë me Zyrën Rajonale të UNICEF, Komisioni Evropian, institucionet akademike shqiptare, punonjësit e shërbimeve sociale dhe OJQ, një nivel i lartë evidencash të nxjerra së fundmi ishte më se i mjaftueshëm për të arritur nivelet më të larta të vendimmarrjes në vend.

Përkushtimi i përfaqësuesit të qeverisë i bërë publik në nivel kombëtar me rastin e Ditës Botërore të Fëmijëve në Nëntor të 2012 përforcoi më tepër punën që kishte filluar. Linja telefonike për fëmijë “ALO 116” – është një tjetër mekanizëm i njohur si një nga shërbimet më të mira në Evropë – dhe vazhdon të funksionojë. Hartuesit e politikave, parlamentet dhe parlamentarët kanë pushtetin për të patur në qendër të vëmendjes ndikimin e dhunës ndaj fëmijëve. Nëpërmjet përparimit, legjislacionit dhe hetimit të orientuar parlamentarët mund të mundësojnë një progres të shpejtë drejt eliminimit të dhunës ndaj fëmijëve.

Ministri i Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Deputetët, Kryeministri, Delegacioni i Bashkimit Evropian, dhe agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara duhet të mblidhen së bashku për të mundësuar që ligjet që ndalojnë dhunën fizike të zbatohen me rigorozitet dhe se proceset gjyqësore do të iniciohen sistematikisht ndaj personave përgjegjës për dhunën fizike ndaj fëmijëve; të kriminalizohen të gjitha format e dhunës në familje dhe të detyrohen dhunuesit të mbajnë përgjegjësi: punonjësit social të specializuar në mbrojtjen e fëmijëve duhet të jenë në çdo njësi të qeverisjes vendore: Ministria e Arsimit duhet të mbështesë mënyrën e re të disiplinës në shkollë; qeveria të mbështesë linjën telefonike për fëmijë “ALO 116” dhe ta njoh atë si një burim të dhënash për vendimmarrjen e politikave; të miratojë masa parandaluese për familjet që janë në rrezik të përfundojnë në rrugë dhe të mbështesë kthimin e fëmijëve pranë familjeve atëherë kur shihet e arsyeshme.

Nuk janë vetëm këto institucioneve joqeveritare që kujdesen për të drejtat e fëmijëve dhe shmangien e aksesit të tyre në internet ndaj përmbajtjeve të dëmshme. Për tu bindur për këtë fakt, përmendim Vendimin e Këshillit të Ministrave në korrik të vitit 2014 për ngarkimin e përgjegjësisë ndaj Agjencisë Kombëtare për Sigurinë

Kompjuterike (ALCIRT) për krijimin e portalit, i cili do bllokojë adresat me përmbajtje të papërshtatshme.

Në nëntor të vitit 2011 kryeministri Berisha krijoi ALCIRT me VKM 766. Në korrik të vitit 2014 VKM së mësipërme iu shtua si pikë përgjegjësie garantimi i mirëmbajtjes së portalit për mbrojtjen ndaj ekspozimit të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme. Me mbështetjen e aktorëve të fushës së sigurisë kompjuterike në vendin tonë u arrit të realizohet faza e parë e zbatimit të këtij projekti. Pavarësisht mendimeve dhe argumentave kundër, sidomos nga ana e ISP-ve për bllokimin e adresave të ndryshme me domain shqiptar ose të huaj u arrit bashkëpunimi, i cili shumë shpejt do të mundësojë një herë e përgjithmonë mohimin e aksesit në faqet me përmbajtje të papërshtatshme për të gjithë përdoruesit e internetit brenda Republikës së Shqipërisë. Raste të ngjashme: ndalimi i aksesit të Facebook në Kinë dhe Twitter në Turqi.

Projekti i cili ka nisur të implementohet është bashkëpunim midis ALCIRT, InfoSoft dhe ISP-ve në vendin tonë. Portali i cili gjeti mbështetje të fuqishme nga organizatat, që mbështesin fëmijët do të jetë shumë shpejt i aplikueshëm dhe në këtë formë do të shmanget një herë e përgjithmonë aksesit i fëmijëve e jo vetëm për përmbajtjet e dhunës në shkollë, por raciste, etnike, etj

L.M – Koordinate e të rinjve

Zyra për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Bashkive financuar nga UNICEF identifikon dhe ndihmon fëmijët në nevojë, fëmijë të dhunuar, të trafikuar ose në rrezik për t'u shfrytëzuar. Bashkëpunon me gjykatën, Drejtorinë Arsimore dhe Bordin e Shkollës, por nuk ka statistika të rasteve të dhunës kundër fëmijëve.

Administratorët Socialë të Bashkive janë punonjës publikë të punësuar nga pushteti vendor për të administruar ndihmën ekonomike, ndihmën e paaftësisë dhe dhënien e shërbimeve sociale.

Plani Social është dokument strategjik vendor mbi të cilin ndërtohet puna në vazhdimësi.

D. K – Përgjegjës i Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë në Drejtorinë Arsimore Rajonale Dibër shpehet se dhuna në shkollë ekziston. Dhuna ndodh edhe në shkollat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendi më demokratik. Nga përvoja personale mund të them se historia e shkollës amerikane është e mbushur me raste të dhunës në shkollë si:

Incidentet më 1927 në Bath, Township dhe në Michigan, 1992 një incident fatkeq në shkollën e mesme Virgjinia, masakra që ndodhi në vitin 1999 në shkollën e mesme Columbine, Kolorado, 2006 Pensylvani, dhjetor 2012 në Konektika.

Statistika të dhunës në shkollë nuk ka, por nuk ka as raste të paraqitur në DAR, ndoshta dhe për faktin që jemi në një qytet të vogël, ku njihemi me emër dhe mbiemër. Ka patur raste që mund të kenë ndërruar shkollën ose janë zgjidhur mes palëve, por nuk janë zyrtarizuar. Sipas mendimit tim nuk do të ketë shoqëri njerëzore pa dhunë, por ajo që ka bërë MAS dhe DAR është shërbimi i “psikologut të shkollës”. Një psikolog shkollor mbulon tre shkolla dhe viziton secilën shkollë dy herë në javë. Roli i psikologut të shkollës është të identifikojë dhe t’u përgjigjet problemeve sociale në bashkëpunim me mësuesit dhe drejtorinë e shkollës. Psikologët kanë mbaruar për psikologjidhe kanë bërë trajnime shtesë.

Ndryshimi i drejtimit të formave shkatërruese të dhunës duke e kthyer prirjen drejt saj në favor të formave kolektive si sportet, duke rritur numrin e orëve nga 2 orë në

klasëne 10 dhe 1 orë në klasën e 11 në 3 orë për të gjitha klasat në gjimnaz dhe shkollat e mesme profesionale. Ndoshta mjediset sportive nuk janë në nivelin e duhur, por është detyrë e drejtuesve të shkollave për menaxhimin e procesit mësimor si dhe bashkëveprimet me Bordin, DAR dhe Bashkinë Dibër për krijimin e mjediseve sportive me standarde.

Pavarësisht nga këto iniciativa të dobishme duhet thënë se problemi i dhunës, që ushtrohet kundër fëmijëve nuk është ende një problem i mirëfilltë i punës së ndonjë sektori në DAR.

DAR ka qenë mbështetëse e projekteve të World Vizion, Save the Children,...Do të ishte ideale të kishim një kombinim të të gjithë aktorëve, të trajnimeve, konferencave, politikave zero tolerancë, sigurisë elektronike dhe personelit të sigurisë.

Gjithsesi këto mbeten sfida të arsimit në të ardhmen.

A. J – Sekretare në Gjykatën e Peshkopisë

Rastet e dhunës në shkollë trajtohen nga Gjykata e të Miturve në Tiranë. Rasti i Krenar.B është trajtuar nga Gjykata e të Miturve në Tiranë. Nuk kemi patur raste të dhunës institucionale ndaj personelit mësimdhënës për gjykim. Zgjidhja është gjetur mes palëve dhe jo nëpërmjet organeve gjyqësore.

Inspektorja në Sektorin e Krimit të Komisarariatit të Policisë *Besa Uka* shprehet se më shumë janë trajtuar raste të dhunës në familje, që prek edhe fëmijët. Sa për rastin e dhunës në shkollë janë zgjidhur mes palëve. Për rastin Krenar. B nuk kemi ndonjë dokument që tregon për ngjarjen dhe vazhdimësinë e problemit. Zona ku ndodhet Shkolla e Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti" mbetet një zonë e nxehtë. Aty ndodhet stacioni i linjave kombëtare, Pallati i Sportit, Stadiumi "Korabi", Gjimnazi "Said

Najdeni", një sërë mjedisesh sportive private, tregu i fruta-perimeve dhe karburanti. E pamundur pa ndodhur një incident.

Gjithashtu në projektin "Policimi në komunitet" ku përfshiheshin dhe shkollat e mesme të Peshkopisë nxënësit janë shprehur se nuk kanë besim te policia në rastet e dhunës. Sistemet e Matjes së Sigurisë në Komunitet (SMSK) sigurojnë informacion për sigurinë dhe rendin në komunitet. Fokusimi i punës së policisë tek problematika e qytetarëve si dhe tek drejtimi dhe monitorimi i performancës është një shenjë e dukshme e të gjitha shërbimeve policore moderne në të gjithë botën.

B. K –gazetar dhe botues i gazetës "Rruga e Arbërit"

Të shpëtojmë fëmijët nga shfrytëzimi dhe errësira e analfabetizmit ka qenë një ndër shkrimet e mia. Zhytur në varfëri, fëmijëve të zonave rurale u mungon e drejta për arsimim. Puna e fëmijëve në Shqipëri i heq shkëlqimin industrisë së kromit. Sa për dhunën kanë qenë raste jo të publikuara, por rast specifik nuk kemi patur. Media shpesh kalon kufijtë e saj duke publikuar emrat e fëmijëve.

Sipas *F. C* – Drejtor i Gjimnazit "Said Najdeni" Peshkopi:

Gjimnazi "Said Najdeni" është institucioni më i madh në Bashkinë Dibër, me shtrirje në të gjitha Njësitë Administrative dhe shumë e vështirë për t'u menaxhuar. Gjatë gjithë kohës duhet të jesh në lëvizje për të patuir situatën nën kontroll. Anë e fortë e gjimnazit është puna në ekip, dixhitalizimi i shkollës, Shkolla – Qendër komunitare dhe godinë e re. Energjitë e të rinjve po i kanalizojmë në aktivitete. Shqetësuese janë mësuesit e rinj pa përvojën e duhur profesionale, orët e edukimit fizik, palestra në katin e katërt, lokalet përballë shkollës dhe të rinj të kthyer nga emigracioni ose të papunë

Sipas drejtueses së shkollës “ Nazmi Rushiti” A. S: viktima Krenar. B ishte i vetmi nxënës, që e kish sfiduar dhe nuk kishte si ndodhte ndryshe me të...

Kur gjëma ndodh, të gjithë janë vonë...Nuk kish si të ndodhte ndryshe me Krenarin që shpejtësia e tij nuk ishte në parametrat e rrugëtimit të arsimit shqiptar. Ndoshta është trashëgimi familjare se dhe prindërit e Krenarit kanë qenë model në moshën e tij dhe adhurohen nga të gjithë.

Ëndrrën e Krenarit do ta realizoj tek nxënësit e shkollës “Nazmi Rushiti” për të qenë agjentë të ndryshimit në arsimin dibran dhe shqiptar.

Sot shkolla e mesme “Nazmi Rushiti” nën drejtimin e saj ka një qasje drej projekteve dhe e-learning.

Sipas drejtoreshë së konviktit të së shkollës “ Nazmi Rushiti” *Sadet Shahi*: Shkolla është ngjit me konviktin dhe ka pasur konflikte që janë transmetuar në shkollë. Policia rreth 26% e nxënësve shprehen për armë të ftohta, prandaj duhet të hartohet një plan ndërhyrjeje që përfshin situatën në shkollë dhe në konvikt, që mbart konflikt. Duke qenë se shkolla menaxhon pjesën më të madhe që ndodhin në konvikt, mendoj se duhet të ngrihet një rrjet nxënësish të trajnuar për menaxhimin e konflikteve për të identifikuar nxënësit që janë potencial i mundshëm për tu bërë pjesë e konfliktit. Bashkëpunim nxënës – mësues kujdestar dhe psikologe. Të kryhen kontrolle në çantat e nxënësve. që mbajnë armë të ftohta në shkollë. Ora e praktikës mësimore në mekanikë dhe porta e përbashkët e shkollës me konviktin është një burim konfliktesh. Bashkëpunim me policinë në raste krizash për parandalim.

Gjithashtu shkolla është bërë pjesë e projektit për Lidership nga mosha 12-18 vjeç. Mesazhi që përcjellin është se ato janë agjentë të ndryshimit në komunitet.

Përzgjidhen idetë e tyre për rigjenerim fondesh, të cilat kalojnë për familjet në nevojë.

Në këtë mënyrë rriten kapacitetet për tregun e punës. Në këtë mënyrë ato do të parandalojmë dhunën në shkollë, sepse nuk do të jemi në korridoret e konviktit apo në oborrin e shkollës me "skenën " e rradhës, por kemi forcën e ndryshimit duke u bërë të dobishëm për komunitet.

I. B-Xhaxhai i Krenar.B

Krenari ashtu siç kish emrin pushtonte mendjet, arsyet, zemrat dhe shpirtin e gjithkujt që pati fatin ta takojë dhe të dëgjojë për të. Kishte një koeficient inteligjence shumë më të lartë se bashkëmoshatarët e tij. Shokët u lidhën shumë pas tij, sepse në fytyrën e tij nuk kish gënjeshtër dhe ligësi.Gjithkush, që e shihte për herë të parë mahnitej nga fisnikëria dhe mesazhet që transmetonte.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Krenari ishte pasardhës i denjë i të parëve të tij, që këputën vargonjtë e diktaturës, për më tepër ishte model qëndrese, fisnikërie e miqësie.Largimi i tij tronditi fort familjen, të afërmit, shokët duke hapur rrugë, që dhuna dhe padituria të fundosë sportistin e madh, të shkretojë familjen dhe shoqërinë.Familjarët janë mbyllur në heshtje të thellë nga padrejtësitë e institucioneve shqiptare dhe kanë zgjedhur arsimimin e fëmijëve jashtë Shqipërisë, ku janë të sigurt dhe ofrojnë sistem vlerash. Emri i Krenarit përmendet me dashuri dhe respekt. Modeli i djalit të përsosur. Nëse e vështrojmë nga dritarja e kohës, që jetojmë do të vëmë re se mënyra se si i zgjidhte situatat problemore, fjalët, jeta, vlerat, virtytet dhe cilësitë ishin modeli i njeriut, që sot shoqëria jonë ka më tepër nevojë se kurrë. Natyra,krenaria shqiptare,dashuria e njerëzve që e rrethonin, kontrastet e jetës shqiptare lanë në temperamentin e tij gjurmë si sportist.

Ëndrra e tij për t'u endur nëpër botë me Shqipërinë në zemër duke valëvitur flamurin shqiptar në kampionate botërore i brohoritur nga miliona tifozë me Kombëtaren Shqiptare mbeti ëndërr. Nëse e shohim nga dritarja e kohës që kalojmë Kombëtarja Shqiptare ka më tepër nevojë se kurrë për Krenarin.

Sot vëllai i tij, Andi ka zgjedhur të realizojë ëndrrën e vëllait duke u diplomuar në universitetet e Evropës për të valëvitur flamurin shqiptar në konferenca dhe simpoziume shkencore.

D. Ka.- Këshilltare në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Kosovë

Sot MASHT dhe MASR kanë një bashkëpunim të shkëlqyer. Ekipet e përbashkëta kanë bërë punë intensive dhe arritën që Shqipëria dhe Kosova të njëjtësojnë Kornizën Kurrikulare. Sot kemi hapësira të përbashkëta të kërkimit shkencor në edukim, kualifikimin e mësuesve dhe tekste të përbashkëta. Kosova dhe Shqipëria kanë sot modele të përbashkëta kurrikulare që integrojnë arsimin në hapësirën evropiane.

Ne nuk kemi ndonjë program të veçantë për Komunën e Prizrenit, por është përgjegjësi e Drejtorive Arsimore Komunale të zgjedhin psikologë profesionistë.

Ne jemi te një fazë ku ka ndryshuar forma e dhunës në shkolla. Kemi të bëjmë me ngacmime brenda shkollave, me rrahje ndërmjet fëmijëve, me ndonjë indiferencë të lehtë të mësimeve për t'iu qasur zgjidhjes së problemeve të fëmijëve. Këta shembuj tregojnë se mënyra e zgjidhjes së problemeve duhet të ndryshojë.

Qëllimi i shkollës nuk është që t'i përjashtojë njerëzit nga sistemi, ndoshta pastaj të krijojë raste edhe më të rënda jashtë sistemit, por të gjejë dhe të ofrojë zgjidhje brenda sistemit të arsimit, t'i integrojmë, të përballemi me ata që bëjnë probleme dhe të ofrojmë zgjidhje konkrete. Jo të bëhet eliminimi i tyre, sepse çdo hedhje në rrugë është fillimi i problemit.

S. S - Asistente Pedagoge e Pedagogjisë në Universitetin e Prizrenit.

Sot janë të shumta rastet e dhunës, ku mësuesit përfundojnë në rajonin e policisë ose bëhen pjesë e rrjeteve të ndryshme sociale.

Departamenti i Pedagogjisë ka investuar në mënyrë të palodhur në përgatitjen e armatës së mësuesve të rinj dhe ka një mësimdhënie strikte. Studentët janë përfshirë në mënyrë intensive në projekte kërkimi në fushën e edukimit. Çdo sfidë shoqërohet me energji pozitive.

Studentët e Pedagogjisë dallohen për nivel të lartë shkencor në punët kërkimoro-shkencore, praktikën arsimore dhe përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe të nxënë.

Y. B – Administrator i Qendrës Psikologjike "FRENA" Prizren dhe mësues i psikologjisë në Gjimnazin "Remzi Ademaj".

E keqja e mësuesve është kontrolli i pandërprerë mbi nxënësin, që në shumicën e rasteve e mërzit dhe mbingarkon. Krijoi një sipërfaqe të lirë, ku mund të japë maksimumin nga vetja, por bëja me dije se nëse nuk e përdor si duhet kjo sipërfaqe lirie nuk do të funksionojë. Ai ndihet shumë më i fortë për shkak të lirisë së tij. Ai mund të kapërcejë edhe muret, nëse kontrollin e këmbëjmë me përkushtim dhe profesionalizëm. Mos i bëj shpatullat e nxënësit fushë sporti, topi i të cilës është kontrolli i tepërt!

D. A – Drejtor i Gjimnazit "Remzi Ademaj" Prizren

Gjimnazi "Remzi Ademaj" Prizren po merr identitetin e tij. Gjimnazimka drejtim gjuhësor, nuk ka përbërje etnike, ndodhet në qendër, i drejtuar drejt sporteve, me shumë medalje dhe trofe në shkallë kombëtare, rajonale, pjesë e projektit mbi dixhitalizimin e klasave dhe tentojmë drejt suksesit.

E. N - Kryetar i Bordit të shkollës

Të drejtat dhe detyrat e prindërve janë të rregulluara me ligj. Prindërit ose kujdestarët e fëmijëve janë njohësit më të mirë të fëmijës së tyre. Bashkëpunimi me prindër është çelësi për një punë të suksesshme në shkolla dhe veçanërisht në gjimnaz. Prindërit e nxënësve impulsivë duhen nxitur pasi shpesh ndihen "fajtorë".

Partneriteti shkollë-prind kërkon respekt, mikpritje dhe gatishmëri për të marrë informacionin e duhur. Komunikimi me prindër kërkon përgatitje dhe strategji.

Prindi e ndjen në shpirt se çfarë i mungon fëmijës së tij. Politikat arsimore e fuqizojnë rolin e prindit duke e bërë pjesë të strukturave të shkollës dhe të menaxhimit të saj.

H. J. – Shkolla Doktorale UEJL Tetovë

UEJL ka qenë institucioni i parë jopublik që ofroi studime në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze në Maqedoni. UEJL është institucion jofitimprurës dhe i akredituar. Ka lidhje me shumë universitete në Evropë, Amerikë dhe Shqipëri, një ndër ta është dhe UET. Më vjen mirë që shumë studentë të mi, Sajmira Dardha, Nazyktere Hasani, Ilir Ramadani dhe Zamira Gjeleshi që kanë mbaruar studimet në ciklin e parë ose master vazhdojnë studimet në UET.

UEJL ka organizuar shumë konferenca shkencore me temë sociale dhe ka revistën e saj "Review" ku janë trajtuar tema mbi sjelljet e dhunshme, ku ndërthuren idetë dhe mendimet mes kërkuesve shkencorë. Qendra për Karrierë është urë informimi mes studentëve dhe institucioneve.

Nuk mjafton arsimi i fituar gjatë diplomimit, por është e nevojshme të mësuarit gjatë gjithë jetës duke kërkuar burime informacioni.

A A - Kancelare e USHT

Universiteti Shtetëror i Tetovës ka degët e tij në Shkup, Kumanovë, Kërçovë dhe Dibër

Fakulteti Filozofik ka Programe Studimore të Ciklit të Parë me 240 kredite: Filozofi, Sociologji, Histori, Pedagogji, Psikologji, Filologji Orientale, Edukim Special dhe Rehabilitim.

Drejtimit arsimore the profesionale:

- Pedagog i diplomuar
- Profesor i diplomuar i mësimit klasor
- Profesor i diplomuar për edukim parashkollor
- Profesor i diplomuar i psikologjisë
- Psikolog i diplomuar

Në ciklin e dytë Pedagogji dhe Psikologji merr titullin Magjistër i Pedagogjisë dhe Psikologjisë.

USHT mbulon të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar me kuadro.

USHT në bashkëpunim me Universitetin e Ilionisit Verior në Çikago të ka Qendrën për Paqe dhe Komunikim Transkulturore, si model i ri bashkëpunimi ndërkulturore dhe ndëretnik.

A. P – Psikologe e Gjinnazit "28 Nëntori" Dibër e Madhe

Unë jam psikologe e shkollës nga reforma e fundit për shërbim psikologu e Ministrisë së Arsimit për shkollat e mesme. Nga përvoja personale si ish - nxënëse dhe mësuese e gjinnazit dhe profesionale si psikologe jam zëri i tyre. Pavarësisht se nuk ka asnjë statistikë apo dokument jam një kordinatore bashkëpunimi mes personelit të shkollës dhe nxënësve. Gjinnazi ka përbërje etnike, por vlen të theksohet se në shkollë nuk ka konflikte etnike. Kjo falë kulturës së dibranëve, personelit pedagogjik dhe

drejtuesve të shkollës. Mjediset janë shumë frymëzuese dhe ka një traditë në arsim. Gjithsesi edhe pse mësimi bëhet me turne ku nxënësit shqiptarë janë të ndarë nga nxënësit maqedonas, personeli i shkollës është shumë i kujdesshëm në zgjidhjen e situatave, që të mos dalin jashtë kontrollit. Testimi i nxënësve maturantë është shoqëruar me stres, ndërsa greva e mësimdhënësve për përmirësimin e kushteve u shoqërua me dhunë institucionale. Është një rrugë e gjatë për t'u bërë.

F. M- Koordinator i OJQ Dibër e Madhe

Të gjithë thonë se bazat e arsimit në trojet shqiptare të Maqedonisë janë në Dibër.

Së pari, mësuesit dibranë si Vehbi e Ismet Dibra, Said Najdeni, Sherif Lëngu, Josif Bageri, Haki e Adem Sharofi, etj kanë qenë veprimtarë shumë aktivë për çështjet sociale e sidomos për çështje kombëtare.

Së dyti, në pjesën dërrmuese kanë qenë klerikë dhe mësues njëkohësisht.

Së treti, ato më të shquarit janë marrë edhe me krijimin e abetareve shqipe e teksteve shkollore, me një theks të veçantë edukativ.

Prandaj në pozicionin kordinator i njoh vlerat e të parëve dhe e kam drejtuar arsimin dibran drejt projekteve: "Ndërtojmë ura", shkollave u ofrohen grande që të organizojnë aktivitete të ndryshme në fushën e arsimit, kulturës dhe sportit. Projekti më i fundit është "Avokati i nxënësit", nxënësi – avokat mbron të drejtat e nxënësve në shkollë. Ai merr pjesë në të gjitha mbledhjet e drejtorisë, Bordit dhe Bashkësisë profesionale të shkollës.

E. S – Psikologe e shkollës "Demir Gashi", "Selim Alliu" dhe Gjimnazit "Gjergj Kastrioti" Kastriot

Unë jam pjesë e projektit të organizatës "Partnerë për fëmijë" në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Dibër për psikologë në shkolla.

Pjesë e punës sime janë dosjet me nxënësit problematikë dhe Indrit. R ka dosje personale në shkollën 9;vjeçare. Unë u kam bërë ftesë të hapur drejtuesve të shkollë, prindërve të tij dhe Bordit të shkollës. Heshtja e tyre përfundoi me tragjedi njerëzore. Sot është vonë.

Krenar.B u bë një vend tjetër në qiell, që qemë të paaftë të menaxhojmë inteligjencën e tij.

Nga përvoja profesionale dhe personale kordinimi i të gjithë aktorëve është çelësi i suksesit.

Vlen të theksohet gjimnazi “Gjergj Kastrioti” Kastriot që e mbuloj vitet e fundit edhe pse njihet si zonë problematike, ku dhuna është bashkëshoqëruese, sot mjediset e shkollës janë frymëzuese dhe rrjedhojë e kordinimit të mësuesve, prindërve dhe psigologes. Sot edhe organizatat “Argitra”, “World Vision” e kanë kthyer punën e tyre drejt zonave rurale.

“16 ditë – luftë kundër dhunës ndaj gruas” ishte aktiviteti i mbylljes së fundvitit.

O. D – Koordinatore e Qeverisë së Nxënësve Gjimnazi Maqellarë

Gjimnazi ka një traditë në aktivitete dhe kjo na ka mundësuar që të jemi larg skenave të dhunës. Unë u ktheva në gjimnaz si mësimmdhënëse, por shoh se një pjesë e mirë kanë përqafuar alkoolin, duhanin, lëndët narkotike, arenat e dyluftimeve. Gjimnazi është bërë shumë i zhurmshëm, ndoshta edhe për faktin se fushatat elektorale kanë ndikuar më shumë se duhet në drejtuesin e shkollës. Pjesëmarrja në lëvizje globale si: “Earth hour”, “Global Money Week” apo “16 Day No Violence ” janë tregues se jemi më shumë se çfarë bëjmë.. .

3.14 Analizë e rezultateve të Maturës Shtetërore 2013- 2014


Matura Shtetërore është jo vetëm procedurë e vlerësimit të njohurive të nxënësve, por duhet parë si process i arritjeve akademike.

Si procedurë është diçka shumë e arrirë, por për t’u realizuar është e vështirë duke pasur parasysh infrastrukturën, koston dhe natyrën njerëzore.


Kjo mbetet për t’u parë nga të tjerët, që janë kompetentë të çështjeve të tilla, ndërsa unë po përpiqem të hedh dritë rreth asaj se sa ndikon dhuna në arritjet arsimore të nxënësit.

Matura Shtetërore është quajtur epokë në arsim dhe vlerëson arritjet e nxënësve në Anglisht, Gjuhë Shqipe – Letërsi, Matematikë dhe Lëndët me Zgjedhje Z_1 dhe Z_2

Lënda: Gjuhë Shqipe – Letërsi



Grafiku 3.14.1: Gjuhë Shqipe – Letërsi 2013-2014




Grafiku 3.14.2: Gjuhë Shqipe – Letërsi 2013-2014

Veçojmë për kalueshmëri të ulët gjimnazin “Muhurr” me 68.18 %.

Në nivel kombëtar, në provimin e Maturës Shtetërore – Gjuhë Shqipe dhe Letërsi:

- Kalueshmëria është 94.56%.
- Nota mbizotëruese është nota 7 me 28.23%.
- Notat 6, 7 dhe 8, në përqindje arrijnë mbi 70% të totalit.



Grafiku 3.14.3: Gjuhë Shqipe – Letërsi në shkallë kombëtare

DAR Dibër: Arritjet mesatare të nxënësve kanë një rritje në provimin e maturës me 0.22 notë krahasuar me arritjet mesatare vjetore 2014.

Krahasuar me Maturën Shtetërore 2013 rezulton se:


Duke e krahasuar me një vit më parë kalueshmëria është ulur nga 96.2% që ishte në MSH 2013 në 92.4% në MSH 2014.

Nota mesatare është ulur nga 6.45 që ishte në MSH 2013 në 6.37 në MSH 2014.

Përqindja e vlerësimeve me notën 10 nga 1% në MSH 2013 në 0.5% në MSH 2014

Përqindja e vlerësimit me notën 4 është rritur nga 4.2% në MSH 2013 në 7.7% në MSH 2014

Analiza e shpërndarjes së pikëve




Grafiku 3.14.4: Analiza e shpërndarjes së pikëve në Gjuhë Shqipe - Letërsi


- Nga analiza e shpërndarjes së pikëve rezulton se:
 - 0.5% e totalit të nxënësve (nota 10) ndodhen në intervalin 46-50 pikë.
 - 7.7% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 15 pikë.
 - 40.11 % e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0- 24 pikë.

Pra 40% e nxënësve kanë marrë pikë që janë më pak se gjysma e pikëve maksimale të testit (50 pikë).

Lënda: Matematikë



Grafiku 3.14.5: Matematikë 2013 - 2014



Grafiku 3.14.6: Matematikë 2013 - 2014

Nga kjo tabelë del se % më të ulët kanë shkollat Sllovë, Arras dhe Muhurr.

Renditja e shkollave sipas notës mesatare:

Sipas grafikut kanë notën mesatare më të lartë gjimnazi "Said Najdeni", "Gjimnazi Maqellare" dhe notë mesatare më të ulët Sllovë dhe Arras.

Nuk kanë nota 9 dhe 10 e mesmja profesionale "Nazmi Rushiti" gjimnazet Arras dhe Sllovë.


Matematika në shkallë kombëtare

- mesatarja e pikëvetë fituara: 17.93 pikë
- nota mesatare e maturës: 5.72
- nota mesatare vjetore: 6.23
- kalueshmëria 76.83%
- nota mbizotëruese është nota 5 ose 34.17%

Shpërndarja në përqindje e notave të MSH


- 72.17% të totalit e kanë notat 4, 5 dhe 6.

Kjo tregon se arritjet e nxënësve në provimin e maturës janë të ulëta.



Grafiku 3.14.7: Matematika 2013 – 2014 në shkallë kombëtare

Shpërndarja e pikëve



Grafiku 3.14.8: Analiza e shpërndarjes së pikëve në Matematikë

- 26.9% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në kufijtë 0 – 9 pikë, duke mos arritur pikët minimale për kalueshmëri: 10 pikë.
- 2.7% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në kufijtë 46-50 pikë.

Pra, rreth 50% e nxënësve kanë fituar pikë që janë më pak se 25% e pikëve maksimale të testit (50 pikë). Duke e krahasuar me një vit më parë kalueshmëria është ulur nga 99.1% në MSH 2013 në 73.1% në MSH 2014.


Nota mesatare është ulur nga 6.42 në MSH 2013 në 5.4 në MSH 2014.

Përqindja e vlerësimeve me notën 10 është rritur nga 0.04% në MSH 2013 në 2.7% në MSH 2014


Përqindja e vlerësimit me notën 4 është rritur nga 0.8 % në MSH 2013 në 26.9% në MSH 2014

Kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre mbivlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar (17.93) dhe Dibër (18.26)

Lënda: Anglisht




Grafiku 3.14.9: Anglisht 2013 – 2014



Grafiku 3.14.10: Anglisht 2013 – 2014

Vlerësojmë si tregues pozitiv gjimnazin "Said Najdeni" ku 37.7 % e nxënësve janë vlerësuar me notën 9 dhe 10.

Lëndët me Zgjedhje




Grafiku 3.14.11: Lëndët me Zgjedhje Z₁& Z₂

Sipas grafikut veçojmë gjimnazin Arras në lëndën Z₂. % e kalueshmërisë është 50 %

Gjimnazi "Remzi Ademaj" Prizren

Kalueshmëria në Provimin Shtetëror të Maturës në shkollat e Prizrenit është 82.61 %, ndërsa në gjimnazin "Remzi Ademaj" 66 %.


Nota mesatare jepet sipas grafikut



Grafiku 3.14.12: Nota mesatare e gjimnazit "Remzi Ademaj"

Nota mesatare ndër vite: 2.9 nota mesatare e vitit shkollor 2010-2011, 2.7 nota mesatare e vitit shkollor 2011-2012, 3 nota mesatare e vitit shkollor 2012-2013 dhe 2 nota mesatare e vitit shkollor 2013-2014. Ulja e notës mesatare vjetore vërteton hipotezën se dhuna ndikon në performancën dhe arritjet arsimore të nxënësit. Gjithashtu në provimet e Maturës Shtetërore gjimnazi "Remzi Ademaj " ka rënie në renditjen e shkollave të mesme të Prizrenit. Kalueshmëria e Maturës Shtetërore e Prizrenit është 73%, ndërsa gjimnazi "Remzi Ademaj" ka kalueshmëri 66%, pra poshtë kalueshmërisë së shkollave të mesme komunale. Vërtetim i hipotezës se dhuna ndikon në arritjet arsimore të nxënësit.

Gjimnazi "28 Nëntori" Dibër e Madhe



Grafiku 3.14.13: Nota mesatare vjetore sipas viteve

3.53 nota mesatare për vitin shkollor 2012 - 2013ulet në 3.37 për vitin shkollor 2013 – 2014. Gjithashtu për vitin shkollor 2013 – 2014 kemi një kalueshmëri shumë më të ulët se në nivel kombëtar. Vërtetohet hipoteza se dhuna ndikon në arritjet arsimore të nxënësit.

Përfundim:

1. Rezultatet e Maturës Shtetërore 2013 - 2014 poshtë mesatares në shkallë kombëtare.
2. Rezultatet e Maturës Shtetërore 2013 - 2014 janë më të ulëta se Matura Shtetërore 2012 – 2013.
3. Rezultatet e notës mesatare të Maturës Shtetërore kanë rënie ndërmjet viteve.
4. Rezultatet e notës mesatare të shkollave kanë rënie ndërmjet viteve.
5. Ulje të % së notës 10.
6. Rritje të % të notes 4.

Fakte të pakapërcyeshme se dukuria dhunës në shkollë ndikon në arritjet e nxënësit.

Vërtetohet Hipoteza e Studimit:

Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është në rritje, ndikon në performancën dhe rezultatet arsimore të nxënësit.

3.15 Analiza e nevojave SWOT

Për të përcaktuar objektiva sa më reale dhe të suksesshme mund të përdorim dhe modelin e analizës së nevojave, që në anglisht njihet me emërtimin “Analiza SWOT”.

SWOT do të thotë analizim përpara procesit të njohjes së objektivave jo vetëm të programit dhe detyrës, por edhe të:

S = strength, ose anëve të forta Arritjet

W = weakness ose anëve të dobëta Dobësitë

O = opportunities ose mundësive Mundësitë

T = threats ose rreziqeve. Rreziqet

Anët e forta dhe të dobëta kanë të bëjnë me aftësitë, njohuritë, sjelljet,...

Mundësitë dhe rreziqet janë të lidhura ngushtë me mjedisin njerëzor, ligjet, mënyrën e të kuptuarit e të arsyetuarit, drejtimet e zhvillimit dhe të pranimi ku zhvillohet problemi, si shoqëria, mentaliteti, kultura, rregullimet ligjore,....

Arritjet

Bashkëpunim dhe shkëmbim përvoja me kërkues dhe botues shkencorë, mes gjimnazeve Peshkopi, Dibër e Madhe dhe Prizren, regjistri elektronik, siguri private, shërbim psikologjik në shkolla të mesme Peshkopi dhe Dibër e Madhe, programe rajonale, kombëtare dhe lokale, ndërgegjësim i trajnimeve dhe fushatave, metoda ndërvepruese, edukim qytetar, mjedis paqësor, bashkëveprim mësues-nxënës-prindër, uniforma e shkollës dhe dokumentete identifikimit, 2 klasa dixhitale në gjimnazin "Said Najdeni" Peshkopi si dhe pjesë e projektit të "Save the Children" dhe Shkolla-Qendër Komunitare,

Mundësitë

Bashkëpunim me organizata jo qeveritare: Save the Children, World Vision, Partnerë për Fëmijë, Argitra, potencial profesional, motivim i personelit, mësim gjatë gjithë jetës, mësues të licensuar, kultura e shkollës, s'ka diskriminim etnik, kurrikula e re e gjimnazit, kultura e kërkimtarit shkencor, personel i ri, bashkëpunim me ish nxënësit e gjimnazit në institucione arsimore,...

Dobësitë

Shtrirja gjeografike e studimit, ngarkesa mësimore, mosbashkëpunim me psikologët, mungesë statistikash, mosadaptim i mësuesve tradicionalë, mungesë informacioni, mungesë e nxënësve në vendimmarrje, mungesë e psikologut në shkollat e mesme në Prizren, administratorëve socialë dhe personelit të sigurisë, mungesë aktiviteteve, qeveria e nxënësve jo funksionale, keqpërdorimi i trajnimeve, mostransparencë,

Rreziqet

Braktisja e shkollës nga emigrimi në vendet e Evropës Perëndimore, braktisja e fshehtë, diskriminimi, mentaliteti provincial, mishërimi i ndenjave negative vetmi, ndrojtja, fyerja, nervozizmi, humbje e besimit tek vetja, vetëbllokim, humbje e aftësive psikike, kultivimi i sjelljeve të dhunshme, rebelime, kurth i shëndetit mendor, dinakëri, mashtrim, dyfytirësi, abuzim me pushtetin dhe sjellje të pamoralshme, naivitet, dhunim psikologjik dhe fizik, zemërbutësi, stres, ankth, depresion klinik, dhuna vlerë e shkollës, ulja e imazhit të shkollës, psikologët dështim i rradhës, person asocial dhe antisocial....

3.16. 10 veprime për t'i thënë “ Stop “dhunës në shkollë

Kjo guidë është një dizajn i trajtimit pedagogjik të dhunës, që të adresojë mësuesit të parandalojnë dhunën në shkollë. Disa nga veprimet themelore mësuesit mund të fillojnë menjëherë. Të tjerët kërkojnë nivele më të mëdha të përfshirjes.

Në çdo shkollë sigurohet një aktivitet plotësues në klasë, që mësuesi mund t'u propozojë nxënësve. Këto aktivitete në klasë synojnë të ndihmojnë nxënësit në krijimin dhe mbajtjen e ndërveprimeve më harmonike me nxënësit e tjerë dhe mësuesit. Ato mund të paraqiten nga mësuesi si pjesë e një diskutimi në klasë duke dhënë udhëzimet për veprime praktike dhe mund ndërtohen ura komunikimi mësues-nxënës.

Kjo guidë nuk përbën një ilaç për parandalimin e dhunës në shkollë, por është montim i një sistemi alarmi për marrjen në kohë të masave. Ajo shërben për të ndihmuar dhe zhvilluar një kulturë jo të dhunshme shkollore. Një mjedis shkollor pozitiv, jo i ndëshkueshëm dhe jo i dhunshëm siguron të drejtat e mësuesit dhe nxënësit.

1.Gjithëpërfshirje

Advokim për gjithëpërfshirje me nxënësit, stafin e shkollës, prindërit dhe komunitetin. Diskuto me drejtorin e shkollës, këshilltarin, psikologun, kolegët, nxënësit, prindërit, drejtues të institucioneve për të arritur një kuptim të përbashkët të problemit të dhunës në shkollën tuaj. Mësuesit nuk mund të parandalojnë vetëm dhunën në shkollë. Të gjithë aktorët duhet të mblidhen për të dhënë mesazh të fortë dhe të qartë se dhuna është e papranueshme në mjedisin shkollor. Kur të gjithë janë të

vetëdijshëm për mënyrat e ndryshme të shfaqjes së dhunës, njerëzit do të ndikojnë në të dhe do të gjejnë zgjidhje.

2. Harto një plan veprimi me të gjithë aktorët, që janë profesionistë .

Reduktimi i mundësive për dhunë nga nxënësit dhe mjetet për ta parandaluar atë.

Kërkoju nxënësve të flasin me njëri-tjetrin, mësuesin, këshilltarin, psikologun e tyre për dhunën në shkollë. Kush preket dhe si? Kush nga aktorët mund të ndihmojë? Bëj një listë të njerëzve dhe organizatave që mbështesin parandalimin e dhunës në shkollë. Bëj që studentët tuaj të parandalojnë dhunën. Përfshij të drejtat e njeriut dhe edukimin për paqen në kurrikulën shkollore. Mësoj nxënësit për bashkëmoshatarët e tyre, mësuesit, anëtarët e familjes dhe anëtarët e komunitetit, duke përdorur histori, debate, lojë me role, lojëra dhe ngjarje aktuale.

3. Diskuto për Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Të dy dokumentet shprehin mjedisin. Duke diskutuar këto dokumente, që të drejtat e secilit mund të kuptohen, mbrohen dhe respektohen në klasë. Mirato kodin e sjelljes në klasë me nxënësit. Rrit ndërgjegjësimin përmes debateve, udhëtimeve në terren, lojërave, lojë me role dhe leximit të librit.

Përforco sjelljen konstruktive përmes kontaktit me sy, një dremetje ose një buzëqeshje. Pika shtesë krediti ose pesë minuta shtesë të kohës së lojës. Pasja e një suksesi të përmendur para klasës mund të jetë veçanërisht e dobishme për nxënësit. Mund të zgjedhësh grupin më të mirë për sjelljen më të mirë çdo javë dhe të shfaqësh emrin e grupit në një zonë të dukshme të klasës. Kur përdoret një njohje e tillë, ato gjithmonë duhet të jenë të menjëhershme dhe të shkurtra, por të pëlqyeshme.

Përdor masa disiplinore që janë edukative, jo ndëshkuese. Sigurohu që kur disiplinon një nxënës, masat përqendrohen në sjelljen e gabuar të nxënësit dhe ndikimin të tjerët. Disa metoda disiplinore mund të jenë:

- Lër mënjane kohën pas shkollës ose gjatë periudhave të pushimit për të diskutuar sjelljen e gabuar. Pse u ngrit dhe çfarë duhet bërë për ta korrigjuar atë?
- Kërko nga nxënësi të kërkojë falje.
- Dërgo njoftim prindit ose bëj vizita në shtëpi.
- Analizo seriozitetin e situatës dhe vendos ta dërgosh nxënësin në zyrën e drejtorit në varësi të situatës.

4. Je një forcë aktive dhe efektive për të ndaluar dhunën

Të njëjtat pritshmëri në mënyrë të vazhdueshme. Dhuna përfshin dhunën fizike dhe psikologjike.

Zbato vazhdimisht rezultatet për dhunën fizike dhe psikologjike edhe pse shoqërohet me humbjen e kohës , pushimin, drekën me kolegë ose aktivitete jashtëshkollore.

Inkurajo psikologun e shkollës ose stafin të japin këshillime për dhunën, së bashku me zbatimin e pasojave.

Mbështet nxënësit e goditur nga dhuna. Inkurajo ata të flasin me mësuesit dhe psikologun e shkollës për t'i mbrojtur ata nga viktimizimi i përsëritur. Përdor programet e zgjidhjes së konflikteve. Përdor mënyra për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut në shkollë dhe për të promovuar respekt dhe vlerësim për dallimet,

përmes debateve, udhëtimeve në terren, lojërave me roleve dhe konkurseve dhe fushatave ndërgjegjëse.

5. Ndërto rezistencën e nxënësve dhe ndihmoj ata t'i përgjigjen sfidave të jetës në mënyrë konstruktive.

Ndihmo nxënësit të ndërtojnë marrëdhëniet e tyre me të tjerët. Rezistenca e rritur zvogëlon mundësinë e një nxënësi që të reagojë me dhunë ose të bie pre e saj. Mësimdhënësit që demonstrojnë sjellje pro-shoqërore, konstruktive, ofrojnë udhëzime dhe ofrojnë mbrojtje rritin aftësinë e studentëve të tyre duke treguar një mënyrë pozitive, mënyrë alternative për t'iu përgjigjur sfidave të jetës. Mësues të tillë shërbejnë si modele për marrëdhënie pozitive dhe të kujdesshme.

Përfshi shkollën tuaj në një program të edukimit për paqen për të krijuar aftësi për zgjidhjen e konflikteve. Programet e edukimit për paqen lejojnë nxënësit të kuptojnë se si ndodh dhuna dhe të zhvillojnë kapacitete për t'u përgjigjur.

Inkurajo shkollën tuaj të krijojë një program shkollor. Psikologët mund të mbështesin nxënësit që të merren me vështirësi në jetën e tyre dhe të ndërhyjnë në mënyrë parandaluese. Ata mund të mbështesin mësuesit, stafin e shkollës, nxënësit e dhunuar dhe adresimin e dhunës nëpërmjet ndërmjetësimit, arritjen e një zgjidhjeje paqësore para se një situatë të përshkallëzohet në dhunë fizike, duke punuar me viktimat dhe autorët e dhunës, të sigurojë mbështetje psikosociale, duke promovuar programe të dizajnuara për të adresuar çështje të tilla si ngacmimi, abuzimi i drogës dhe aktiviteti i bandave.

Krijo situata që janë momentale reale, nxënësit mund të praktikojnë të përballen me situata stresuese, të panjohura ose komplekse. Inkurajo lojërat që zhvillohen, në

mënyrë që të inkurajojnë empatinë. Kërko nga nxënësit të diskutojnë se si u ndien dhe cilat zgjidhje funksionuan.

Krijo aktivitete për të luajtur role në klasë, ku nxënësit veprojnë jashtë konflikteve të dhunshme, të diskutojnë çdo konflikt dhe mënyrat për ta zgjidhur atë në mënyrë paqësore.

6. Bëhuni një model pozitiv duke folur kundër dhunës gjinore.

Je i vetëdijshëm për paragjykimet gjinore. Ata inkurajojnë diskriminimin gjinor. Ndonjëherë perceptimi i mësuesve për djemtë është i ndryshëm nga perceptimi i tyre për vajzat. Për shembull, disa shohin se djemtë janë natyrshëm më të mirë në matematikë ose ‘natyrisht të zgjuar’, ndërsa vajzat mund të shihen si punëtore, të qeta, ‘të vështirë’. Thyej përjetësimin e stereotipeve dhe pritjeve të ndryshme për vajzat / gratë dhe djemtë / burrat. Rrit vetëdijen për paragjykimet gjinore në klasë dhe inkurajo kolegët tuaj që të bëjnë të njëjtën gjë. Djemtë janë autorë dhe viktime të dhunës brenda shkollës, kështu që mësuesit nuk duhet të përqendrohen vetëm në viktimizimin e vajzave. Sigurohu që bashkëveprimi juaj me djemtë të jetë i ngjashëm me bashkëveprimin tuaj me vajzat. Një frekuencë më e ulët dhe / ose cilësi e bashkëveprimit të mësuesve me vajzat mund të përdoret për vetëvlerësim dhe vetëbesim. Një mënyrë për të inkurajuar vajzat të marrin pjesë në klasë. Vajzat në përgjithësi ndjehen më të lira për t’u shprehur kur gjenden ndërmjet njëra-tjetrës.

Inkurajo shkollën tuaj të krijojë një program trajnimi për mësuesit, nxënësin dhe komunitetin për të kuptuar, identifikuar dhe reaguar ndaj rasteve të dhunës gjinore. Trajnimi duhet të edukojë për paragjykimet gjinore, i cili bazohet në dhunën me bazë gjinore.

Ndihmo shkollën dhe komunitetin tuaj të njohin nevojën për të mbrojtur vajzat dhe gratë brenda mjedisit shkollor. Në situata konflikti dhe pas konfliktit, vajzat dhe gratë janë veçanërisht të ndjeshme ndaj dhunës të lidhura me konfliktin.

Avokat për të trajnuar stafin e shkollës për gjininë dhe dhunën me bazë gjinore si dhe forcimin e përfaqësimit të grave në strukturat e menaxhimit. Personeli i trajnuar ndikon në zbulimin dhe mbështetjen e viktimave nga dhuna me bazë gjinore. Mbështetja e viktimave dhe inkurajimi i raportimit të dhunës gjinore.

Thyej heshtjen. Fol kundër dhunës dhe përdor mekanizmat e raportimit. Mbështet kolegët dhe nxënësit të emërojnë autorët e dhunës. Të gjithë janë të ndryshëm, por të gjithë jemi të barabartë!

7. Bëhu avokat për mekanizmat e sigurisë në shkollë.

Mbështetje dhe shtytje për një menaxhim të fortë dhe një mësimdhënie efektive të shkollës. Shumë e rëndësishme, që ata të punojnë me mësuesit dhe autoritetet e arsimit për të hartuar dhe zbatuar politika.

Ndihmo shkollën tuaj të krijojë një mjedis të sigurt në shkollë.

Avoko mekanizmat e raportimit miqësor të nxënësve, që inkurajojnë të flasin kundër dhunës. Shërbimet e raportimit duhet të jenë mbështetëse, të ndjeshme dhe konfidenciale.

Merr seriozisht ankesat e nxënësve për dhunën dhe mbaj në mend mirëqenien e tyre. Kjo përfshin dhënien e peshës së duhur për një nxënë.

Komuniko me mësuesit, nxënësin, drejtorin e shkollës dhe psikologun për të krijuar një kod sjelljeje shkollor për të gjithë.

8. . Siguro hapësira të sigurta dhe mikpritëse për nxënësit.

Krijo hartën për të identifikuar cilat vende në shkollë janë të sigurta, cilat janë të rrezikshme dhe kur nxënësit janë në rrezik. Stafi i shkollës gjithashtu duhet të paralajmërohet për qoshet, zonat me dritë-hije, shkallët e errëta dhe tualetet, ku nxënësit janë në rrezik të abuzimit seksual ose fizik.

Tërhiq vëmendjen e tualeteve private dhe të sigurta për vajzat dhe gratë. Një arsye e thjeshtë, por domethënëse që vajzat nuk ndjekin shkollën është mungesa e rasteve të sigurta, të pastra dhe lehtësirave të tjera që sigurojnë privatësinë.

Puno së bashku me stafin tjetër për t'u siguruar që mjediset e shkollës janë të sigurta. Nxënësit kanë nevojë për vende të sigurta për të luajtur mes klasave dhe pas shkollës.

Sugjero një fushatë për një mjedis shkollor të sigurt brenda mjedisit shkollor që janë të paligjshëm ose të pasigurt.

9. Mëso aftësitë e parandalimit të dhunës dhe zgjidhjen e konflikteve për nxënësit.

Merr trajnime për zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, menaxhimin e klasës dhe edukimin e paqes. Pyet në DAR, Bashki ose Ministrinë e Arsimit për mundësitë ekzistuese të trajnimit. Informacion mbi materialet, që ofrojnë mënyra praktike për të parandaluar dhe zgjidhur konfliktet në shkolla.

Mëso aftësi ndërmjetësuese që u mundësojnë nxënësve të përcaktojnë konfliktin, shkëmbejnë pozicione dhe të shohin situatën nga të dyja këndvështrimet, opsionet ku të dy nxënësit mund të fitojnë zgjidhje "fituese" , arritja një marrëveshje të arsyeshme për një zgjidhje konstruktive të konflikteve të shokëve të klasës. Ndërmjetësit zyrtarë shërbejnë për të ndërmjetësuar çdo konflikt.

Dizenjo një paqeruajtës të klasës çdo javë në mënyrë që të gjithë të mësojnë dhe praktikojnë aftësi për zgjidhjen e konflikteve.

10. Njih dhunën dhe diskriminimin ndaj nxënësve nga pakicat dhe komunitetet e tjera.

Shpjego arsyet që disa nxënës sillen ndryshe. Thekso se të gjithë anëtarët e klasës janë të ndryshëm në mënyra të ndryshme dhe çfarë i bën ato unike. Të gjithë kanë të drejtë të respektohen për ata që janë. Një punë e ngjashme mund të bëhet në takimet prind-mësues.

Mundohu të bëhesh i vetëdijshëm për paragjykimet ose supozimet e mundshme. Modelo sjelljen e duhur të nxënësit tuaj. Bisedo se si fjalët kanë fuqinë për të lënduar. Kujdesu për dhunën fizike, sado minimale të duket, që mund të shoqërojë vërejtje diskriminuese dhe raciste.

Kontrollo kurrikulën dhe librat shkollorë. A kërkojnë ata të zhvillojnë të kuptuarit e kulturave të ndryshme në shoqëri? A zhvillojnë mirëkuptim për dallimet dhe nxitin të mësuarit për të jetuar së bashku?

Shmang zëdhënësin për grupin e tyre kulturor ose etnik. "Etiketimi" do t'i izolojë ata vetëm nga pjesa tjetër e nxënësve. Ndihma për t'u integruar si pjesë e klasës do të rrisë ndërgjegjësimin për vlerën pozitive të diversitetit.

Eduko veten dhe të tjerët. Veproni tani!

KAPITULLI IV: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Duke marrë si shtysë fillestare parametrat e Shqipërisë në kushtet e europianizimit dhe globalizimit, ky studim ka patur si qëllim analizimin në nivel rajonal të dukurisë së dhunës në shkollat e mesme që operojnë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni si dhe të faktorëve që ndikojnë mbi nivelin e dhunës në këto shkolla. Ky studim është shtrirë në 3 shkolla të mesme në Peshkopi / Shqipëri, 1 shkollë në Prizren / Kosovë dhe 1 shkollë Dibër e Madhe / Maqedoni. Në punim janë parashtruar dy hipoteza kryesore:

1. Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është në rritje.
2. Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollat e mesme në Peshkopi, Prizren dhe Dibër e Madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ndikon në performancë dhe rezultatet arsimore të nxënësit.

Me synim testimin e këtyre dy hipotezave, është shtjelluar një kuadër i plotë teorik, i shtrirë në dy kapituj, i cili trajton në mënyrë të detajuar përkufizimet e dhunës, llojet e saj, mite dhe fakte rreth dhunës në shkollë. Gjithashtu janë trajtuar faktorët të cilët, bazuar në literaturën e shfrytëzuar, rezultojnë faktorë kushtëzues të nivelit të dhunës në shkollë.

Gjithashtu, në funksion të testimit të hipotezave, përmes metodave statistikore (analiza faktoriale, analiza e regresionit etj) është bërë i mundur përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve në lidhje me nivelin e dhunës në shkollë.

Vlerësimi rreth dhunës së fëmijëve në shkollë është:

1. Ka një nivel të lartë të dhunës në shkollë më të lartë sesa mendohej.

2. Ndikimi i dhunës në performancën dhe arritjet arsimore të nxënësit është e lartë.

4.1 Përfundime:

1. Mungesa e kornizës institucionale që trajton dhe parandalon dhunën. Ka një mungesë statistikash dhe dokumentacioni mbi trajtimin dhe parandalimin e dhunës në shkollë.

Asnjë institucion i marrë si objekt studimi nuk ka një plan që trajton dhunën në shkollë ose të përfshirë në Kartën e Performancës së shkollës apo në planin vjetor të psikologëve.

2. Ka një mungesë gatishmërie në rradhët e psikologëve për të folur për dhunën në shkollë, meqenëse shumë të intervistuar thonë se nuk kanë ndeshur apo dëgjuar rreth ndonjë rasti dhune në shkollë. Mungon gatishmëria për bashkëpunim, por rezistenca për të fshehur dukurinë e dhunës edhe pse secili prej nesh brenda e vetes e di që ekziston. Psikologët e marrin se po kontrollon punën e tyre, meqë nuk varen nga drejtori i shkollës dhe gjatë javës janë shëtitës nëpër shkollë.

3. Niveli i ulët i rasteve të raportuara të dhunës është për shkak të dobësive në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve. Fakti i zgjedhjeve qendrore dhe vendore çdo 2 vjet justifikon dhe mungesën e statistikave dhe dosjeve.

4. Ka dallime të qarta ndërmjet sektorëve përsa i përket identifikimit, regjistrimit, raportimit dhe referimit të dhunës. (Sektori i Drejtësisë dhe Shëndetit)

Nga të intervistuarit në Sektorin e Drejtësisë dhe Shëndetit, ata thonë që nuk kanë patur raste, pasi i kalojnë Gjykatës së të Miturve në Tiranë. Mungon Mekanizmi i Referimit për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve.

5. Dallime mes ofruesve të shërbimeve publikë-privatë, rural-urban dhe zonave gjeografike.

Gjithmonë përparësi kanë shkollat e qytetit përse u përket projekteve nga OJQ, pajisjes me libra, bazë materiale, mjedise sportive, etj. Shkollat e zonave rurale janë drejt shkatërimit si objekt fizik dhe as bëhet fjalë për investime.

6. Mungesa e sigurimit fizik dhe teknik të objekteve shkollore, që do të mundësonte kontrollin në shkollë. Vetëm në Shkollën Profesionale "Nazmi Rushiti" ka personel sigurie te porta, ndërsa në shkollat e tjera futesh pa ndonjë rezistencë. Të jashtëm dhe nxënës janë bashkë, aq më tepër përballë shkollës janë lokale që mundësojnë ndotje akustike dhe e pamundur për të realizuar orën e mësimi.
7. Mungesa e uniformës dhe ID së nxënësit mundësojnë të jashtëmit të depërtojnë në ambientet e shkollës, duke krijuar mundësinë e pranisë së huliganizmit në shkollë dhe jashtë saj, të cilët nxisin dhe shkaktojnë dhunë mes nxënësve, mbajtje armësh të ftohta, të nxehta, drogë,...
